



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 648 Akti

Nr. 768 Vendimi  
Tiranë, më 31.5.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 28.5.2024, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Sonjela Voskopi**, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është subjekt rivlerësimi që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e gjyqtarit.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.
- 3.** Me vendimin datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Sonjela Voskopi, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.
- 4.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- 5.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
- 6.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 13.5.2024 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e saj për t’u njohur me rezultatet e hetimit, materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
- 7.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 15.5.2024 me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, me të drejtën e saj për të paraqitur brenda datës 24.5.2024 (ora 12:00) pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit.

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka kërkuar nëpërmjet *email*-it datë 24.5.2024 shtyrjen e afatit edhe një ditë për të paraqitur prapësimet dhe provat pranë Komisionit, në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

9. Komisioni, bazuar në vendimin datë 24.5.2024, nëpërmjet postës elektronike, në datën 24.5.2024, pranoi kërkesën e subjektit duke e shtyrë afatin deri në datën 25.5.2024.

10. Me *email*-in datë 25.5.2024, subjekti ka dërguar pranë Komisionit prapësimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit.

11. Me *email*-in datë 27.5.2024, Komisioni i njoftoi subjektin ftesën për seancën dëgjimore të datës 28.5.2024 (ora 15:00).

## II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 28.5.2024 (ora 15:00), në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

13. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe në përfundim kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

## III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Znj. Sonjela Voskopi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

16. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere vlerësimi: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

17. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe në përfundim ka hartuar dhe dërguar në Komision raportin përkatës<sup>1</sup> ku, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.3.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**18.** Komisioni vëren se subjekti Sonjela Voskopi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e ligjit në fuqi<sup>2</sup>. Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 30.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se janë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

#### ❖ **Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

**1. Apartament banimi me sipërfaqe 104 m<sup>2</sup>**, me adresë: Korçë, Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, mbi të cilin subjekti ka të drejtë përdorimi që e ka marrë nga babai i saj H. V., i cili disponon aktmarrëveshje datë 11.1.2012 me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “\*\*\*” sh.p.k. Vlera 3,500,000 lekë sipas marrëveshjes, nga të cilat të likuiduara 2,500,000 lekë.

Në vitin 2015 ka filluar bashkëjetesën, për këtë arsye ka filluar të përdorë apartamentin e mësipërm. Për arredimin e banesës, gjatë viteve 2015 – 2016, nga kursimet e saj dhe të bashkëjetuesit ka shpenzuar: në vitin 2015, nga kursimet e saj 1,300,000 lekë dhe 700,000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit; për vitin 2016 ka shpenzuar nga kursimet e saj 400,000 lekë dhe nga kursimet e bashkëjetuesit 300,000 lekë. Vlera e arredimit gjithsej: 2,700,000 lekë.

**1.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga babai i subjektit të rivlerësimit: *“Apartament banimi me sip. 104 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Korçë, Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, për të cilën kam nënshkruar aktmarrëveshjen datë 11.1.2012 me shoqërinë e ndërtimit (shitësi) “\*\*\*” sh.p.k. Apartamentin ia kam lënë në përdorim vajzës sime Sonjela Voskopi. Apartamenti nuk është regjistruar në regjistrat publikë në pronësinë time për shkak të mosshlyerjes së plotë të vlerës së tij. Të ardhurat janë krijuar nga puna ime dhe e bashkëshortes (kursime të depozituara në banka para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit), si dhe të ardhura të përfituara nga bashkëshortja me dhurim nga shitja e pronave nga prindërit e saj. Vlera e apartamentit është 3,500,000 lekë, nga të cilat kam likuiduar 2,500,000 lekë”*.

**1.2** Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar *detyrimin e pashlyer në shumën 1,000,000 lekë ndaj shitësit “\*\*\*” sh.p.k.*

**1.3** Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj I. F., për shkak të pozicionit të tij të punës si Avokat Shteti pranë Zyrës Vendore Korçë, kanë deklaruar të drejtën e përdorimit të apartamentit të lënë në përdorim nga babai i subjektit, gjithashtu edhe vlerat e shpenzuara për mobilim, përkatësisht: 1,300,000 lekë nga subjekti dhe 700,000 lekë nga bashkëjetuesi i saj.

**1.4** Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shpenzime për mobilim banese për disa sende. Shuma: 400,000 lekë”*.

---

<sup>2</sup> Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti, datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare<sup>2</sup>, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.16, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë, deri në 19 janar 2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

**1.5** Nga dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ka rezultuar se: (i) me aktmarrëveshjen (pa të drejtë pronësie) datë 11.1.2012, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka shitur blerësit H. V. apartamentin me sip. 104 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Korçë, kati \*\*\*, vlera 3,500,000 lekë. Palët kanë përcaktuar se pagesa e parë do të jetë 1,500,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 2,000,000 lekësh do të shlyhet gradualisht; (ii) me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 11.1.2012, shtetasi H. V. ka paguar në arkën e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shumën 1,500,000 lekë dhe me mandatarkëtimin datë 8.4.2013 ka paguar shumën 1,000,000 lekë.

**1.6** ZVRPP Korçë nuk ka konfirmuar<sup>3</sup> pasuri të paluajtshme në emër subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesit të saj, si dhe as pronësinë e këtij apartamenti në emër të prindërve të saj.

**1.7** Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, referuar çmimit të EKB-së<sup>4</sup> në vitin 2012 që ishte 51.500 lekë/m<sup>2</sup>, vlera e apartamentit me sip. 104 m<sup>2</sup> duhej të ishte 5,356,000 lekë dhe jo 3,500,000 lekë. Pra, duket se apartamenti me vlerë 3,500,000 lekë është blerë rreth 1,800,000 lekë më lirë sesa çmimi referencë.

**1.8** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka konfirmuar<sup>5</sup> se me dakordësinë e palëve nuk janë aplikuar penalitetet për pagesat e vonuara të parashikuara në aktmarrëveshje.

**1.9** Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se *ka banuar në apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, në Korçë, me familjen e origjinës deri në fund të dhjetorit 2014 dhe nuk ka paguar qira. Prindërit kanë vazhduar të banojnë në këtë apartament. Në fillim të muajit janar të vitit 2015 ka filluar bashkëjetesën me shtetasin I. F. në një apartament në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në adresën: rruga “\*\*\*\*”, Lagjja Nr. \*\*\*, pallati i ri përballë shkollës 9-vjeçare “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, Korçë.* Referuar certifikatave familjare<sup>6</sup> rezulton se subjekti i rivlerësimit është ndarë nga trangu i familjes së saj të origjinës në datën 25.9.2016.

**1.10** Shoqëria rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Korçë sh.a. ka konfirmuar<sup>7</sup> lidhjen e kontratës me klienten Sonjela Voskopi në gusht të vitit 2015, me nr. klienti \*\*\*, në adresën: Lagjja Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Korçë, objekti 16. Këtë fakt e konfirmon edhe subjekti i rivlerësimit<sup>8</sup>, duke deklaruar edhe që konsumin e ujit e ka paguar vetë, me qëllim që të mos i faturon shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**1.11** FSHU-ja konfirmon<sup>9</sup> se me shtetasin E. V.<sup>10</sup> ka lidhur kontratë furnizimi të llojit “familjare”, në datën 8.11.2014. Nga dokumentacioni që FSHU-ja ka dërguar, ka rezultuar se kjo kontratë është lidhur fillimisht me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 18.10.2014. Në këtë datë është mbajtur edhe procesverbali me emër klienti Sonjela Voskopi për montim matësi nr. \*\*\*, i cili është i njëjtë me matësin që figuron në kontratën e lidhur me shtetasin E. V..

**1.12** Në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3<sup>11</sup>, subjekti ka shpjeguar se nuk ka lidhur kontratë furnizimi me OSSH-në. Procesverbali i montimit të matësit nr. \*\*\*, që është mbajtur në emrin e saj, mund të jetë për shkak të listës së poseduesve të apartamenteve të banimit që shoqëria ka dërguar pranë

<sup>3</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2021.

<sup>4</sup> Udhëzim nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e koston mesatare të ndërimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K””.

<sup>5</sup> Shkresë datë 10.7.2017 e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>6</sup> Certifikatat familjare nr. \*\*\*, datë 20.1.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 20.1.2017.

<sup>7</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, drejtuar Komisionit.

<sup>8</sup> Përgjigjja nr. 2 e pyetësit nr. 2.

<sup>9</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2023, të FSHU-së.

<sup>10</sup> Nga verifikimi i regjistrit të gjendjes civile rezulton se me emrin E. H. V. ekziston vetëm një person, pra vëllai i subjektit të rivlerësimit.

<sup>11</sup> Përgjigjja nr. 2 e pyetësit nr. 2 dhe përgjigjja nr. 1 e pyetësit nr. 3.

Drejtorisë Rajonale të OSSH Korçë, meqë administratorja e shoqërisë ishte në dijeni që apartamenti do të posedohej prej subjektit dhe bashkëjetuesit të saj. Më pas, bazuar në aplikimin e shoqërisë, kontrata është lidhur në emër të vëllait të saj E. V., pasi shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. e kishte atë të punësuar dhe gjeneralitetet e tij i aksesonte më shpejt sesa të merrte kontakt me subjektin, prandaj ia ka dhënë OSSH-së për të lidhur kontratën me emrin E. V..

**1.13** Për të provuar këto shpjegime, subjekti ka depozituar shkresën e OSSH Drejtoria Rajonale Korçë<sup>12</sup>, që konfirmon se që nga data 7.4.2015, kur kontrata nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka kaluar tek qytetari E. V., energjia elektrike faturohet në emër të këtij të fundit, ndërsa Sonjela Voskopi nuk ka kontratë energjie elektrike. Bashkëlidhur shkresës janë dërguar: (i) kontrata e energjisë në emër të shtetasit E. V., ku rezulton se matësi është instaluar në datën 18.10.2014, ndërsa në datën 8.11.2014 kontrata ka kaluar nga emri i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në emër të këtij shtetasi; (ii) faturat e pagimit të energjisë ku në muajin prill 2015 janë në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe nga muaji maj 2015 janë në emër të shtetasit E. V.; (iii) librezja e energjisë elektrike në emër të shtetasit E. V..

**1.14** Komisioni hetoi<sup>13</sup> për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe organeve drejtuese të saj, nga nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**1.15** Në pyetësorin nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me çmimin më të ulët se çmimi referencë; në lidhje me mospagimin e shumës 1,000,000 lekë të mbetur nga çmimi i apartamentit dhe mosaplikimin e penalteteve për vonesën e kësaj pagese; në lidhje me vlerën e mobilimit më të lartë se vlera e paguar për apartamentin, etj.

**1.16** Në përgjigje<sup>14</sup>, subjekti i rivlerësimit ka depozituar relacionin datë 28.10.2023 të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe ka shpjeguar se: (i) Në lidhje me çmimin e lirë të apartamentit, palët kanë vendosur çmimin 3,500,000 lekë, sepse ballkoni është i pambuluar e, për këtë shkak, i pashfrytëzuar në pjesën më të madhe të vitit<sup>15</sup>; caktimi i çmimit dhe pagesat janë bërë pak pasi pallati ka filluar të ndërtohet, përpara se të merrej leja e shfrytëzimit dhe kur nuk kishte dalë ende certifikata e pronësisë së tij; paratë me të cilat babai i subjektit ka paguar këstet kanë qenë depozitë në bankë; (ii) Pagesa e këstit të fundit 1,000,000 lekë nuk është bërë sepse në mirëkuptim me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare me administratoren dhe një nga ortakët e saj, znj. L. Q., kësti nuk është kërkuar nga shoqëria, meqë edhe në aktmarrëveshje është parashikuar pagimi i saj “gradualisht”, pa datë fikse konkrete. Për shkak të mospagesës së këtij kësti, babai i subjektit nuk ka nënshkruar ende kontratë noteriale me shoqërinë ndërtuese për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe pronar i apartamentit është kjo shoqëri; (iii) Në lidhje me mosaplikimin e penalteteve nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. për vonesën në pagimin e këstit, kjo shoqëri ka shpjeguar në relacionin e saj se nuk e ka pjesë të praktikës dhe politikës në marrëdhëniet me klientët që të përdorë penaltete në rast vonese në pagimin e kësteve. Gjithashtu, shtetasja L. Q., administratore dhe ortakja e kësaj shoqërie, është tezja e subjektit të rivlerësimit, ndërsa babai

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, e OSSH Drejtoria Rajonale Korçë.

<sup>13</sup> (i) Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezultoi se me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.10.2008, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit K. K. (ish-ortak dhe administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.) për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 25.2.2008, por referuar ekstraktit historik të kësaj shoqërie nga QKB-ja, ky shtetas është larguar përfundimisht si administrator dhe ortak nga kjo shoqëri në vitin 2002, pra 6 vjet përpara se subjekti të dispononte me vendimin datë 10.10.2008; (ii) sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 3.1.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; (iii) sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; (iv) sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

<sup>14</sup> Përgjigja nr. 4 e pyetësorit nr. 2.

<sup>15</sup> Në relacionin e saj datë 28.9.2023, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. deklaroi të njëjtën gjë, se çmimi i ballkonit është llogaritur me çmim më të ulët nga ambientet e tjera, meqë ishte i pambuluar.

i subjektit ka punuar para shumë vitesh si shofer pranë kësaj shoqërie; (iv) Marrëdhënien me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. e ka pasur babai i subjektit, pavarësisht se ai nuk ka nënshkruar ndonjë akt për marrjen në dorëzim të apartamentit dhe nuk ka banuar asnjëherë aty, sepse që nga muaji janar 2015 apartamenti është banuar nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj me lejen verbale nga shoqëria ndërtuese, e cila në praktikë ka lejuar përdorimin e apartamenteve të prenotuara, pa kaluar më parë të drejtën e pronësisë dhe për më tepër që administratore është tezja e subjektit<sup>16</sup>; (v) Në lidhje me vlerën e mobilimit më të lartë se vlera e paguar për apartamentin, kur diskutonin familjarisht për nevojën e një banese në Korçë për të filluar bashkëjetesën, subjekti ka konstatuar se shumica e shtëpive me qira ishin ose të pamobiluara ose me mobilie shumë të përdorura, prandaj vendosën që me paratë që kishin kursyer dhe që nuk do i shpenzonin për qira, të blinin mobiliet si sende që në çdo rrethanë zhvendosen, por edhe nëse do të jetonin me qira, gjithsesi shpenzime për mobilim do të kryheshin.

**1.17 Në përfundim të hetimit**, referuar faktit që për blerjen e apartamentit me sip. 104 m<sup>2</sup> nuk është paguar diferenca prej 1,000,000 lekësh e çmimit të blerjes, faktit që vlera e kontraktuar është 1,800,000 lekë më e ulët se çmimi referencë, faktit që apartamenti është përdorur nga subjekti që nga viti 2015 e deri më sot, e provuar kjo edhe me kontratat e furnizimit me ujë (e lidhur në emër të subjektit) dhe me energji elektrike (e lidhur në emër të vëllait të subjektit), Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i kaloi subjekti të rivlerësimit barrën e provës, si vijon:

- Të justifikojë diferencën midis çmimit të ulët të paguar të apartamentit dhe çmimit referencë.
- Të provojë çmimin real të apartamentit, duke depozituar kontrata të ngjashme të porosisë dhe shitjes së apartamenteve nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në pallatin ku është ndërtuar ky apartament.
- Të shpjegojë dhe provojë në mënyrë bindëse përse nuk është bërë deri sot pagesa e diferencës së çmimit prej 1,000,000 lekësh.
- Të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.18 Në lidhje me barrën e provës për të justifikuar diferencën midis çmimit të ulët të paguar të apartamentit dhe çmimit referencë**, subjekti ka shpjeguar në prapësimet e saj se çmimi i shitjes është dakordësuar në vlerën 3,500,000 lekë, për arsye se tezja e saj L. Q. është administratore dhe ortake që zotëron 20% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Gjithashtu, bazuar në çmimin e EKB-së të vitit 2012, ku është referuar Komisioni, vlera gjithsej e apartamentit nuk duhej të jetë 5,356,000 lekë, sikurse e ka përllogaritur Komisioni, por duhet të jetë 4,810,100 lekë (76.7 m<sup>2</sup> sipërfaqe e brendshme + 5.1 sipërfaqe e përbashkët) \* 51,500 lekë/m<sup>2</sup> + 23.2 m<sup>2</sup> sipërfaqe verandë \* 51,500 m<sup>2</sup> \* 50%). Kjo sepse çmimi i shitjes së verandës është 50% e çmimit të shitjes, për rrjedhojë edhe kostoja e ndërtimit të verandës është 50% e kostonë së ndërtimit. Të njëjtin shpjegim subjekti bëri edhe gjatë seancës gjyqësore, ku shpjegoi se veranda është e madhe dhe e pambuluar, çka konstatohet edhe nga planimetria e apartamentit.

**1.19 Në relacionin shpjegues datë 17.5.2024 bashkëlidhur prapësimeve**, administratorja dhe ortakët e shoqërisë kanë deklaruar se janë dakordësuar që çmimi i pasqyruar në aktmarrëveshjen datë 11.1.2012 të jetë nën çmimin mesatar të shitblerjeve në tregun e lirë për qytetin e Korçës për vitin 2011, sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostonë mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”, pasi:

<sup>16</sup> Në përgjigjet nr. 2 dhe nr. 4 të pyetësorit nr. 2.

- Në të njëjtin pallat, çmimi i shitjes nën çmimin mesatar për tregun e lirë është aplikuar edhe në raste të disa blerësve të tjerë, sepse shoqëria ndiqte këtë politikë çmimesh (pra të shesë nën çmimin mesatar të tregut të lirë), për shkak të raportit kërkesë - ofertë të tregut në ato momente.

- Mbi sipërfaqen verandë nuk aplikohet i njëjti çmim/m<sup>2</sup>, sikurse për sipërfaqen e brendshme (siç kemi shpjeguar në relacionin tonë datë 28.10.2023 të hartuar me kërkesën e znj. Sonjela Voskopi).

- Për shkak të lidhjes shumë të ngushtë familjare midis bashkortakes dhe administratores së shoqërisë, znj. L. Q., me palën blerëse, sikurse ka ndodhur në raste të tjera kur blerës të apartamenteve apo njërive të objektit kanë qenë familjarë të bashkortakëve të tjerë.

**1.20** Në lidhje me barrën e provës për të provuar çmimin real të apartamentit, duke depozituar kontrata të ngjashme të porosisë/shitjes së apartamenteve nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. në pallatin ku është ndërtuar ky apartament, subjekti ka shpjeguar se çmimi real është ai i shënuar në aktmarrëveshjen datë 11.1.2012 dhe që në fakt është dakordësuar në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, pavarësisht se aktmarrëveshja u nënshkrua në momentin e maturimit të depozitës 1-vjeçare.

**1.21** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në prapësime disa kontrata shitblerjeje<sup>17</sup> të lidhura midis shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe blerësve të ndryshëm të apartamenteve të pallatit ku ndodhet apartamenti që përdor subjekti i rivlerësimit. Çmimi mesatar në këto apartamente rezulton 43,485 lekë/m<sup>2</sup> dhe subjekti shpjegon se ky çmim, krahasuar me çmimin 33,333 lekë/m<sup>2</sup> të apartamentit që ajo përdor, rezulton se është 10,000 lekë/m<sup>2</sup> më i lartë.

**1.22** Në lidhje me barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar në mënyrë bindëse mospagesën deri sot të diferencës së çmimit prej 1,000,000 lekësh, në prapësimet e saj subjekti ka shpjeguar se: “Qëllimi i blerjes së apartamentit ishte të siguronin një banesë për vëllain, që do ta përdorte në momentin kur të krijonte familjen e tij. Në aktmarrëveshjen datë 11.1.2012 është përcaktuar që vlera e blerjes së apartamentit do të likuidohet gradualisht. Për shkak të marrëdhënies së punësimit që vëllai ka si inxhinier me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. që nga marsi 2013, për shkak se babai dhe vëllai në vitin 2015 kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një ekonomi të përbashkët familjare, si dhe për shkak se në vitin 2015 babai pati probleme shëndetësore, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. nuk ka kërkuar shlyerjen e pagesës në shumën 1,000,000 lekë, prandaj nuk është paguar deri sot detyrimi i mbetur prej 1,000,000 lekësh. Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. dhe vëllai do ta zgjidhin me njëri-tjetrin këtë marrëdhënie dhe shuma 1,000,000 lekë do të trajtohet si bonus, duke kompensuar në këtë mënyrë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet tyre. Mospagimi i kësaj shume nuk ka ardhur si mungesë e likuiditetit të familjes time pasi, sikurse rezultoi nga analiza financiare, vëllai ka pasur depozitën prej 1,000,000 lekësh në vitet 2015 dhe 2016, ndërsa prindërit kanë pasur kursimet cash në vlerën 700,000 lekë”.

**1.23** Për të provuar këto shpjegime, subjekti ka bashkëlidhur: (i) Deklaratën noteriale datë 23.5.2024, ku shtetasi E. V. deklaron se prindërit e tij i kanë treguar se kanë prenotuar një apartament pranë apartamentit ku jetonin së bashku, me qëllim që t’ia dhuronin kur ai të krijonte familjen e vet dhe të ndahej prej tyre. Diferenca prej 1,000,000 lekësh nuk është paguar ende prej tij dhe as nga babai, sepse shoqëria nuk e ka kërkuar këtë pagesë dhe këtë qëndrim të shoqërisë ai e ka vlerësuar si “bonus” për periudhën 11-vjeçare të punësimit dhe të performancës së tij pranë saj, ndërsa shoqëria e ka parë si mekanizëm për ta mbajtur të lidhur në punë, për shkak të nevojës për specialistë inxhinierë. Nëse shoqëria do t’i kërkonte pagesën e shumës 1,000,000 lekë, fare

<sup>17</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.6.2015, me palë blerëse M. C. (çmimi 43,871 lekë/m<sup>2</sup>); kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.10.2015, me palë blerëse I. Zh. (çmimi 43,750 lekë/m<sup>2</sup>); kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.10.2016, me palë blerës A. G. (çmimi 43,617 lekë/m<sup>2</sup>); kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.10.2015, me palë blerës S. Rr. (çmimi 42,682 lekë/m<sup>2</sup>).



mirë mund ta realizonte duke i mbajtur paratë nga paga e tij, por nuk e ka bërë një veprim të tillë; (ii) Relacionin shpjegues datë 17.5.2024 të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., i nënshkruar nga administratorja dhe të gjithë ortakët e shoqërisë, ku citohet se diferenca e mbetur pa paguar prej 1,000,000 lekësh nga çmimi i apartamentit nuk është kërkuar nga shoqëria, për shkak se djali i blerësit është i punësuar pranë saj që prej vitit 2013 si inxhinier ndërtimi që ndjek zbatimin e projekteve dhe është shumë korrekt në punë, prandaj shoqëria ka pasur nevojë që ta motivojë në këtë mënyrë për të vazhduar marrëdhënien e punësimit me të. Këtë qëndrim shoqëria mban edhe me punonjës të tjerë të saj, si p.sh.: (a) me shtetasin A. Xh., me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen datë 28.5.2008 për blerjen e një apartamenti me vlerë 4,000,000 lekë, të cilën ai e ka shlyer me këste ndër vite dhe aktualisht ka mbetur pa shlyer shumën 730,000 lekë, ndërkohë që e përdor apartamentin që nga viti 2010; (b) me shtetasin P. B., me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen datë 12.6.2004 për blerjen e një apartamenti me vlerë 2,400,000 lekë, të cilën e ka shlyer me këste ndër vite dhe aktualisht ka mbetur pa shlyer shumën 400,000 lekë, ndërkohë që e përdor apartamentin që nga viti 2005. Për këta shtetas, shoqëria ka zgjedhur si penalitet të mos lidhë kontratën e shitjes dhe të mos i kalojë pronësinë e apartamenteve, pasi nuk e sheh të arsyeshme që t’u kërkojë gjyqësisht lirim e banesave; (iii) Deklaratat noteriale<sup>18</sup> të shtetasve A. Xh. e P. B., të cilët konfirmojnë të njëjtat rrethana që citohen në relacionin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. si më lart, si dhe duke deklaruar pamundësinë e shlyerjes së pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit për shkaqe ekonomike; (iv) Aktmarrëveshjet<sup>19</sup> që shtetasit A. Xh. e P. B. kanë lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. për blerjen e apartamenteve të tyre; (v) Certifikatat<sup>20</sup> e pronësisë ku apartamentet e blera nga shtetasit A. Xh. e P. B. janë të regjistruara në emër të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.; (vi) Kontratat<sup>21</sup> e furnizimit me energji elektrike në emër të shtetasve A. Xh. e P. B. për këto apartamente dhe pagesat mujore të energjisë elektrike.

**1.24** Në lidhje me barrën e provës për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka shpjeguar se prindërit dhe vëllai i saj e kanë deklaruar apartamentin në deklaratën *Vetting*, duke iu nënshtruar hetimit edhe në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të tij. Edhe sikur ky apartament të ishte porositur dhe paguar nga subjekti, përgjegjësia ligjore për të provuar burimin e ligjshëm të tij do të ishte e njëjtë.

**1.25** Në vijim, subjekti shpjegon se apartamenti është porositur nga babai me perspektivën që aty të jetonte vëllai kur të krijonte familjen e tij. Në fillim të vitit 2015, subjekti vendosi të bashkëjetojë me shtetasin I. F., i cili deri në atë periudhë kishte banuar me prindërit e tij në fshatin \*\*\*, Korçë dhe meqë vëllai i saj ishte ende beqar, u vendos që këtë apartament ta përdorë subjekti me bashkëjetuesin e saj. Subjekti filloi edhe mobilimin e apartamentit që ishte bosh, meqenëse kishin kursime e njëkohësisht do të kursenim duke mos paguar qira. Mobilimin e konsideruan si investim për të ardhmen, meqë mobiliet si sende të luajtshme zhvendosen. Vëllai, i cili u martua në nëntor të vitit 2016 dhe në gusht të vitit 2017 lindi fëmijën e parë, vendosi të vijojë jetesën në të njëjtën banesë me prindërit, për shkak të gjendjes shëndetësore të babait që u operua në zemër, ndërsa nëna duhej të kujdesej edhe për fëmijën e vogël të vëllait, madje për këtë arsye ajo mbylli edhe biznesin<sup>22</sup>.

**1.26** Në deklaratën noteriale datë 23.5.2024, shtetasi E. V. konfirmon këto rrethana që shpjegoi subjekti në prapësime, duke shtuar se kur është nënshkruar aktmarrëveshja datë 12.1.2012 për

<sup>18</sup> Deklaratat noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.5.2024 dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.5.2024.

<sup>19</sup> Aktmarrëveshje datë 28.5.2008 e shtetasit A. Xh.; aktmarrëveshje datë 12.6.2004 e shtetasit P. B..

<sup>20</sup> Certifikatë pronësie datë 2.5.2012 dhe datë 4.5.2010.

<sup>21</sup> Kontratë datë 25.2.2010 në emër të shtetasit A. Xh. dhe datë 25.10.2005 në emër të shtetasit P. B..

<sup>22</sup> Personi fizik “A. V.” më 12.4.2018 ka kaluar me status “çregjistruar”.

apartamentin, motra e cila kishte pagë të lartë ka qenë beqare dhe jetonte pranë familjes, prandaj prindërit menduan që me paratë që kishin depozitë në bankë të ndihmonin djalin duke blerë një banesë për të. Në nëntor të vitit 2022, subjekti lindi fëmijën dhe kishte nevojë për më tepër hapësirë banimi, po kështu edhe ai që tashmë ishte familje e re me 5 anëtarë, prandaj u mendua që subjekti të lironte apartamentin në pranverë-verë të vitit 2023 dhe aty të banonte familja e tij. Por, në dhjetor të vitit 2022 babai u diagnostikua me sëmundje të rëndë, prandaj vëmendja e përkujdesi ndaj tij i penguan që të merreshin me zhvendosjen e banesave.

**1.27** Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka depozituar certifikatën e martesës së vëllait, datë 22.5.2024, që vërteton martesën më 3.11.2026, si dhe dokumentacionin shëndetësor<sup>23</sup>, që vërteton problemet shëndetësore të babait të saj në vitet 2015 dhe 2023 – 2024.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.28** Në lidhje me diferencën midis çmimit të ulët të paguar të apartamentit dhe çmimit referencë, Komisioni sjell në vëmendje që në relacionin e depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 2, së bashku me planimetrinë e apartamentit bashkëlidhur ku evidentohet një verandë prej 23 m<sup>2</sup>, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka konfirmuar se meqë 23 m<sup>2</sup> e apartamentit është verandë e pambuluar, palët janë dakordësuar që për verandën të aplikohet çmim më i ulët sesa çmimi për sipërfaqen e brendshme. Bazuar në udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, të EKB-së, përcaktohet vetëm çmimi i blerjes së sipërfaqes së një apartamenti, pa u specifikuar çmimi i verandës. Për këtë arsye, Komisioni i është referuar VKM-së nr. 173, datë 29.3.2006 “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, sipas të cilit rezultojnë se kostoja e parkimit të hapur, me të cilën mund të përafrohet veranda<sup>24</sup>, është 30% e çmimit të apartamentit. Por, meqenëse midis babait të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese është dakordësuar që çmimi i paguar për verandën të jetë 50% i çmimit të sipërfaqes së apartamentit, atëherë përlllogaritjet do të bazohen mbi këtë çmim real të paguar, i cili është më i lartë se çmimi dysHEME i verandës, i përcaktuar nga ligji. Kështu që çmimi i referencës që duhet përlllogaritur dhe krahasuar me çmimin e blerjes së pronës në fjalë është 4,810,100 lekë, sikurse pretenduar nga subjekti në parashtrimet e saj. Si rrjedhojë, diferenca nga ky çmim referencë tek çmimi i blerjes 3,500,000 lekë është 1,310,100 lekë. Kjo diferencë është justifikuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në relacionin e saj datë 28.10.2023 gjatë hetimit dhe në relacionin bashkëlidhur prapësimeve, për efekt të politikës së saj në shitjen e apartamenteve, ku ka mbajtur parasysh raportin kërkesë-ofertë, shtuar kësaj edhe favorizimin për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare që administratorja dhe ortakia e kësaj shoqërie ka me blerësin e këtij apartamenti.

**1.29** Në lidhje me barrën e provës për të provuar çmimin real të apartamentit duke depozituar kontrata të ngjashme të porosisë dhe shitjes së apartamenteve nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në pallatin ku është ndërtuar ky apartament, subjekti nëpërmjet kontratave që depozitoi provoi deklarimin e saj dhe të ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. se çmimet e shitjes së apartamenteve kanë qenë nën çmimin referencë të EKB-së për vitin 2012. Pra, aplikimi i çmimit të shitjes së apartamentit më i ulët se çmimi referencë të EKB-së, nuk është bërë nga shoqëria ndërtuese vetëm për rastin e apartamentit ku banon subjekti i rivlerësimit, si rrjedhojë nuk kemi një trajtim dukshëm

<sup>23</sup> Epikrizë daljeje datë 16.5.2025 e QSUT “\*\*\*\*”, që provon shtrimin në spital dhe ndërhyrjen kirurgjikale në zemër që ka kryer babai i subjektit të rivlerësimit në datën 4.4.2015; ekzaminimi imazherik datë 7.2.2023, që babai i subjektit ka kryer në spitalin “\*\*\*\*” në Tiranë dhe është ekzaminuar me Ca Pulmoni sinister; fletë-dalje datë 1.3.2023 nga spitali “\*\*\*\*”, që konfirmon se babai i subjektit ka operuar mushkërinë e prekur nga Ca Pulmoni dhe i rekomandohet rikontroll çdo dy javë; fletë përcjellëse datë 6.3.2023 e spitalit “\*\*\*\*” për ekzaminimin histopatologjik të babait të subjektit; vërtetim nga spitali “\*\*\*\*”, datë 2.5.2024, që pasqyron kronologjinë e trajtimit me kimioterapi të pacientit H. V. që nga shkurti 2023 deri më 2.5.2024.

<sup>24</sup> Në Aneksin 1 të kësaj VKM-je, në tabelën “Lista e fitimeve minimale fiskale për shitjen e apartamenteve në Korçë”, tek shënimi 4, përcaktohet se: “Fitimi minimal për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30% e fitimit minimal të sipërfaqeve të banimit.

të veçantë në krahasim me blerësit e tjerë të apartamenteve, duke vënë në dispozicion të Komisionit kontrata të ngjashme.

**1.30** Duke marrë në konsideratë edhe rrethanat e tjera të pretenduara nga ortakët e shoqërisë (si lidhjen e ngushtë familjare midis blerësit H. V. dhe administratores, e njëkohësisht ortakës së shoqërisë; momentin e caktimit të çmimit sapo është miratuar leja e ndërtimi, kur gjithmonë ekziston tendenca e ndërtuesit që çmimi i shitjes së apartamentit që porositet për t'u ndërtuar, të jetë më i ulët sesa çmimi i një apartamenti të përfunduar), atëherë rrjedhimisht vlera më e ulët e çmimit të apartamentit në përdorim të subjektit është e logjiksht e justifikuar.

**1.31** *Në lidhje me barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar në mënyrë bindëse përse nuk është bërë deri sot pagesa e diferencës së çmimit prej 1,000,000 lekësh*, Komisioni vlerëson se mënyra e shlyerjes gradualisht dhe pa afat e kështit të fundit që është përcaktuar në kontratë, marrëdhënia e ngushtë familjare midis palëve kontraktore, marrëdhënia e punësimit të babait dhe vëllait të subjektit tek shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., si dhe politikat e punësimit që ndjek kjo shoqëri, të sjella të gjitha këto nga subjekti si argumente të shoqëruara edhe me provat përkatëse, krijojnë bindjen se këto janë rrethana të reale dhe të pranueshme deri në atë masë sa që të krijohet një terren për një tolerancë të tillë midis palëve kontraktore. Për sa kohë që ekzistojnë marrëdhëniet familjare dhe të punësimit midis palëve, këto kanë hapësirën që midis tyre të dakordësohen për pagimin ose jo të kësaj difference, për faljen plotësisht ose tërësisht të saj, apo për këmbimin e saj me shërbimin që ofron vëllai i subjektit si i punësuar pranë palës tjetër, shitësit. Pra, diferenca e çmimit është një pikë e marrëdhënies që do të zgjidhet midis palëve kontraktore, pjesë e së cilave subjekti nuk ka qenë dhe nuk është bërë asnjëherë.

**1.32** Këto shpjegime, parë edhe në dritën e realitetit të shoqërisë shqiptare, ku shpesh ndodh që nëse në një marrëdhënie kontraktore midis palëve ndërthuren raportet familjare dhe raportet e punësimit, patjetër që do të rezultojnë favorizime dhe tolerime nga palët, e në këtë rast nga pala shitëse, sikurse ka rezultuar edhe me blerës të tjerë në rastin konkret, po të punësuar në shoqëri.

**1.33** *Në lidhje me barrën e provës për të provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës*, Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar me detaje rrethanat dhe qëllimin e blerjes së këtij apartamenti; të gjitha rrethanat familjare që e kushtëzuan atë të fillonte përdorimin e përkohshëm të apartamentit që nuk është i saj dhe të vazhdonte përdorimin e tij prej disa vitesh; mënyrën e deklarimit të këtij apartamenti nga subjekti dhe prindërit e saj pa u përpjekur ta fshehin atë apo të shtrembërojnë ndonjë rrethanë në lidhje me krijimin e kësaj pasurie.

**1.34** Të gjitha këto rrethana ku ndërthuren arsyet madhore njerëzore, familjare, tradita e familjes shqiptare, marrëdhënia e familjarëve të subjektit, ku spikat mbështetja dhe respekti i ndërsjellë midis tyre, krijojnë bindjen se përdorimi i këtij apartamenti nga subjekti është një histori reale familjare dhe jo një tentativë e subjektit për të fshehur një pasuri që mund të ishte dyshuar se mund të ishte krijuar prej saj. Gjithashtu, fakti që kontrata e furnizimit me energji elektrike pasi është miratuar nga OSSH Drejtoria Rajonale Korçë në qershor të vitit 2014<sup>25</sup> në emër të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., është lidhur më pas në maj të vitit 2015 në emër të vëllait të subjektit dhe nuk është lidhur në emër të subjektit, provon se ky apartament është blerë për vëllain e subjektit.

**1.35** Të gjitha shpjegimet dhe provat e paraqitura së bashku nga subjekti në lidhje me të gjitha barrët e provës, provuan tej çdo dyshimi të arsyeshëm se apartamenti nuk është pasuri e fshehur e

---

<sup>25</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, të OSSH Drejtoria Rajonale Korçë.

subjektit dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

**1.36** Në vijim, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit dhe familjes së saj për blerjen e apartamentit në shumën 2,500,000 lekë nga ana e prindërve dhe për mobilimin e tij në shumën 2,700,000 lekë nga ana e subjektit dhe bashkëjetuesit të saj.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e apartamentit**

**1.37** Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar dy burime të ardhurash për blerjen e apartamentit, por pa përcaktuar vlerën e secilit burim, konkretisht: (i) të ardhurat e krijuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes (kursime të depozituara në banka para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit); (ii) të ardhura të përfituara nga bashkëshortja me dhurim, nga shitja e pronave nga prindërit e saj.

**1.38** Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar: *“Interesa në vlerën 189,789 lekë nga depozita e krijuar më datën 11.1.2011 në Intesa Sanpaolo Bank sh.a., me nr. reference \*\*\*, e mbyllur në datën 11.1.2012. Kjo depozitë është krijuar nga shuma prej gjithsej 1.500.000 lekësh që unë dhe bashkëshortja i kemi pasur në banka, para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe 1,500,000 lekë që i janë dhënë bashkëshortes me dhurim nga nëna dhe ati i saj, nga të ardhurat e përfituara prej tyre nga shitja e pasurive të paluajtshme që atyre u ka ardhur në trashëgimi, pas procesit të kthimit të pronave ish-pronarëve”*.

**1.39** Sa i takon burimit të parë “1,500,000 lekë kursime të depozituara në banka para fillimit të detyrës së subjektit”, në DIPP-në e vitit 2008 (i vetmi vit kur kanë deklaruar prindërit e subjekti), ata kanë deklaruar: *“Kontratë depozite datë 11.2.2008, depozituese A. V. në Raiffeisen Bank sh.a., nr. llogarie \*\*\*, afati i depozitimit 12 muaj. Shuma 500,000 lekë”* dhe *“Kontratë depozitë datë 6.2.2008 në Bankën Amerikane të Shqipërisë, nr. llogarie \*\*\*, afati 12 muaj. Shuma 1,000,000 lekë”*. Ndërsa në deklaratën *Vetting* prindërit e subjektit kanë deklaruar: (i) *Interesa në vlerën 109,055 lekë nga depozita, e krijuar në datën 2.2.2005, në Bankën Amerikane të Shqipërisë..., e maturuar disa herë me afate 1-vjeçare dhe 6-mujore. Kjo depozitë është mbyllur në datën 6.2.2009...;* (ii) *Interesa bankarë në vlerën 31,194 lekë nga depozita e krijuar në datën 9.2.2007 në Raiffeisen Bank sh.a., dega Korçë..., e maturuar. Kjo depozitë është mbyllur në datën 11.2.2009...<sup>26</sup>.*

**1.40** Nga verifikimi i llogarive bankare të prindërve të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë krijuar dy depozita: (i) Një në emër të babait të subjektit, e çelur në datën 2.2.2005 në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank), në shumën 1,000,000 lekë. Depozita është rinovuar disa herë dhe është mbyllur/tërhequr në datën 6.2.2009; (ii) Një depozitë në emër të nënës së subjektit, e hapur në datën 9.1.2006 në ABA Bank, në shumën 500,000 lekë, tërhequr në datën 10.10.2006, ridepozituar në Raiffeisen Bank në datën 11.2.2007 dhe tërhequr në datën 11.2.2009.

**1.41** Në datën 11.1.2011, babai i subjektit ka depozituar pranë Intesa Sanpaolo Bank, dega Korçë, shumën 3,000,000 lekë, duke çelur një depozitë me afat 1-vjeçar. Kjo depozitë është mbyllur dhe shuma është tërhequr në të njëjtën ditë kur i është paguar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma 1,500,000 lekë sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 11.1.2012.

<sup>26</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) kontratë depozite datë 2.2.2005, me afat, e lidhur midis Bankës Amerikane dhe shtetasit H. V., për shumën e depozituar prej 1,000,000 lekësh; (ii) mandatet për tërheqjen e interesave në shkurt të viteve 2005 – 2008, ku vlera totale e interesave është 150,325 lekë.

**1.42** Subjekti në pyetësonin nr. 2<sup>27</sup> ka përshkruar të njëjtat lëvizje bankare si më sipër dhe ka shpjeguar se depozitat që kanë tërhequr prindërit nga bankat në datat 6 dhe 11 shkurt 2009 janë mbajtur *cash* në banesë deri në momentin e ridepozitimit të shumës 3,000,000 lekë në janar të vitit 2011. Subjekti shpjegon se *cash* në banesë është mbajtur edhe diferenca prej 1,500,000 lekë e mbetur nga shuma 3,000,000 lekë, pasi ajo u tërhoq në janar të vitit 2012 dhe u pagua kësti i parë i apartamentit, dhe nga diferenca është paguar kësti i dytë prej 1,000,000 lekësh, në datën 8.4.2013.

**1.43** Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit detyrimin për deklarim e kanë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët madhorë të subjektit deklarues, Komisioni gjatë hetimit ka mbajtur parasysh deklarimin e prindërve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008, deklaratën *Vetting* dhe shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ.

**1.44** Gjatë hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të deklarojë burimin e krijimit të shumës 3,000,000 lekë, të depozituar nga babai i saj në ISP Bank në datën 11.1.2011, duke sqaruar edhe zanafillën e krijimit dhe vijueshmërinë e depozitave të prindërve të saj.

**1.45** Në përgjigje<sup>28</sup>, subjekti ka shpjeguar 3 burime:

- *1,500,000 lekë të depozituara në dy llogari bankare të ndryshme (siç është pasqyruar më lart) nga prindërit para fillimit të detyrës nga ana ime, shuma që janë kursime nga puna e tyre ndër vite, duke pasur parasysh edhe faktin se nëna ime ka pasur të ardhura të tjera, të dhëna nga prindërit e saj..., që iu ka dhënë mundësinë prindërve të mi të kursejnë më shumë nga të ardhurat nga puna.*
- *1,000,000 lekë si kursime që kanë qenë cash në banesë, siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 nga prindërit e mi, nga të ardhurat prej gjithsej 1,600,000 lekësh, që nëna ime ka marrë nga prindërit e saj në periudhën 2004 – 2006<sup>29</sup>.*
- *500,000 lekë të përfituara gjatë periudhës 2009 – 2010 nga nëna ime, të dhëna nga prindërit e saj.*

**1.46** Në lidhje me burimin e krijimit të dy depozitave të prindërve, në total 1,500,000 lekë që nga viti 2005, si pjesë përbërëse e depozitës 3,000,000 lekë, vërehet se në deklaratën *Vetting* babai i subjektit deklaroi si burim të ardhurat që janë krijuar nga puna e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa në DIPP-në e vitit 2008 nuk deklaroi drejtpërdrejt burimin, por pasi ka deklaruar dy depozitat bankare<sup>30</sup> 1,000,000 lekë dhe 500,000 lekë, poshtë tyre deklaroi një pasuri tjetër automjet dhe citon: “Çmimi 250,000 lekë. Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.11.2006... Makina është blerë nga dhurata me vlerë 1,600,000 lekë e bërë nga S. K. (e padokumentuar në kontratë dhurimi) babai i nënës. Ai i ka siguruar për shkak të tjetërsimit të pasurive të fituara nga ligji nr. 9235, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” një pjesë e shumës është përdorur për blerjen e makinës, pjesa tjetër është shumë në lekë, e pasqyruar si më

<sup>27</sup> Përgjigjja nr. 3/a e pyetësorit nr. 2

<sup>28</sup> Në pyetësonin nr. 2.

<sup>29</sup> Ashtu si është shpjeguar në përgjigje të pyetjes nr. 13: “(i) Gjatë vitit 2004 – janar 2005 është dhënë një shumë gjithsej 1,200,000 lekë (500,000 lekë nga të ardhurat ndër vite të siguruara nga gjyshja N. K. nga tjetërsimi i pronave ku ajo ka qenë bashkëpronare dhe 700,000 lekë nga të ardhurat nga shitja e pronave ku gjyshi rezultonte bashkëpronar. (ii) Në fund dhjetori 2005 ose fillim janari i vitit 2006 është dhënë një shumë prej 400,000 lekësh nga të ardhurat nga gjyshi, i cili sapo kishte tjetërsuar një pronë (kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2005). Pra, në periudhën 2004 – 2006 janë përfituruar gjithsej 1,600,000 lekë, siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008”.

<sup>30</sup> Kontratë depozite datë 11.2.2008, depozituese A. V., në Raiffeisen Bank, nr. llogarie \*\*\*, afati i depozitimit 12 muaj. Shuma 500,000 lekë; Kontratë depozite datë 6.2.2008 në Bankën Amerikane të Shqipërisë, nr. llogarie \*\*\*, afati 12 muaj. Shuma 1,000,000 lekë.

*sipër*”. Fjalja “Pjesa tjetër është shumë në lekë e pasqyruar si më sipër” i referohet dy depozitave bankare, duke lënë të kuptohet se diferenca prej 1,350,000 lekësh, pasi është blerë automjeti prej 250,000 lekësh, është burim i këtyre dy depozitave.

**1.47** Pra, për depozitën 3,000,000 lekë, në DIPP-në e vitit 2008, babai i subjektit deklaroi si burim shumën e mbetur nga dhurata me vlerë 1,600,000 lekë që nëna e subjektit ka marrë nga prindërit e saj prej shitjes së pronave, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes, duke bërë që të ketë mospërputhje në këto dy deklarime.

**1.48** Sa më sipër, në lidhje me burimin e dy depozitave në shumën totale 1,500,000 lekë, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar dy burime: të ardhurat e punës së prindërve të subjektit dhe dhurimet që ka përfituar nëna e subjektit nga prindërit e vet.

**1.49** Gjithashtu, duke mbajtur parasysh shpjegimin e subjektit në pyetësin nr. 2 mbi mënyrën sesi është shpenzuar shuma 1,600,000 lekë që nëna e saj ka marrë dhuratë nga prindërit (250,000 lekë është shpenzuar për blerjen e automjetit nga babai në vitin 2006; shuma 350,000 lekë është shpenzuar gjatë periudhës 2004 – 2006; 1,000,000 lekë është mbajtur *cash* në banesë, derisa është krijuar depozita prej 3,000,000 lekësh nga babai në datën 11.1.2011 pranë Intesa Sanpaolo Bank), duket se dy depozitat me vlerë totale 1,500,000 lekë nuk janë krijuar nga një pjesë e dhuratës 1,600,000 lekë.

**1.50** Si rrjedhojë, mund të merret në konsideratë deklarimi në deklaratën *Vetting* i babait të subjektit dhe i subjektit në shpjegimet e saj gjatë hetimit administrativ se burim i kursimeve prej 1,500,000 lekësh, të depozituara në banka para fillimit të detyrës, janë të ardhurat nga puna e prindërve të subjektit të rivlerësimit, pasi: (i) deklarata *Vetting* ka qëllimin e korrigjimit të deklarimeve të kryera nga subjektet ndër vite; (ii) në një ekonomi familjare është thuajse e pamundur të evidentohet burimi nga i cili vjen çdo kursim.

**1.51** Në lidhje me shumën tjetër 1,500,000 lekë, që ka shërbyer për krijimin e depozitës 3,000,000 lekë në datën 11.1.2011, babai i subjektit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim paratë që nëna e subjektit ka marrë me dhurim nga prindërit e saj që i kanë përfituar nga shitja e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, sikurse u përmend më lart, edhe subjekti ka deklaruar në pyetësin nr. 2 dy burime<sup>31</sup>: (i) 1,000,000 lekë si kursime që kanë qenë *cash* në banesë deri kur u krijuar depozita 3,000,000 lekë, siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 nga prindërit e saj, nga të ardhurat prej gjithsej 1,600,000 lekë që nëna ka marrë nga prindërit e saj në periudhën 2004 – 2006; (ii) 500,000 lekë dhuratë nënës nga prindërit e saj gjatë viteve 2009 – 2010.

**1.52** Për shumën 1,000,000 *cash* në banesë, subjekti shpjegon se është përfituar si dhuratë e nënës nga prindërit dhe i referohet deklarimit që kanë bërë prindërit në DIPP-në e vitit 2008, por në këtë deklaratë prindërit kanë deklaruar si burim të shumës 1,000,000 *cash* në banesë të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar i subjektit fizik “A. V.”, që ka filluar veprimtarinë në vitin 1997 deri sot.

**1.53** Edhe në lidhje me këtë mospërputhje vlen i njëjti arsyetim si në pikën 1.50 më lart.

**1.54** Për të konkluduar, për efekt të analizës financiare, burimet që kanë shërbyer për krijimin e shumës 2,500,000 lekë që janë paguar për apartamentin janë konsideruar në këtë mënyrë: (i) dy depozitat, në shumën totale prej 1,500,000 lekësh, janë krijuar me një pjesë nga dhurata nga gjyshërit; (ii) shuma *cash* prej 1,000,000 lekësh nga kursimet e krijuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të nënës, para emërimit në detyrë të subjektit.

<sup>31</sup> Përgjigjet nr. 3/a dhe nr. 12 të pyetësorit nr. 2.

**1.55** Mospërputhjet e konstatuara në përgjigjet e subjektit, sa i takon përcaktimit specifik të burimeve për krijimin e depozitës 3,000,000 lekë, pra të ardhurat nga aktiviteti i nënës dhe të ardhurat e dhuruara nga gjyshërit, mbahen në konsideratë në kuadër të faktit se: (a) kemi të bëjmë me një ekonomi të përbashkët familjare; (b) ka kaluar një kohë e gjatë nga krijimi i këtyre burimeve.

**1.56 Në përfundim**, lidhur me burimin e depozitës 3,000,000 lekë me të cilën janë paguar dy kështet e apartamentit, vlerësohet se shuma 2,000,000 lekë ka si burim dhurimet që nëna e subjektit ka marrë nga prindërit e saj në periudha të ndryshme kohore; shuma *cash* 1,000,000 lekë nga të ardhura të kursyera nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të nënës së saj.

**1.57 Sa i takon burimit “Të ardhura nga puna e prindërve”**, i cili është deklaruar si burimi i një pjese të pagesës së apartamentit, Komisioni ka analizuar më vete të ardhurat e nënës dhe të babait nga viti kur subjekti ka deklaruar të ardhurat e secilit prej prindërve dhe deri në fund të vitit 2006, kur janë kursyer shumat nga të cilat rrjedh depozita bankare 3,000,000 lekë që është përdorur si burim për blerjen e apartamentit.

**1.58 Në lidhje me të ardhurat e nënës nga punësimi**, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimin të provojë me dokumentacion të ardhurat e nënës së saj nga viti 1998, sikurse ka deklaruar. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar dokumentacionin që provon se nëna e saj ka qenë e regjistruar në ISSH, dega Korçë qysh prej vitit 1993<sup>32</sup> dhe ka paguar sigurime shoqërore nga muaji mars i vitit 1998 e në vijim. Nga të dhënat e këtij dokumentacioni, por edhe nga të dhënat e DRT Korçë që ka administruar Komisioni, rezulton se nëna e subjektit nga viti 1993 deri në fund të vitit 2006 ka ushtruar aktivitet tregtar dhe ka realizuar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në shumën totale 1,695,793 lekë<sup>33</sup>. Të ardhurat e nënës nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të saj janë trajtuar hollësisht në pikën 13 të këtij vendimi.

**1.59** Në lidhje me të ardhurat e babait nga punësimi, përveç dokumenteve të pensionit, Komisioni i kërkoj subjektit në pyetësorin nr. 2 që të provojë me dokumentacion punësimin dhe të ardhurat e përfituara gjatë tij.

**1.60** Subjekti ka depozituar disa dokumente, me të cilat provohet<sup>34</sup>: (i) punësimi dhe sigurimi i personit fizik “H. V.” për periudhat 1.7.1993 – 24.11.1993 dhe 11.5.1995 – 22.6.1995; (ii) regjistrimi si tatimpagues i personit fizik “H. V.” me kod fiskal \*\*\*, në datën 18.3.1994, me aktivitet “Transport ushqimor industrial fruta-perime” me automjetin me targë \*\*\*, tip “Saurel”, me tonazh 8.5 ton; (iii) pronësia e automjetit 8.5 ton në emër të shtetasit H. V. që nga qershori 1993; (iv) pagimi i detyrimeve tatimore nga personi fizik “H. V.” për vitin 1994; (v) mungesa e regjistrave të personit fizik për vitet 1993, 1995 – 1997, për shkak të dëmtimit të tyre gjatë trazirave të vitit 1997; (vi) punësimi i siguruar i babait në periudhën 16.9.1997 – 19.2.1999 pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (vii) përfitimi i raportit të paaftësisë nga babai në periudhën shkurt – gusht 1999 dhe pension invaliditeti në periudhën 18.8.1999 – 31.12.2022.

---

<sup>32</sup> Sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 4.10.2023, nga ISSH Korçë, znj. A.V. është e siguruar pranë personit fizik me nr. fiskal \*\*\*, për periudhën 1 shtator – 31 dhjetor 1993. Deri në mars të vitit 1998 nga ky institucion nuk ka të dhëna mbi bazën e vlerësuar/pagën e znj. A. V..

<sup>33</sup> Në këtë shumë janë përfshirë: për vitet 1993, 1998, 2001 dhe 2003 të ardhurat nga paga, sikurse pasqyruar në vërtetimin e bazës së vlerësueshme nga ISSH Korçë dhe për vitet e tjera të periudhës të ardhurat nga personi fizik sipas informacionit nga DRT Korçë, sipas tabelës përmbledhëse për të ardhurat e nënës, në pikën 17.1.

<sup>34</sup> Në përgjigjen nr. 3 të pyetësorit nr. 2: katër vërtetime nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nga DRSSH Korçë; dy fletë regjistri nga DRSSH Korçë; kërkesat datë 26.9.2023 të shtetasit H. V., dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023, e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; shkresa kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2023, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2023, e DRT Korçë; pasqyra e të ardhurave të pensionit që nga viti 1999; kartela e automjetit me targë \*\*\*.

**1.61** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në lidhje me të ardhurat nga punësimi i babait se ai për vitet 1983 – 1993 ka punuar si shofer pranë Parkut të Mallrave Korçë dhe në datën 24.6.1993 ka lidhur kontratën nr. \*\*\* për blerjen e automjetit për transport mallrash, që ai e kishte në përdorim. Gjatë viteve 1993 – 1996 ka punuar si shofer transporti pranë Minierës së Qymyrgurit \*\*\*, meqë kishte në pronësi automjetin e tonazhit të rëndë dhe pagat janë marrë me mandate, të cilat nuk i disponon sepse ka kaluar shumë kohë dhe babai i saj nuk i ka ruajtur, ndërsa miniera është shpërbërë. Për periudhën 1993 – 1999, babai ka punuar si shofer transporti edhe për individë të ndryshëm duke marrë pagesa në dorë, prandaj këto të ardhura nuk mund të provohen. Në shkurt të vitit 1999 babai është shkëputur nga puna për arsye shëndetësore dhe automjetin e ka shitur për pjesë këmbimi në periudhën 1999 – 2000, duke përfutur shumën totale 100,000 lekë, pa mandat, por me pagesë në dorë.

**1.62** Sa i takon fitimit të realizuar nga personi fizik “H. V.”, bazuar në të dhënat e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2023, të DRT Korçë dhe në ligjin e kohës, është përllogaritur xhiroja e parashikuar e këtij personi fizik. Duke konsideruar një normë fitimi prej 60% për aktivitetin e transportit, është përllogaritur edhe fitimi i personit fizik, sikurse treguar në tabelën më poshtë:

Viti	Xhiroja e përllogaritur* (lek)	Tatimi i paguar (lek)		Marzhi i fitimit	Fitimi i përllogaritur**(lek)
1993	Nuk gjenden regjistra pas trazirave të vitit 1997				
1994	2,333,333	70,000	3% <sup>35</sup>	60%	1,400,000
1995	Pagar sigurime shoqërore për periudhën maj – qershor 1995				
1996	Nuk ka paguar asnjë detyrim për sigurime shoqërore				

**1.63** Për sa më sipër, në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj janë përfshirë si të ardhura të ligjshme të ardhurat e dokumentuara, duke përfshirë në analizën financiare: (i) fitimin e personit fizik “H. V.” për ato vite kur ka të dhëna nga DRT-ja, ose kur ky fitim është e mundur të përllogaritet; (ii) pagën minimale për ato vite kur nuk ka të dhëna mbi qarkullimin ose fitimin, por personi fizik “H. V.” ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore.

**1.64** Bazuar në të gjithë dokumentacionin e administruar në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit, Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme të tij nga viti 1993 deri në fund të vitit 2006, pra ato të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e vlerave monetare, të cilat më vonë janë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2011, sikurse treguar në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Si rezultat, për periudhën 1993 – 2006, babai i subjektit të rivlerësimit ka përfutur të ardhura të dokumentuara në shumën totale 2,152,070 lekë.

Të ardhurat e dokumentuara deri në fund të vitit 2006	Në lek
1.7.1993 – 24.11.1993 (paga nga personi fizik “H. V.”)	8,183
Viti 1994, fitimi i personit fizik (i përllogaritur)	1,400,000
11.5.1995 – 22.6.1995 (paga tek personi fizik “H. V.”)	3,922
16.9.1997 – 19.2.1999 (paga tek shoqëria “****”)	114,278
Shkurt 1999 – 31.8.1999 (raport paaftësie)	29,638
Pension invaliditeti nga data 18.8.1999 deri në fund 2006	558,649
Ndihmë ekonomike nga bashkia nga data 1.8.2005 deri në fund 2006	37,400
<b>Total</b>	<b>2,152,070</b>

<sup>35</sup> Sipas ligjit nr. 7679 datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, në fuqi nga data 1.4.1993 deri më 1.4.1998, neni 3 “Llojet e veprimtarive që taten me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie”, shkronja “e” “Traktoristët, kombajnërit, zëtoristët etj., që kryejnë shërbime bujqësore, transporti etj., 3 për qind”.



**1.65** Sa i takon burimit të dytë të krijimit të apartamentit “Të ardhurat që ka përfituar nëna e subjektit me dhurim nga shitja e pronave nga prindërit e saj” (të cilat janë trajtuar hollësisht në pikën 14 të këtij vendimi), subjektit të rivlerësimit iu kërkua gjatë hetimit administrativ që të saktësojë shumën që gjyshërit i kanë dhënë nënës së saj dhe që ka shërbyer si burim për pagesën e apartamentit, si dhe dokumentacionin ligjor që provon burimin e kësaj shume.

**1.66** Në përgjigje<sup>36</sup>, subjekti ka sqaruar se nëna e saj ka përfituar ndër vite nga prindërit e saj shumën totale 3,500,000 lekë, nga të cilat vetëm 1,500,000 lekë janë përdorur në mënyrë direkte për krijimin e depozitës bankare prej 3,000,000 lekësh, në datën 11.1.2011, nga babai i saj H. V. në Intesa Sanpaolo Bank, dega Korçë. Shuma 1,500,000 lekë përbëhet nga: (i) 1,000,000 lekë si kursime që kanë qenë *cash* në banesë sipas deklarimit në DIPP-në e vitit 2008 nga prindërit e saj, nga të ardhurat prej 1,600,000 lekësh që nëna e subjektit ka marrë nga prindërit e saj në periudhën 2004 – 2006. Subjekti sqaron se shuma 1,000,000 lekë është mbajtur *cash* në banesë derisa babai i saj H. V. ka krijuar depozitën prej 3,000,000 lekësh në datën 11.1.2011 pranë Intesa Sanpaolo Bank, dega Korçë, me nr. reference \*\*\*; (ii) 500,000 lekë nëna e saj i ka përfituar gjatë periudhës 2009 – 2010 nga prindërit e vet.

**1.67** Për të verifikuar mundësinë e familjes të subjektit për të krijuar shumën prej 2.500.000 lekësh të krijuara gjatë viteve 2004 – 2006 (kursime në bankë dhe *cash*), të përdorura për blerjen e apartamentit, Komisioni ka kryer analizën financiare kumulative për periudhën 1993 – fund të vitit 2006. Sipas kësaj analize, e cila iu dërgua subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, kishte rezultuar që familja e subjektit nuk kishte fonde të mjaftueshme për të krijuar kursime/depozita në shumën 2,500,000 lekë gjatë periudhës së analizuar, për shkak të një rezultati negativ në vlerën -955,821 lekë.

**1.68 Në përfundim të hetimit administrativ**, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu ngarkua barra e provës për të provuar të kundërtën, për sa vijon:

- Duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur një mungesë fondesh në shumën - 955,821 lekë për të krijuar kursimet e tyre deri në vitin 2006, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.
- Referuar deklarimit të subjektit gjatë hetimit administrativ se shuma totale 1,500,000 lekë e tërhequr nga bankat në shkurt të vitit 2009 është mbajtur *cash* në banesë, krijohet dyshimi i arsyeshëm që kjo shumë të mos jetë pjesë përbërëse e shumës 3,000,000 lekë, të depozituar në janar të vitit 2011.
- Bazuar në këtë dyshim, arsyetohet se nëse shuma 3,000,000 lekë do të konsiderohej si një shtesë likuiditeti pjesërisht e re<sup>37</sup>, atëherë konkluzionit të Komisionit për pamundësi financiare të prindërve të subjektit në vlerën -955,821 lekë për periudhën 1993 – 2006, e cila është pothuajse sa vlera e gjendjes *cash* të krijuar dhe deklaruar nga prindërit në DIPP-në e vitit 2008, do t'i shtohet pamundësia e familjes për të krijuar një shumë të re prej 1,500,000 lekësh në vitin 2011. Kështu, pamundësia e subjektit dhe e familjes së saj për të krijuar likuiditete, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesat e apartamentit në janar 2012 dhe në prill 2013, do të ishte e barabartë me vlerën e paguar të apartamentit. Në këtë rast, do të konkludohej që duket se familja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesat e apartamentit.

<sup>36</sup> Në pyetësorin nr. 2.

<sup>37</sup> Pasi shuma *cash* prej 1,000,000 lekësh, që vjen nga DIPP-ja e vitit 2008, konsiderohet e mbajtur *cash* në vijimësi sipas shpjegimeve të subjektit.

- Të provojë bindshëm dhe qartë burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës prej 3,000,000 lekësh, të çelur nëpërmjet veprimit depozitim *cash* në datën 11.1.2011, në Raiffeisen Bank.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës për të kundërshtuar mungesën e fondeve në shumën -955,821 lekë për të krijuar kursimet e tyre deri në vitin 2006, si dhe me barrën e provës, për të provuar në mënyrë bindëse dhe të qartë burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës prej 3,000,000 lekësh**

**1.69** Në prapësime<sup>38</sup>, subjekti ka shpjeguar njësoj si gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e krijimit të shumës 3,000,000 lekë, të depozituar nga babai në ISP Bank në datën 11.1.2011, duke cituar 3 burimet: “(i) 1,500,000 lekë të depozituara në dy llogari bankare të ndryshme nga prindërit para fillimit të detyrës, që janë kursime nga puna e tyre ndër vite; (ii) 1,000,000 lekë si kursime që kanë qenë *cash* në banesë, siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008; (iii) 500,000 lekë që janë përfituar gjatë periudhës 2009 – 2010 nga nëna ime, të dhëna nga prindërit e saj”.

**1.70** Në prapësime, subjekti, duke iu referuar deklaramit që kanë bërë prindërit në DIPP-në e vitit 2008<sup>39</sup> (ku janë deklaruar dy depozitat bankare 1,000,000 lekë dhe 500,000 lekë, si dhe shuma *cash* në banesë prej 1,000,000 lekësh) ka shpjeguar se nga shuma 1,600,000 lekë që nëna e saj ka marrë dhuratë nga prindërit në periudhën 2004 – 2006 është zbritur vlera e automjetit të blerë 250,000 lekë dhe diferenca në vlerën 1,350,000 lekë ka shërbyer si burim pjesor për dy depozitat (1,000,000 lekë dhe 500,000 lekë), si dhe për gjendjen *cash* prej 1,000,000 lekësh. Pra, pasuritë e deklaruara në DIPP-në e vitit 2008 kanë pasur si burim të ardhurat nga aktiviteti tregtar dhe dhurimi i shumës 1,600,000 lekë.

**1.71** Gjatë hetimit administrativ, duke sqaruar burimet e shumës 3,000,000 lekë, që është depozituar në bankë në datën 11.1.2011, nuk ka deklaruar që kursimet në fund të vitit 2006 kanë qenë në shumën 2,500,000 lekë, për shkak se gjatë hetimit nuk mund të përcaktonte sa kanë qenë kursimet e prindërve në fund të çdo viti apo në një moment të caktuar kohe, për sa kohë ata nuk kanë qenë subjekte deklaruese.

**1.72** Në vijim, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj e ka konsideruar të gabuar ndërtimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni dhe periudhën e përlllogaritur deri në vitin 2006, për të cilën është krijuar shuma 2,500,000 lekë. Për këtë arsye, subjekti kërkon që analiza të kryhet për periudhën 1993 – 2006 për krijimin e shumës 1,500,000 lekë dhe për periudhën 2006 – 2008 për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1,000,000 lekë, periudhë gjatë së cilës ajo dhe prindërit kanë pasur ekonomi të përbashkët familjare. Subjekti kërkon që të dyja periudhat të trajtohen në mënyrë kumulative dhe rezultati negativ prej -1,051,706 lekësh të mblidhet me balancat pozitive të periudhës 5.10.2007 – 31.12.2008, të cilat janë 1,047,240 lekë.

**1.73** Këtë pretendim të saj, subjekti e mbështet në këto argumente:

- a. Në vitin 2006, ajo nuk ka qenë subjekt deklarues, prandaj nuk mund të deklaronin as ajo as prindërit e saj.
- b. Subjekti, përveç shumës 1,500,000 lekë që ka qenë në llogaritë bankare të prindërve, nuk mund të kujtojë sasinë e parave që prindërit kanë pasur në vitin 2006.

<sup>38</sup> Pika 57 e prapësimeve të subjektit.

<sup>39</sup> Pikat 15-18 të prapësimeve të subjektit.

- c. Nëse ka pasur pasaktësi në deklarinimin e burimeve, kjo ka ardhur për shkak të mungesës së një kronologjie dhe deklarimi të pasurisë së prindërve ndër vite<sup>40</sup>.
- d. Shumën prej 2,500,000 lekësh prindërit e saj e kanë deklaruar në vitet 2008 dhe 2016. Kursimet e prindërve deri në fund të vitit 2008 dhe jo në fund të vitit 2006 kanë qenë gjithsej në shumën 2,500,000 lekë.
- e. Në një ekonomi familjare është thujtë pamundur të evidentohet burimi nga i cili vjen çdo kursim, për sa kohë prindërit nuk kanë qenë subjekte deklaruese.
- f. Referimin tek vendimi nr. 20, datë 3.5.2023, i Kolegjit (paragrafët 11.4, 11.6, 11.9 e 11.11), sipas të cilit ky i fundit mban qëndrimin se: *(i) Prindërit që kanë qenë në një certifikatë familjare me subjektin, nuk kanë detyrimin për të deklaruar gjatë DPV-së; (ii) Verifikimi i mundësisë financiare të tyre për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën Vetting duhet të përfshijë edhe të ardhurat/kursimet cash, që nga analiza financiare rezultojnë si mundësi potenciale për t'u kursyer nga prindërit e subjektit, duke u bazuar në indikatorët financiarë, si të ardhurat e ligjshme që prindërit kanë pasur në dispozicion, mbulimi i kostove të jetesës, investimet e kryera dhe huat e dhëna prej tyre.*
- g. Referimin tek vendimi nr. 26, datë 3.7.2023, i Kolegjit (subjekti i rivlerësimit G. Xh., pika 14.10), ku ky i fundit mban qëndrimin se: *(i) E gjen të drejtë qëndrimin e subjektit për mosdeklarimin e pasurive të prindërve ndër vite; (ii) Në kushtet kur në rastin objekt shqyrtimi për prindërit e bashkëshortit të subjektit mungojnë DIP-të periodike, të cilat janë dokumenti i vetëm nga ku mund të evidentohen kursimet cash, Kolegji konsideron të arsyeshme dhe të drejtë që analiza për familjen e subjektit të bëhet duke përllogaritur mundësinë për kursim të prindërve të personit të lidhur, si para martesë, ashtu edhe pas martesë, deri në fund të vitit 2016, para plotësimit të deklaratës së pasurisë Vetting, në funksion të përllogaritjes së burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes cash prej 900,000 lekësh, të deklaruar në të.*

**1.74** Subjekti konkludon se analiza financiare mbi mundësinë e kursimeve në shumën 2,500,000 lekë deri në fund të vitit 2006 ka sjellë mospërfshirjen në këtë analizë të mundësisë së kursimeve në fund të vitit 2007 dhe 2008, periudhë gjatë së cilës subjekti dhe prindërit kanë pasur ekonomi të përbashkët familjare.

**1.75** Në përfundim, për këtë pikë, subjekti pretendon se pavarësisht që analiza financiare deri në fund vitin 2006 paraqet rezervë në përllogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i babait dhe nënës dhe nëse merret në konsideratë kjo analizë e përllogaritur nga Komisioni deri në fund të vitit 2008, moment në të cilin prindërit e saj kanë deklaruar kursimet *cash* në shumën 1,000,000 lekë, duke pasur kursime gjithsej në shumën 2,500,000 lekë, prindërit rezultojnë me balancë pozitive.

**1.76** Në vijim të kundërshtimit të analizës së kryer nga Komisioni, subjekti kundërshtoi mënyrën se si janë përllogaritur disa të ardhura, prandaj kërkoi të rishikohen të ardhurat e babait për vitin 1993 dhe në analizën financiare të përfshihen:

i) Fitimi neto në shumën 500,000 lekë, i realizuar në vitin 1993 – Subjekti ka sjellë në vëmendje edhe një herë disa fakte dhe dokumente, të cilat i ka paraqitur pranë Komisionit gjatë hetimit

---

<sup>40</sup> Kolegji në vendimin nr. 37, datë 24.11.2021 nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se: *“Pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Në të kundërt, pasaktësitë e pretenduara në deklarinimet periodike nuk mund të shërojnë dhe as të shpjegojnë mungesën e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare që bëhet mbështetur mbi këto deklarime, e cila mbetet dhe konsiderohet si shkak shkarkimi sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

administrativ, duke theksuar se ajo ka provuar se babai i saj ka punuar si person fizik në mënyrë të ligjshme për vitet 1993 – 1997, por që ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të dokumentuar të ardhura për disa vite të kësaj periudhe, sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Përlllogaritja e të ardhurave për periudhën 5-mujore të bëhet bazuar në tatimet e paguara gjatë vitit 1994, me arsyetimin se tatimet e vitit 1994 janë bazuar në qarkullimin 2 milionë lekë për vitin 1993 dhe marzhin e fitimit të përdorur nga Komisioni.

ii) Shuma 100,000 lekë e ardhur nga shitja e mjetit tip “\*\*\*\*” 8.5 ton, shitur për skrap në vitet 1999 – 2000 pa akt noterial, duke kujtuar se në kohën e shitjes e ardhura nga shitja për skrap nuk ka qenë e tatueshme<sup>41</sup>.

**1.77** Për të ardhurat e babait, subjekti kërkon që të mbahet në konsideratë edhe vendimi nr. 6, datë 17.3.2022, i Kolegjit (paragrafi 22)<sup>42</sup>, sipas të cilit mungesa e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë këtu të ardhurat për të cilat organet tatimore nuk disponojnë të dhëna që konfirmojnë pagimin e tatimit, ndërkohë që provat tregojnë se subjekti ka kryer aktivitetin në përputhje me kuadrin ligjor të kohës, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**1.78** Gjithashtu, subjekti kërkon që të rishikohen nga Komisioni të ardhurat e nënës nga aktiviteti privat dhe, konkretisht, të ripërlllogaritet marzhi mesatar për vitet 2008 – 2016, vite kur disponohen të dhëna mbi qarkullimin dhe fitimin e personit fizik “A. V.”, por pa përfshirë vitin 2010, pasi fitimi i këtij viti është krahasimisht i ndryshëm nga fitimet neto të realizuara në vitet e tjera. Duke përdorur të njëjtat të dhëna dhe metodologji me atë të Komisionit, subjekti ka kryer përlllogaritjet sikurse kërkon, nga ku ka rezultuar një marzh fitimi në masën 17.64%. Në vijim, këtë marzh të ri e ka aplikuar edhe në periudhën 1998 – 2007, nga ku rezultojnë fitime vjetore më të larta se ato të përlllogaritura nga Komisioni.

**1.79** Gjithashtu, subjekti ka vërejtur se për vitet 2000 dhe 2002 Komisioni ka përlllogaritur të ardhura nga paga dhe jo fitim neto, me argumentin se nuk ka të dhëna të konfirmuara nga organet tatimore për pagesën e detyrimeve tatimore. Subjekti prapëson analizën e Komisionit, duke pretenduar se ushtrimi i aktivitetit nga nëna ka qenë në mënyrë të pandërprerë dhe se në këto periudha konfirmohet ushtrimi i aktivitetit të saj si ambulante, pasi ka marrë karton ambulant në datat 5.4.2000 dhe 21.2.2002, prandaj kërkon që Komisioni të përlllogarisë “fitimin neto” dhe jo “pagën neto” të derdhur si person fizik për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

**1.80** Në përfundim të të gjitha prapësimeve si më lart, subjekti pretendoi se në analizën financiare deri në fund të vitit 2006, duke marrë në konsideratë ndryshimin e disa zërave në të ardhurat nga aktiviteti i babait dhe nënës, përfshirjen e të ardhurave nga shitja e automjetit për skrap, si dhe

---

<sup>41</sup> Shkronja “g”, “Të ardhura të tjera” është shtuar në paragrafin 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, në vitin 2004, sipas ndryshimeve që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003.

<sup>42</sup> “Kolegji mban në konsideratë faktin se, megjithëse provat e disponueshme nga institucionet shtetërore nuk konfirmojnë legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara prej subjektit, duke qenë se në organet tatimore kompetente nuk disponohen të dhëna që konfirmojnë pagimin e tatimit, duke qenë se provat sugjerojnë që subjekti ka qenë një avokat aktiv dhe gjasat janë që ai e ka kryer aktivitetin në përputhje me kuadrin ligjor të kohës dhe në mungesë të ndonjë treguesi që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit, me deklarin e të ardhurave të tilla, ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, vlerëson se kjo situatë faktike nuk çmohet se është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt i cili të prodhojë për subjektin e rivlerësimit si pasojë vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. Mungesa e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare e kryer në Kolegji, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga avokatia, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

duke përfshirë në analizën financiare që pasuria “Likuiditete në bankë dhe *cash*” është në shumën 2,500,000 lekë, analiza rezultoi me një balancë negative në shumën -12,917 lekë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.81** Në lidhje me sa subjekti pretendoi në prapësime që analiza financiare të shtrihet në periudhën 1993 – 2006 për krijimin e shumës 1,500,000 lekë dhe në periudhën 2006 – 2008 për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1,000,000 lekë, së pari Komisioni vlerëson të mbajë parasysht vendimin nr. 20, datë 3.5.2023, të Kolegjit, i cili mban qëndrimin se *mundësia potenciale për kursime që rezulton nga analiza financiare duhet të përfshihet si mundësi kursimi*. Ky qëndrim i Kolegjit vlen të aplikohet në rastin tonë, edhe pse znj. Sonjela Voskopi si subjekt deklarues nuk ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash* në fund të vitit 2007<sup>43</sup> por, nga ana tjetër, prindërit e saj kanë deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2008.

**1.82** Në rezultatet e hetimit, Komisioni kishte marrë parasysht të gjitha deklaratimet e subjektit dhe prindërve të saj në lidhje me këtë çështje, nga leximi i të cilave dukej se krijimi i depozitave përkonte me periudhën deri në fund të vitit 2006. Por, në vijim të parashtrimeve të subjektit, duke marrë parasysht disa rrethana që subjekti me të drejtë i sjell në vëmendje të Komisionit, si dhe duke u bazuar në argumentimet e sjella në vendimin nr. 20, datë 3.5.2023, të Kolegjit, Komisioni çmon të mbajë në konsideratë si vijon:

i) Bazuar në deklarinim e prindërve në deklaratën *Vetting* për vitin 2008, si dhe në deklarinimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, bëhet e qartë që shuma 2.5 milionë lekë, në bankë dhe *cash*, është disponuar prej prindërve të subjektit në fund të vitit 2008. Gjithashtu, evidentohet se burimet e deklaruara për krijimin e kësaj vlere janë dhuratat e gjyshërve të subjektit dhe kursimet nga puna e prindërve të saj.

ii) Gjatë periudhës së krijimit të depozitave, subjekti ka qenë studente dhe, si e tillë, nuk ka qenë subjekt deklarues, për më tepër as prindërit e saj.

iii) Për shkak të kohës shumë të largët që ka kaluar që nga krijimi i vlerave monetare në fjalë, është praktikisht e vështirë të kujtohet vlera e parave *cash* që kanë pasur prindërit në një vit të caktuar, në rastin konkret të mund të përcaktohet me saktësi nëse gjendja *cash* i takon vitit 2006 apo dy viteve në vijim.

iv) Gjithashtu, për të përcaktuar se cili është burimi i saktë i secilës prej shumave që përbëjnë shumën 2.5 milionë lekë, dhe konkretisht i shumës 1.5 milionë lekë që ndodhet në bankë dhe 1 milion lekë që ndodhet *cash* në banesë, është e vështirë. Kjo, jo vetëm për shkak të një kohe shumë të largët që ka kaluar, por edhe sepse paratë janë sende gjenerikisht dhe jo individualisht të përcaktuara e, si të tilla, është e pamundur të përcaktohet cilat para janë përdorur për çfarë.

v) Për të përcaktuar kohën e posedimit të vlerës 2.5 milionë lekë dhe burimin nga i cili rrjedh çdo shumë, vjen në ndihmë deklaratat e prindërve për vitin 2008 pasi, pavarësisht se ky deklarinim nuk ka qenë një detyrim ligjor, ai ekziston dhe merret në konsideratë në cilësinë e provës. Nga ai evidentohet se prindërit e subjektit kanë pasur gjithsej likuiditete në bankë dhe *cash*, në vlerën 2.5 milionë lekë, në fund të vitit 2008. Gjithashtu, Komisioni gjen se burimi për krijimin e depozitave bankare në vlerën 1.5 milionë lekë vjen nga dhuratat e gjyshërve dhe për gjendjen *cash* prej 1 milion lekësh vjen nga të ardhurat e prindërve nga puna.

---

<sup>43</sup> Në përgjigje të pyetjes nr. 2 të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës që ka jetuar me prindërit, nga të ardhurat e saj, përveç shumave që në fund të çdo viti figurojnë në bankë dhe që kanë qenë kursimet e saj personale, apo për mbulimin e ndonjë shpenzimi (udhëtim/pushime), pjesën tjetër të të ardhurave i ka dorëzuar në familje, pasi në përditshmëri administrimin e të ardhurave dhe mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe nevojat familjare e bënin prindërit.

vi) Në lidhje me burimet, deklaratimet e mëvonshme janë kontradiktore: ato përcaktojnë se si burim për depozitat janë kursimet e prindërve dhe se depozitat janë krijuar brenda vitit 2006 dhe si burim për shumën *cash* janë dhuratat e gjyshërve të dhuruara brenda vitit 2006. Sidoqoftë, fakti që deklarimi i prindërve për vitin 2008 është një deklaram/dokument i kohës, e bën atë më të vërtetë dhe më pranë realitetit.

vii) Kështu, shuma 2.5 milionë lekë është krijuar dhe është gjendje në bankë dhe *cash* brenda vitit 2008, me burim të ardhurat e gjyshërve deri në vitin 2006 dhe kursime të prindërve deri në vitin 2008. Si të tilla, Komisioni nuk mund të përjashtojë mundësinë kursyese të prindërve të subjektit gjatë viteve 2007 e 2008, derisa deklarimi për kursime i tyre ka ndodhur në datën 31.12.2008.

viii) Ndërtimi i analizës financiare të subjektit dhe familjes së saj mund të përdorë metodologjinë kumulative deri në datën 5.10.2007, datë kur subjekti është emëruar në detyrë. Ndërsa për periudhën 5.10.2007 deri në fund të vitit 2008, ajo ka qenë e emëruar në detyrë dhe nuk mund të analizohet në bazë të metodologjisë kumulative. Por, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për prindërit e saj me të cilët ajo ka bashkëjetuar deri në fund të vitit 2014.

ix) Prindërit e subjektit kanë marrë statusin e personit të lidhur vetëm me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe ata, sa i përket analizës së likuiditeteve *cash*, nuk mund të analizohen me të njëjtin standard si subjektet me detyrim deklarues ndër vite për gjendjet *cash*<sup>44</sup>. Kështu që, meqenëse vitet 2007 dhe 2008 kanë rezultuar pozitive nga analiza financiare e tyre, atëherë kjo mundësi për kursime, e krijuar nga bashkëjetesa në një ekonomi të përbashkët me subjektin, do të mbartet si kursim i akumuluar nga ana e prindërve deri në fund të vitit 2008.

**1.83** Bazuar në të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni gjykon që pretendimi i subjektit se nuk duhen lënë jashtë analizës financiare vitet 2007 e 2008, kur familja ka vazhduar t'i krijojë kursimet *cash* me burime të ligjshme<sup>45</sup>, qëndron.

**1.84** Për këtë arsye, është kryer analiza financiare e rishikuar për periudhën 1993 deri në fund të vitit 2008, duke përdorur metodologjinë kumulative. Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur mundësi për të krijuar shumën 2,500,000 lekë në banka dhe *cash*, deri në fund të vitit 2008, për shkak të një balance pozitive në vlerën 54,711 lekë<sup>46</sup>. (shihni tabelën në fund të kriterit të pasurisë).

**1.85** Në lidhje me prapësimet e subjektit që ka kundërshtuar përlllogaritjen e kryer nga Komisioni për të ardhurat nga aktiviteti i babait dhe ka kërkuar që të njihen të ardhurat e babait të saj nga puna e tij si person fizik vetëm për vitin 1993, në masën 500,000 lekë, ky pretendim nuk mund të merret parasysh nga Komisioni, pasi: (i) Fakti që babai i subjektit ka paguar sigurime shoqërore për disa muaj të vitit 1993, nuk i bën këto të ardhura të ligjshme, ndërsa pagesa e tatimit për këto të ardhura, po; (ii) Mungesa e të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, për shkak të trazirave të vitit 1997, do të kishte pasjellë humbjen/prishjen/asgjësimin e disa viteve rresht ose e të gjithë dosjes së personit fizik "H. V.", ndërkohë që në dosjen tatimore ekzistojnë të dhëna për vitin 1994, duke kapërcyer vitin 1993 e pastaj vitet 1995 dhe 1996. Nisur nga ky fakt, por edhe për shkak të kaosit që ka mbizotëruar gjatë periudhës, duket se probabiliteti për mospagim i detyrimeve tatimore është më i lartë se mungesa e të dhënave për vitin 1993, pra ka më shumë gjasa që subjekti të mos ndodhet në kushtet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Pavarësisht se ka dokumentacion që tregon se babai i subjektit ka punuar privatisht me kamionin e tij, në mënyrë të

<sup>44</sup> Vendim nr. 20, datë 3.5.2023, paragrafi 11.9.

<sup>45</sup> Mundësia për kursime e llogaritur nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ për vitin 2007 ishte +386,042 lekë dhe për vitin 2008 ishte 661,198 lekë.

<sup>46</sup> Në fakt, kjo shifër është shumatorja e analizës 1993 – 5.10.2007 + 5.10.2007 deri në 31.12.2007 + viti 2008 + tepricat e kursimeve të subjektit, e cila gjatë Shkollës së Magjistraturës u analizua më vete, me të ardhurat, likuiditetet dhe qiranë e saj.

vijueshme, përveç disa pagesave sporadike<sup>47</sup> të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për efekt pensioni, qarkullimi dhe fitimi i personit fizik për vitet 1993, 1995 – 1996, jo vetëm që janë të pamatshme nga ana sasiore, por nuk ekziston as *indicie* që mund të jenë paguar tatimet mbi to.

**1.86** Për të konkluduar, Komisioni çmon se të ardhurat e babait të subjektit mbeten ato të cilat janë të dokumentuara dhe që janë konsideruar nga Komisioni në analizën financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit. Sa i takon të ardhurave të tjera të padokumentuara, por të pretenduara nga subjekti, Komisioni vlerëson se ka *indicie* që tregojnë se babai subjektit ka ushtruar aktivitet privat, por ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare; nga ana tjetër nuk mund të thuhet që këto të ardhura nuk ekzistojnë. Nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk mund të penalizohet për pamundësi financiare të prindërve, nëse do të ishte rasti, që rrjedh nga mosmarrja parasysh e këtij pretendimi.

**1.87** *Në lidhje me prapësimet e subjektit që ka kundërshtuar përllogaritjen e kryer nga Komisioni për të ardhurat nga aktiviteti i babait dhe ka kërkuar që të përfshihen në analizë të ardhurat e babait nga shitja për skrap e automjetit tip “Saurel” 8.5 ton, Komisioni vlerësoi që në analizën financiare nuk mund të përfshihet as blerja dhe as shitja e këtij automjeti, sepse për asnjë nga këto veprime subjekti nuk ka depozituar akt shkresor as më parë, as në prapësime.*

**1.88** *Në lidhje me pretendimin e subjektit në prapësime që të rishikohen nga Komisioni të ardhurat e nënës nga aktiviteti privat, duke e përllogaritur marzhin e fitimit pa fitimin e vitit 2010, Komisioni çmon se ky pretendim bazohet në një metodë statistikore, e cila përdoret për të bërë parashikime dhe planifikime ekonomike me synimin për të shmangur *bias* (gabimet në parashikim) dhe jo për të matur të ardhura reale të cilat janë të deklaruara nga vetë subjektet tregtare dhe të verifikuara nga organet tatimore. Subjekti nuk ka dhënë asnjë arsye përse viti 2010 është i ndryshëm nga vitet e tjera, pasi vetëm në rast se do të kishte arsye nga shkaqe madhore apo objektive, atëherë ky vit mund të përjashtohet nga përllogaritjet, pasi ai do të ishte një shmangie nga vitet e tjera dhe nuk do të shërbente për të treguar trendin e vërtetë të ecurisë së të ardhurave të biznesit.*

**1.89** Nga verifikimi i deklaratave të përcjella nga Zyra e Tatimeve Korçë për vitin 2010, nëna e subjektit ka deklaruar shpenzime shumë të larta, të cilat duket të jenë investime në biznesin e saj. Prandaj ky vit nuk është i veçantë në kuptimin që përcjell subjekti, por është një vit investimi për personin fizik e, për këtë arsye, ai nuk ka përse përjashtohet nga përllogaritja e marzhit mesatar të fitimit.

**1.90** Për më tepër, duke përdorur marzhin e fitimit të përllogaritur nga Komisioni, i cili përfshin edhe vitin 2010, shuma e të ardhurave totale të përfituara nga nëna e subjektit gjatë periudhës kur subjekti ushtron detyrën është shumë e përafërt me të ardhurat e deklaruara prej nënës së subjektit në deklaratën *Vetting*, të ardhura të cilat janë objekt verifikimi.

**1.91** *Në lidhje me pretendimin e subjektit në prapësime, që në kuadër të këtij rishikimi të analizës financiare të nënës nga aktiviteti privat për vitet 2000 dhe 2002, të përllogaritet fitimi neto dhe jo pagat, Komisioni vëren se ka një gabim në atë çka evidenton subjekti, pasi Komisioni ka përllogaritur xhiro dhe fitim, përkatësisht për vitet 2000 dhe 2002, pikërisht sepse ka pasur *indicie* që nëna e subjektit ka ushtruar aktivitet meqenëse për të marrë karton ambulant në këto vite duhej që subjekti tregtar të kishte shlyer të gjitha detyrimet ndaj shtetit. Nga ana tjetër, në formatin Excel të analizës financiare, subjekti ka propozuar që tek të ardhurat të përfshihet fitimi nga biznesi për vitet 2001 dhe 2003, vite për të cilat ishin vendosur pagat minimale. Pra, duket se subjekti ka bërë*

---

<sup>47</sup> Pagesa në ISSH 5 muaj për vitin 1993 dhe 2 muaj për vitin 1995.

një lapsus, duke evidentuar si vite me pagë minimale dhe jo fitim, në vend të viteve 2001 dhe 2003.

**1.92** Sa i takon viteve 2001 dhe 2003, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare pagën minimale të përlogaritur nga Sigurimet Shoqërore, pasi për këto dy vite nuk ka asnjë informacion tjetër, qoftë edhe të tërthortë, që të tregojë se personi fizik “A. V.” ka paguar detyrimet pranë organeve tatimore.

**1.93** Për këto arsye, Komisioni nuk i mori në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të kryer rillogaritjen e të ardhurave të babait dhe të nënës.

**1.94** Për gjithë sa më lart, Komisioni, pasi mori në konsideratë disa prej pretendimeve dhe rrethanave që parashtrioi subjekti, dhe duke i çmuar ato nën dritën e vendimit nr. 20, datë 3.5.2023, të Kolegjit, rishikoi analizën financiare për periudhën 1993 deri në fund të vitit 2008, duke përdorur metodologjinë kumulative, dhe arriti në përfundimin se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi për të krijuar shumën 2,500,000 lekë deri në fund të vitit 2008, duke rezultuar me një balancë pozitive në vlerën 54,711 lekë.

**1.95 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit ndaj konkluzionit “Referuar deklaramit të subjektit gjatë hetimit administrativ se shuma 1,500,000 lekë, e tërhequr nga bankat në shkurt të vitit 2009, është mbajtur *cash* në shtëpi, krijohet dyshimi i arsyeshëm që kjo shumë të mos jetë pjesë përbërëse e shumës 3,000,000 lekë, të depozituar në janar të vitit 2011”**

**1.96** Subjekti në prapësime pretendoi se ky konstatim është i gabuar, pasi depozitat e tërhequra në shkurt të vitit 2009, në vlerën 1,500,000 lekë, janë mbajtur *cash* deri në datën 11.1.2011 dhe i përkasin depozitimit të shumës 3,000,000 lekë. Për këtë, subjekti shpjegoi se pas momentit të depozitimit të shumës 3,000,000 lekë, prindërit mund të kenë pasur kursime *cash* në vlera të vogla, por meqë prindërit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, ajo nuk mund të përcaktojë sa kanë qenë kursimet *cash* të prindërve në fund të vitit 2010, apo në momentin e depozitimit të shumës në datën 11.1.2011. Megjithatë, nga analiza financiare e viteve 2009 dhe 2010 rezulton se prindërit mund të kenë pasur mundësi të kursejnë në *cash* përtej kursimeve të përlogaritura nga Komisioni, përkatësisht në vlerën 259,312 lekë në vitin 2009 dhe 269,677 lekë në fund të vitit 2010. Pra, duke qenë se gjatë vitit 2009, kur janë mbyllur dy depozitat dhe deri në datën 11.1.2011, kur u krijua depozita 3,500,000 lekë, familja rezulton me bilanc pozitiv dhe me mundësi kursimi, si rrjedhim nuk ka pasur shkak që të konsumojë/harxhojë prej shumës 1,500,000 lekë, pasi përveç shpenzimeve jetësore nuk ka kryer asnjë shpenzim në pasuri të paluajtshme ose investim tjetër.

**1.97** E pyetur gjatë seancës gjyqësore për arsyen pse prindërit i tërhoqën depozitat nga bankat në vitin 2009 dhe i mbajtën *cash* në banesë deri në vitin 2011, kur babai depozitoi në bankë shumën 3 milionë lekë, subjekti shpjegoi se nuk e ka kuptuar logjikën ekonomike të prindërve pse e kanë tërhequr këtë shumë të madhe në vitin 2009 dhe, pavarësisht se i ka pyetur, ata nuk kujtojnë dot detaje, por në kujtesën e saj dhe të prindërve ka qenë një diskutim mbi frikën e falimentimit të Bankës Amerikane, ku kanë qenë të depozituara këto para. Ndërsa ridepozitimi në vitin 2011 është bërë sepse interesat bankarë në atë periudhë ishin të larta.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.98** Duke u nisur nga shpjegimet e subjektit në seancën gjyqësore në lidhje me arsyet përse prindërit e saj kanë tërhequr depozitat nga bankat dhe i kanë mbajtur *cash* në banesë për t'i ridepozituar në vitin 2011, Komisioni ka konstatuar nga informacioni mediatik se Banka Amerikane e Shqipërisë – ABA (themeluar në vitin 1998), në të cilën ka qenë depozituar shuma 1,000,000 lekë është blerë në vitin 2008 nga Intesa Sanpaolo Bank Albania (ISP Bank) dhe në vitin 2009 ka shitur edhe 20% të aksioneve të fundit tek kjo bankë.



**1.99** Për më tepër, është një fakt botërisht i njohur që kriza e madhe financiare e cila nisi në SHBA<sup>48</sup>, ishte një ngjarje e cila pati një impakt të jashtëzakonshëm në tregjet financiare në të gjithë botën. Ajo u reflektua pothuaj menjëherë nga disa shtete, midis të cilave Greqia ishte nga të parat, gjë që nuk mund të mos afektonte në mënyrë in/direkte tregun bankar shqiptar<sup>49</sup>. Kështu, edhe në Shqipëri, në vitet 2008 dhe 2009 ka pasur lëvizje në tregun bankar shqiptar, sikurse hyrja e ISP Bank në Shqipëri pas një lëkundjeje të saj në shtetin mëmë, arsye këto që kanë shkaktuar panik në radhët e klientëve depozitues të bankave të nivelit të dytë.

**1.100** Pra, shpjegimet e subjektit në lidhje me veprimet e prindërve të saj për të tërhequr depozitën nga Banka Amerikane e Shqipërisë dhe për t'i mbajtur në banesë, përkojnë me situatën në të cilën ndodhej tregu bankar në atë periudhë.

**1.101** Sa i takon ridepozitimit të shumës 3,000,000 lekë në janar të vitit 2011, përsëri në ISP Bank, pjesë e së cilës duket se janë edhe dy depozitat e mbajtura *cash* në banesë nga shkurti i vitit 2009, sikurse ka pretenduar subjekti, duket se edhe ky veprim lidhet me rifitimin e besimit tek kjo bankë, pasi u pa që nuk pati asnjë falimentin të saj dhe madje të asnjë prej bankave të nivelit të dytë në tregun vendas. Gjithashtu, disa banka i rritën përqindjet e interesave të depozitave në pjesën e dytë të vitit 2010, për të tërhequr përsëri klientët e humbur në periudhat e krizës së madhe. Në lidhje me interesat bankarë të ofruara nga ISP Bank, nga verifikimi i bërë në të dhënat e kohës ka rezultuar se interesat e vitit 2011 kanë qenë rreth 5%, pra mjaft të kënaqshme.

**1.102** Nisur nga këto fakte, shpjegimet e subjektit në lidhje me arsyet e tërheqjes së dy depozitave nga bankat në shkurt të vitit 2009, për t'i mbajtur *cash* dhe për t'i ridepozituar në vitin 2011, duken se qëndrojnë, pasi përputhen me situatën e tregut dhe të vetë Bankës Amerikane në atë kohë. Për më tepër, faktet që familja nuk ka pasur asnjë investim madhor gjatë viteve 2009 – 2010, si dhe analiza e këtyre viteve ka rezultuar me bilanc pozitiv, tregojnë se prindërit kanë pasur fonde të mjaftueshme për të jetuar dhe përballuar çdo shpenzim tjetër, duke pasur kështu mundësi t'i mbajnë kursimet e tyre *cash* në banesë, të paprekura.

**1.103** Në vendimin nr. 20, datë 3.5.2023 (pika 11.4), Kolegji mban qëndrimin se: *“Prindërit e subjektit kanë fituar statusin e personit të lidhur me të, vetëm me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe vetëm pas këtij momenti atyre dhe subjektit u kanë lindur detyrime për të deklaruar pasuritë e tyre dhe justifikimin e ligjshmërisë së krijimit të tyre, sipas modelit të shtojcës nr. 2 të këtij ligji. Në vlerësimin e Kolegjit, fakti që ai nuk ka deklaruar në këto deklarata gjithçka që lidhet me pasuritë, të drejtat apo detyrimet e familjarëve të tij, sa kohë që ligji nuk e detyronte ta bënte këtë, nuk duhet të prezumojë të kundërtën se këto pasuri nuk kanë ekzistuar dhe se subjekti nuk mund t'i provojë ato nëpërmjet dokumentacionit ligjor... Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se provueshmëria e likuiditeteve cash do të duhet t'i nënshtrohet analizës së çdo të dhëne që vjen për to me deklaratën Vetting, si edhe me provat bashkëlidhur saj, ashtu edhe nga provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, por edhe duke vlerësuar shpjegimet e subjektit, ...të dhënat që vijnë nga DPV-të, në të cilat subjekti ka bërë deklarime në tejkallim të ligjit për pasuritë e tyre do të shërbejnë për t'u analizuar së bashku me gjithë të dhënat e tjera që janë përftuar”.*

**1.104** Referuar këtij vendimi të Kolegjit, Komisioni vlerësoi që për të provuar ekzistencën e likuiditeteve *cash* në banesë për periudhën 2009 – 11.1.2011, të marrë në konsideratë deklarinë subjektit dhe prindërve të saj në deklaratën Vetting, deklarinë në DIPP-në e vitit 2008, deklarinë e subjektit gjatë hetimit administrativ<sup>50</sup>, shpjegimet e dhëna prej saj në prapësime dhe gjatë seancës gjyqësore, informacionin nga bankat në lidhje me lëvizjen e depozitave, si dhe informacionet

<sup>48</sup> Fillimi i krizës u shënua me falimentimin e kolosit financiar \*\*\* në shtator të vitit 2008.

<sup>49</sup> Në vitet 2008 – 2010, në Shqipëri kanë operuar 3 banka greke: NBK Bank, Alpha Bank, Tirana Bank.

<sup>50</sup> Në pyetësorin nr. 2.

publike në lidhje me krijimin dhe aktivitetin e ABA Bank dhe ISP Bank në sistemin bankar në Shqipëri.

**1.105** Këto fakte në tërësinë e tyre janë relevante me një rrjedhë kronologjike dhe provojnë në mënyrë bindëse rrjedhën e veprimeve që kanë kryer prindërit e subjektit në lidhje me krijimin dhe administrimin e shumës 3,000,000 lekë, pjesë e së cilës është edhe mbajtja *cash* e shumës 1,500,000 lekë në periudhën shkurt 2009 – 11.1.2011.

**1.106** Për sa më lart, në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se shuma 1,500,000 lekë, e tërhequr nga bankat në shkurt të vitit 2009, është mbajtur *cash* në banesë dhe kjo shumë është pjesë përbërëse e shumës 3,000,000 lekë, të depozituar në janar të vitit 2011.

#### **Në lidhje me mobilimin e apartamentit**

**1.107** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim: (i) gjatë vitit 2015, vlerat 1,300,000 lekë nga kursimet e saj dhe 700,000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit; (ii) gjatë vitit 2016, vlerat 400,000 lekë nga kursimet e saj dhe 300,000 lekë nga kursimet e bashkëjetuesit.

**1.108** Këto shpenzime janë deklaruar edhe në DIPP-të përkatëse të viteve 2015 e 2016, por në DIPP-në e vitit 2016 bashkëjetuesi ka deklaruar pakësim të gjendjes monetare *cash* me 300,000 lekë, të cilat janë shpenzuar, por nuk ka specifikuar llojin e shpenzimeve.

**1.109** Komisioni hetoi për shpenzimin e mobilimit të kryer në vitin 2015. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar mbylljen e dy depozitave në datën 9.12.2014 pranë Union Bank, dega Korçë dhe tërheqjen e shumës totale prej 508,500 lekësh, principal + interesa, nga të cilat 500,000 lekë i ka gjendje *cash* në banesë. Në datën 23.9.2014 ka tërhequr shumën 800,000 lekë pranë arkës së Union Bank, dega Korçë, të cilën deklaroi se e ka në gjendje *cash* në banesë.

**1.110** Pra, evidentohet se në fund të vitit 2014 subjekti ka pasur gjendje *cash* në banesë shumën 1,300,000 lekë. Pavarësisht se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti nuk ka deklaruar “Pakësim të *cash*-it me 1,300,000 lekë”, ajo ka deklaruar të njëjtën shumë si të shpenzuar për mobilimin e apartamentit në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme”. Pra, duket se burimi i shumës së shpenzuar gjatë vitit 2015 janë kursimet *cash* të vitit paraardhës. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive të subjektit në Union Bank ka rezultuar se deklaratimet e subjektit janë të sakta<sup>51</sup>.

**1.111** Pra, shuma prej 1.3 milionë lekësh e shpenzuar për mobilim nga subjekti ka burim të ligjshëm, pasi është krijuar me kursime nga paga. Ndërsa për shumën 700,000 lekësh të shpenzuar nga bashkëjetuesi, në deklaratën *Vetting* janë deklaruar si burim kursimet e tij gjatë vitit 2015.

**1.112** Nga analiza financiare e vitit 2015, ku u përfshinë vetëm subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, ka rezultuar se në këtë vit ata nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, për shkak të balancës negative 533,919 lekë.

**1.113** Komisioni hetoi për shpenzimin e mobilimit të kryer në vitin 2016, të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, në vlerat përkatëse 400,000 lekë dhe 300,000 lekë (nga kursimet e secilit).

---

<sup>51</sup> Në dhjetor të vitit 2009, subjekti ka çelur një depozitë në shumën 250,000 lekë; në maj të vitit 2010 ka çelur një depozitë me afat në shumën 150,000 lekë. Të dyja depozitat janë investuar dhe rinvestuar disa herë deri në dhjetor të vitit 2014, kur edhe janë tërhequr së bashku me interesat e përfituar prej tyre ndër vite. Ndërsa shuma 800,000 lekë është rezultat i pagave të kursyera/të patërhequra të viteve 2013 dhe 2014 dhe është tërhequr në datën 23.9.2014.

**1.114** Në DIPP-në e vitit 2016<sup>52</sup>, subjekti ka deklaruar shpenzime për mobilim banese në shumën 400,000 lekë, si dhe pakësim të gjendjes *cash* të vitit të mëparshëm në vlerën 400,000 lekë<sup>53</sup>.

**1.115** Po ashtu, bashkëjetuesi i saj ka deklaruar<sup>54</sup> “Pakësim të gjendjes monetare *cash* me 300,000 lekë”, por nuk ka përmendur shpenzime mobilimi në deklarimin e tij për vitin 2016.

**1.116** Sa i takon mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëjetuesit të saj për kryerjen e shpenzimeve të mobilimit në vitet 2015 e 2016, Komisioni në rezultatet e hetimit të dërguara subjektit kishte kryer analizën financiare, sipas së cilës ishte konkluduar se: (i) subjekti ka pasur mundësi të kursejë shumën 1,300,000 lekë gjatë vitit 2014 për t’i investuar në vitin 2015 për mobilimin e apartamentit, për shkak të një balance negative të papërfillshme prej -10,386 lekësh; (ii) çifti nuk ka pasur mundësi të krijojë shumën prej 700,000 lekësh për mobilim në vitin 2015, deklaruar si pjesëmarrje e bashkëjetuesit, për shkak të një balance negative prej -533,919 lekësh; (iii) kanë pasur mundësi të investojnë për mobilim shumën 700,000 lekë gjatë vitit 2016<sup>55</sup>.

**1.117** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ngarkoi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 700,000 lekë për mobilim në vitin 2015.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.118** Në prapësimet e saj lidhur më barrën e provës, subjekti ka pretenduar se ndërtimi i analizës financiare nga Komisioni për vitin 2014, ku rezulton se subjekti dhe prindërit kanë pamundësi në shumën -10,386 lekë, është i gabuar dhe në kundërshtim me qëndrimin e Kolegjit në vendimet nr. 20, datë 3.5.2023 dhe nr. 26, datë 3.7.2023, pasi nuk është marrë në konsideratë mundësia potenciale për kursime e familjes së saj në periudhat e mëparshme.

**1.119** Në lidhje me balancën negative -533,191 lekë, që ka rezultuar në vitin 2015, subjekti ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, i cili në analizën financiare të këtij viti nuk ka përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore të dhuruara prej prindërve të bashkëjetuesit, por ka reduktuar shpenzimet e jetesës të saj dhe bashkëjetuesit. Në përfundim, subjekti kërkon të bëhet korrigjimi i analizës financiare, duke përfshirë të ardhurat në shumën 500,000 lekë që bashkëjetuesi ka marrë prej prindërve të tij nga produktet bujqësore dhe duke mos bërë reduktim të shpenzimeve të jetesës. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare të rishikuar për vitin 2015, sipas së cilës ka rezultuar me një pamundësi financiare të zvogëluar në -252,363 lekë. Subjekti gjithashtu kërkon që bazuar në parimet e objektiviteti dhe proporcionalitetit, kjo balancë negative të mos përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj saj. *(Për argumentet e tjera që subjekti ka paraqitur në prapësime dhe për vlerësimin e Komisionit në lidhje me këto prapësime, referojuni pikës 5 të këtij vendimi “Të ardhura nga veprimtaria bujqësore e familjes së origjinës, konkretisht pemëtari. Vlera 1,100,000 lekë”.)*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.120** Në lidhje me rezultatin financiar të vitit 2014, në shumën -10,386 lekë, pavarësisht një balance negative të pakonsiderueshme, Komisioni çmon se pretendimi i subjektit qëndron, pasi ajo dhe familja e saj gjatë vitit 2007 e deri në fund të vitit 2013 kanë pasur potencial për të kursyer,

---

<sup>52</sup> Në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”.

<sup>53</sup> Në rubrikën “Ndryshimi i pasurive e burimi i krijimit”.

<sup>54</sup> Në rubrikën “Ndryshimi i pasurive e burimi i krijimit”.

<sup>55</sup> Në këtë analizë, subjekti ishte analizuar me familjen e saj të origjinës për vitin 2014 dhe me bashkëjetuesin e saj për vitet 2015 e 2016, duke u përfshirë: të ardhurat nga puna të pjesëtarëve të familjes sipas periudhave përkatëse; nuk ishte përfshirë shuma 500,000 lekë dhurim i bashkëjetuesit nga prindërit e tij me të ardhurat nga toka bujqësore e prindërve të tij për efekt mosprovueshmërie të tyre, por ishte kryer reduktimi i shpenzimeve të jetesës së bashkëjetuesve me shportën e konsumit ushqimor.

çka reflektohet në rezultatin financiar të çdo viti të periudhës. Kjo tepriçë burimesh afekton kursimet e prindërve të saj si subjekte pa detyrim deklarimi e, për rrjedhojë, i jep mundësi edhe subjektit të rrisë mundësinë e saj kursyese, duke përfutur nga avantazhet e ekonomisë së përbashkët familjare. Sidoqoftë, Komisioni verifikoi mundësinë për kursime të subjektit për vitin 2014, sikur ajo të kishte jetuar më vete, dhe nga kjo analizë rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e saj, si dhe për të kursyer shumën 1,300,000 gjatë vitit 2014. Ndërkohë që pamundësia financiare për vitin 2014 është krijuar nga prindërit e subjektit, të cilët mund të përdorin kursime nga viti i kaluar. Për këto arsye, Komisioni pranon që analiza financiare e këtij viti bëhet 0 (nga -10,386 lekë).

**1.121** Në lidhje me prapësimet e subjektit ndaj pamundësisë financiare në shumën -533,191 lekë, rezultuar në vitin 2015, Komisioni vlerëson që të marrë parasysh kërkesën e subjektit për të konsideruar si të ardhura të ligjshme dhuratën prej 500,000 lekësh nga prindërit e bashkëjetuesit e, si të tillë, ta përfshijë atë në analizën financiare. Po ashtu, për shkak se reduktimi i shpenzimeve të jetesës me përqindjen që zë shporta e konsumit ushqimor në shpenzimet e jetesës ishte bërë për shkak të njohjes së përfitimit në natyrë të produkteve bujqësore nga ana e çiftit, ky reduktim nuk do të jetë më i vlefshëm dhe shpenzimet e jetesës do të konsiderohen sipas standardit të ILDKPKI-së.

**1.122** Sipas analizës së rishikuar të Komisionit, rezultati financiar i vitit 2015 nga -533,191 lekë bëhet -252,363 lekë.

**1.123 Komisioni, pasi mori në konsideratë prapësimet e subjektit dhe rishikoi analizën financiare për vitet 2014 e 2015, arriti në konkluzionin se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur mundësi të krijojnë shumën 700,000 lekësh për mobilim në vitin 2015, për shkak të një balance negative prej -252,363 lekësh.**

**1.124 Në përfundim**, në lidhje me pasurinë apartament me sip. 104 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Korçë, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi që me burime të ligjshme të paguajnë shumën 2,500,000 lekë për blerjen e tij, por nuk kanë pasur mundësi që për mobilimin e tij në vitin 2015 të krijojnë shumën 700,000 lekë, për shkak të balancës negative prej -252,363 lekësh.

**1.125** Duke mbajtur në konsideratë *së pari*, pikërisht mundësinë financiare për blerjen e këtij apartamenti, ku kontributi më i madh financiar është ai i prindërve; *së dyti*, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit dhe në prapësime, të cilat provuan se apartamenti është blerë me vlerë më të lartë sesa çmimi referencë dhe është toleruar në pagimin e këstit të mbetur prej 1,000,000 lekësh të çmimit të apartamentit, pikërisht për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare dhe marrëdhënieve të punës midis familjarëve të subjektit e shoqërisë që i ka shitur apartamentin, të ndërtuara këto marrëdhënie në terrenin tradicional shqiptar, si dhe për shkak të politikës së aktivitetit të kësaj shoqërie me të gjithë blerësit, krijohet bindja e plotë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ky apartament nuk është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

**2. Bodrum me sipërfaqe 23 m<sup>2</sup>**, regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, si pasuri nr. \*\*\*, me vendndodhje në z. k. \*\*\*, Korçë, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të marrë në huapërdorje sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* regj., nr. \*\*\* kol., datë 13.12.2016, të cilën e përdor për garazh, për mjetin në pronësi të bashkëjetuesit. Vlera \_\_\_\_\_. Pjesa takuese \_\_\_\_ %.

## **Deklarimet ndër vite**

**2.1 Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar:** “Bodrum me sip. 23 m<sup>2</sup>, i regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, si pasuria nr. \*\*\*, me vendndodhje në z. k. \*\*\*, Korçë, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

të marrë në huapërdorje prej janarit 2016, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* regj., nr. \*\*\* kol., datë 13.12.2016, të cilin e përdor për garazh për mjetin në pronësi të bashkëjetuesit tim”.

**2.2 Në DIPP-në e vitit 2018**, subjekti ka deklaruar se sipas deklaratës noteriale<sup>56</sup> datë 1.10.2018 ka zgjidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. kontratën e huapërdorjes<sup>57</sup> datë 13.12.2016. Ndërsa bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar përdorimin e këtij bodrumi si garazh me qira pas datës 3.10.2018, sipas kontratës noteriale të qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.10.2018, të lidhur me afat 2-vjeçar me të drejtë rinovimi, me vlerë 5,000 lekë/muaj.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

**2.3** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë huapërdorjeje<sup>58</sup> datë 13.12.2016, ku huadhënësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., bodrumin me sip. 23 m<sup>2</sup> që e ka në pronësi ia jep huamarrëses Sonjela Voskopi në përdorim, pa shpërblim, për ta përdorur si garazh. Sipas kontratës, objekti është marrë në përdorim në janar të vitit 2016 dhe do të vazhdojë për një kohë të pacaktuar deri kur shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. të sigurojë një blerës; (ii) certifikatë pronësie datë 22.6.2015, për bodrumin me sip. 23 m<sup>2</sup>, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**2.4** Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar përdorimin e këtij bodrumi si garazh nga janari 2016 deri në datën 1.10.2018, për të parkuar automjetin e bashkëjetuesit të saj I. F., me targë \*\*\*, sipas kontratës së huapërdorjes datë 13.12.2016, e cila është zgjidhur sipas deklaratës noteriale<sup>59</sup> datë 1.10.2018. Garazhi ka vijuar të përdoret për parkimin e automjetit sipas kontratës së qirasë<sup>60</sup> datë 3.10.2018 (që ka mbaruar) dhe sipas kontratës së qirasë<sup>61</sup> datë 13.10.2020 që është duke u ekzekutuar, të lidhura këto me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**2.5** Bashkëlidhur përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale datë 1.10.2018 dhe kontratat përkatëse të qirasë.

**2.6** ZVRPP Korçë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2017, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër subjektit dhe bashkëjetuesit të saj.

**2.7** Në pyetësin nr. 2, subjektit iu kërkua që të shpjegojë: (i) arsyet e përdorimit të bodrumit pa shpërblim për 34 muaj (janar 2016 – 3.10.2018) dhe marrëdhënien e saj me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (ii) arsyen për të cilën kjo shoqëri i ka bërë këtë favor; (iii) arsyen e mosdeklarimit të këtij “trajtimi preferencial” në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”; (iv) të depozitohet dokumentacionin ligjor që provon pagesat e qirasë për bodrumin që prej datës 3.10.2018.

**2.8** Në përgjigje<sup>62</sup>, subjekti ka shpjeguar se arsyeja për përdorimin pa pagesë të bodrumit është vetëm marrëdhënia familjare, pasi administratorja dhe një nga bashkëpronarët e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., znj. L. K. (Q.) është tezja e saj, tek e cila ka shprehur interesin për ta përdorur bodrumin, meqenëse ka marrë konfirmimin që për bodrumin në pronësi të shoqërisë në ato momente nuk kishte akoma ndonjë kërkesë për blerjen apo marrjen me qira të tij dhe tezja si përfaqësuese e shoqërisë, e ka lejuar ta përdorë bodrumin pa kundërshtim.

**2.9** Për mosdeklarimin e përdorimit të bodrumit si “trajtim preferencial” në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës *Vetting*, subjekti ka shpjeguar se sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

<sup>56</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2018.

<sup>57</sup> Kontratë huapërdorjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.12.2016.

<sup>58</sup> Kontratë huapërdorjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.12.2016.

<sup>59</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2018, bashkëlidhur pyetësorit standard (pyetja nr. 8).

<sup>60</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.10.2018, bashkëlidhur pyetësorit standard (pyetja nr. 8).

<sup>61</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.10.2020, bashkëlidhur pyetësorit standard (pyetja nr. 8).

<sup>62</sup> Përgjigja nr. 5 e pyetësorit nr. 2.

nëpunësve publikë”, rasti i saj nuk përbën “trajtim preferencial”, për sa kohë që përdorimi është pasojë e marrëdhënieve familjare me administratoren e shoqërisë ndërtuese dhe jo pasojë e detyrës, pasi shoqëria nuk ka pasur asnjë përfitim për shkak të detyrës së subjektit.

**2.10** Në lidhje me pagesat e qirasë për garazhin, subjekti depozitoi në pyetësoin nr. 2<sup>63</sup> mandate nga Raiffeisen Bank, që provojnë pagesën e qirasë në vlerën 30,000 lekë çdo 6 muaj, nga data 5.10.2018 deri më 28.4.2020, si dhe pagesën e qirasë në vlerën 21,000 lekë çdo 6 muaj, nga data 13.10.2020 deri më 11.4.2022.

**2.11** Referuar certifikatës familjare datë 25.10.2016 nga Zyra e Gjendjes Civile Drenovë Korçë<sup>64</sup>, si dhe datëlindjes, vendlindjes dhe atësisë që shënohet në akte të tjera (kontrata shitblerjeje, kontrata qiraje) të evidentuara gjatë hetimit, rezultoi se nëna e subjektit të rivlerësimit A. K. dhe shtetasja L. K. (Q.) janë motra.

**2.12** Neni 4, shkronja “f” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me nenin 3 të ligjit nr. 85/2012, përcakton detyrimin e subjekteve deklarues për të deklaruar *trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale*. Nga ana tjetër, neni 23 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, përcakton se: “*Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdolloji*”. Pra, referuar këtyre dy dispozitave, subjekti deklarues ka detyrimin që të deklarojë trajtimet preferenciale vetëm kur ky trajtim është bërë për shkak të pozicionit të punës së subjektit deklarues. Ky detyrim ka ndryshuar me ligjin nr. 42/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, pra shumë kohë pasi subjekti ka lidhur kontratat e huapërdorjes dhe të qirasë<sup>65</sup>.

**2.13** Referuar hetimit, nga nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. apo organet drejtuese të saj; referuar marrëdhënies familjare që subjekti ka me administratoren dhe një nga ortakët e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; referuar provave që vërtetojnë se bodrumi përdoret si garazh nga bashkëjetuesi i subjektit kundrejt vlerës mujore të qirasë që nga muaji tetor 2018 deri në prill 2022; referuar dispozitave ligjore të lartpërmendura që kanë qenë në fuqi gjatë periudhës *Vetting* dhe që përcaktojnë detyrimin për deklarim të trajtimeve preferenciale që jepen për shkak të pozicionit të punës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se bashkëjetuesi ka një marrëdhënie të ligjshme qiraje për këtë pasuri dhe nuk ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit apo bashkëjetuesit të saj, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe as nuk ka pasur trajtim preferencial prej saj.

**2.14** Për sa më lart, për pasurinë bodrum me sip. 23 m<sup>2</sup> objekt shqyrtimi, rezultoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë.

**3. Gjendje cash të krijuara si kursime nga paga në vlerën 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%** (deklarim i subjektit të rivlerësimit)

<sup>63</sup> Mandate datë 5.10.2018, 5.4.2018, 7.10.2019, 28.4.2020, 13.10.2020, 23.1.2021, 19.10.2021 dhe datë 11.4.2022, nga Raiffeisen Bank.

<sup>64</sup> Në faqen 315 të deklaratës *Vetting*.

<sup>65</sup> Neni 1 i ligjit nr. 42/2017, i shpallur me Dekretin nr. \*\*\*, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ka përcaktuar se: “*Trajtime preferenciale*” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në asetet, shërbimet, mallrat ose përfitime të tjera të ngjashme që i jepen ose janë në përdorim nga personi, pa shpërblim, si pasojë e detyrës, marrëveshjeve ose kontratave”.

**Gjendjen *cash*, kursime nga të ardhurat në vlerën 300,000 lekë. Pjesa takuese 100%. (deklarim i bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit)**

### **Deklarimet ndër vite nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj**

**3.1** Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi: “*Kursime cash 1,300,000 lekë*”.

**3.2** Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi “*Kursime cash nga të ardhurat e pagës për vitin 2015, shumën 600,000 lekë*”, ndërsa bashkëjetuesi i subjektit deklaroi “*Kursime 500,000 lekë, që janë gjendje cash në banesë nga të ardhurat e tokës bujqësore*”.

**3.3** Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi “*Pakësim të vlerës monetare cash me 400,000 lekë dhe në datën 31.12.2016 ka gjendje cash 200,000 lekë*”, ndërsa bashkëjetuesi i subjektit deklaroi “*Pakësim të cash-it me 300,000 lekë, gjendje cash në banesë ka pasur 600,000 lekë, në datën 31.12.2015. Në datën 31.12.2016 ka gjendje cash 300,000 lekë*”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni<sup>66</sup>**

**3.4** Sa i takon mundësisë financiare të subjektit për të kursyer 600,000 lekë në vitin 2015, duket se ajo dhe bashkëjetuesi nuk kanë pasur mundësinë për krijimin e kësaj shume, për rrjedhojë as për gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* (shihni analizën financiare të vitit 2015 në fund të vendimit).

**3.5** Në lidhje me gjendjen *cash* të deklaruar nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i DIPP-ve rezultoi se ka një gabim në deklarim për vitin 2015, pasi në DIPP-në e vitit 2015 deklarohen 500,000 lekë gjendje *cash*, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 deklarohet se në datën 31.12.2015 janë 600,000 lekë gjendje *cash*.

**3.6** Gjatë hetimit subjekti sqaroi duke saktësuar deklaratimet se gjendja *cash* e bashkëjetuesit në datën 31.12.2015 ka qenë 500,000 lekë dhe në datën 31.12.2016 ka qenë 300,000 lekë. Duke marrë në konsideratë këtë saktësim, duket se gjendja *cash* e sjellë në deklaratën *Vetting* vjen nga periudhat e kaluara, konkretisht: nga viti 2015 kur subjekti kishte gjendje *cash* 500,000 lekë, nga të cilat në vitin 2016 ka shpenzuar 200,000 lekë dhe në datën 31.12.2016 gjendja *cash* është 300,000 lekë.

**3.7** Sa i takon mundësisë financiare së subjektit dhe bashkëjetuesit të saj për të kursyer shumën 500,000 lekë në vitin 2015, duket se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur mundësinë për krijimin e shumës 600,000 lekë e, për rrjedhojë, edhe gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting* ka legjitimitet të cenueshëm.

**3.8** Me përfundimin e rezultateve të hetimit, Komisioni ka konkluduar se, për sa më sipër, mund të thuhet që legjitimiteti i gjendjeve *cash* të krijuara nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, përkatësisht në shumat 200,000 lekë dhe 300,000 lekë të deklaruara në deklaratën *Vetting*, është i cenueshëm, për shkak se të dyja vlerat e kanë burimin e krijimit në vitin 2015, kur subjekti ka rezultuar me mungesë financiare, ndonëse proporcionalisht të pakonsiderueshme.

**3.9** Me rishikimin e analizës financiare të vitit 2015, pas prapësimeve të subjektit, balanca negative e vitit 2015 u zvogëlua. Megjithëse kjo balancë negative është relativisht e vogël, konkluzioni mbi legjitimitetin e gjendjeve *cash* mbetet i njëjtë.

---

<sup>66</sup> Nisur nga fakti që subjekti dhe bashkëjetuesi i saj kanë filluar bashkëjetesën në janar të vitit 2015 dhe kanë jetuar me ekonomi të përbashkët, Komisioni vlerësoi që vlerat monetare *cash* të subjektit dhe të bashkëjetuesit të vlerësohen dhe analizohen së bashku.

#### **4. Gjendje likuiditeti të shpenzuara pas fillimit të detyrës, por që janë kursime nga bursa e dhënë gjatë periudhës së studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës para fillimit të detyrës, të cilat në fillim të detyrës kanë qenë në shumën 216,204 lekë**

##### **Deklarimet ndër vite**

**4.1** Në deklaratën e vitit 2007 para fillimit të detyrës ka deklaruar: “Kursime rreth 120,000 lekë në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank sh.a. nga të ardhurat e fituara si studente në Shkollën e Magjistraturës. Kam jetuar me të ardhurat e fituara nga aktiviteti privat i nënës, lloji i aktivitetit “Tregti me pakicë”, regjistruar me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.1998, me NIPT \*\*\*, si dhe “Të ardhurat prej 41,000 lekësh shpërblim bruto x 9 muaj, si student pranë Shkollës së Magjistraturës nga data 1.1.2007 – 5.10.2007”.

**4.2** Në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar: “Kursime rreth 200,000 lekë në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank sh.a. nga të ardhurat e fituara si pagë për shkak të funksionit si gjyqtare stazhiere. Kam jetuar me të ardhurat e fituara nga aktiviteti privat i nënës”, si dhe “Të ardhurat prej 64,449 lekësh pagë bruto x 2 muaj + 28,484 lekë si pagë e muajit tetor si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për periudhën 5.10.2007 – 31.12.2007”.

**4.3** Në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse nr. \*\*\* pranë Raiffeisen Bank, e krijuar për shkak të kursimeve nga paga (duke mos e tërhequr të gjithë pagën mujore është mbledhur kjo shumë) 200,000 lekë”.

##### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**4.4** Nga verifikimet e lëvizjes së llogarisë në Raiffeisen Bank, evidentohet se shuma 216,205 lekë është krijuar si kursim i vlerave monetare të patërhequra nga pagesat e bursës së Shkollës së Magjistraturës, pra është krijuar nga burim i ligjshëm.

**4.5** Për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të kursyer këtë shumë para detyrës, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën e Shkollës së Magjistraturës së subjektit. Për këtë periudhë subjekti ishte analizuar veçmas nga familja e saj, duke përfshirë të ardhurat, likuiditetet në bankë dhe qiranë e saj, ndërsa shpenzimet e jetesës ishin përllëgëritur në analizën e familjes së saj të origjinës<sup>67</sup>.

**4.6** Sipas kësaj analize, kishte rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e saj, në mënyrë që të krijoheshin tepricat prej 216,205 lekësh në llogarinë e saj në Raiffeisen Bank nga bursa e Shkollës së Magjistraturës.

**4.7** Pas qasjes së Komisionit në drejtim të ndërtimit të analizës financiare kumulative nga viti 1993 deri në vitin 2008, subjekti dhe familja janë bashkuar në të njëjtën analizë financiare, nga e cila përsëri ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për kursimin e vlerave monetare në bankë.

##### **Të ardhurat e bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit**

#### **5. Të ardhura nga veprimtaria bujqësore e familjes së origjinës, konkretisht pemëtari (fruta të llojit qershi dhe mollë). Vlera: 1,100,000 lekë.**

**5.1** Bashkëjetuesi i subjektit, në DIPP-në e vitit 2014, për shkak të detyrës, ka deklaruar: “Të ardhura 600,000 lekë nga toka bujqësore e përfituar me ligjin nr. 7501, pemë frutore”. Në DIPP-

<sup>67</sup> Subjekti ka deklaruar që kursimet e saj janë krijuar pikërisht pasi ajo ka përballuar shpenzimet e jetesës me të ardhurat e nënës së saj nga aktiviteti privat.



në e vitit 2015 ka deklaruar: “Kursimet 500,000 lekë, të cilat janë cash në banesë nga të ardhurat e tokës bujqësore”.

**5.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, të Njesisë Administrative \*\*\*, Korçë, që konfirmon se familja bujqësore e shtetasit Xh. F. (babai i bashkëjetuesit) posedon 10 dynym tokë bujqësore të mbjella me pemë frutore (qersh) prej vitit 2009.

**5.3** Në lidhje me të ardhurat totale 1,100,000 lekë nga toka bujqësore të deklaruara, subjektit iu kërkua: (i) të paraqesë dokumentacion të plotë mbi të ardhurat e ligjshme të përfituara nga toka bujqësore; (ii) të deklarojë kush e punon tokën bujqësore; (iii) të shpjegojë ku jetojnë familjarët që e punojnë atë dhe si shpërndahen produktet bujqësore dhe/ose të ardhurat midis bashkëpronarëve.

**5.4** Në përgjigje<sup>68</sup>, subjekti shpjegoi se toka bujqësore, që nga viti 1992 e deri aktualisht, punohet e shfrytëzohet vetëm nga prindërit e bashkëjetuesit të saj, të cilët kanë jetuar gjithmonë në fshatin \*\*\*. Për vitet 1992 – 2008, toka mbillej me produkte bujqësore sezonale (domate, speca, grurë etj.). Në vitin 2009, 8 dynym janë mbjellë me qersh, që edhe aktualisht janë në prodhim. Prej vitit 2009 deri në vitin 2016, 2 dynym janë kultivuar me mollë. Të ardhurat nga shitja e prodhimeve tek persona që nuk kanë qenë të tatueshëm gjithmonë janë administruar nga prindërit e bashkëjetuesit, të cilët për shkak të marrëdhënieve familjare i kanë dhënë pa dokument bashkëjetuesit të saj shumën 600,000 lekë cash në vitin 2014 dhe 500,000 lekë cash në vitin 2015.

**5.5** Subjekti ka shpjeguar se ndodhet në pamundësi objektive për të provuar fitimet vjetore të prindërve të bashkëjetuesit nga shitja ndër vite e produkteve bujqësore e të pemëtarisë, për arsyet se sipas legjislacionit tatimor në fuqi nga viti 1994 deri më sot<sup>69</sup> taksohet vetëm sipërfaqja e tokës bujqësore dhe jo të ardhurat që siguron bujku ose fermeri. Bujku ose fermeri nuk kanë detyrimin ligjor të deklarojnë në organet tatimore të ardhura nga shitja e produkteve të tyre, sepse ato nuk janë parashikuar si të ardhura të tatueshme. Prindërit e bashkëjetuesit nuk përfshihen në kategorinë e prodhuesve bujqësorë, i kanë shitur produktet në tregun informal tek blerës të ndryshëm të paidentifikuar, duke u sjellë më shumë si fermerë sesa si veprimtari tregtare. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka paraqitur disa dokumente përkatëse<sup>70</sup>.

**5.6** Komisioni vlerësoi se midis dokumentacionit që paraqiti subjekti, mbeten në nivel deklarativ: (i) deklaratat e prindërve të bashkëjetuesit dhe bashkëfshatarëve të tyre; (ii) akti i ekspertimit datë 9.10.2023 i agronomit A. H.; (iii) fakti që familja F. ka shitur produkte nga toka, por pa fatura, çka i bën të ardhurat nga këto produkte të pamatshme dhe jo të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>68</sup> Në pyetësoin nr. 2, përgjigja nr. 6.

<sup>69</sup> Ligji nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>70</sup> Vërtetimet nr. \*\*\*, datë 19.6.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 22.9.2023, nga Njësia Administrative \*\*\*, për shlyerjen e taksën e tokës dhe tarifave vendore deri në vitin 2023 nga shtetasi Xh. F.; vërtetimet datë 12.6.2022 dhe datë 25.9.2023 nga DRT Korçë, që fermeri Xh. D. në M., Korçë, si tatimpagues me NIPT \*\*\* është me status aktiv që nga data 16.2.2021 dhe nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën 25.9.2023; vërtetimet nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nga DRSSH Korçë, që prindërit e bashkëjetuesit janë siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi me nr. sigurimi \*\*\* e nr. \*\*\* dhe kanë paguar kontribute për periudhën 1993 – 2014; 8 deklaratat notoriale të bashkëfshatarëve, që deklarojnë se kanë njohje me familjen e bashkëjetuesit të subjektit, të cilët nga viti 1992 kur është ndarë toka e deri sot janë marrë me bujqësi, duke kultivuar 10 dynym tokë me perime sezonale, ndërsa nga viti 2009 e në vijim kanë mbjellë qersh e mollë; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023, nga Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë, mbi të dhënat e çmimit/kg të perimeve dhe pemëve frutore në zonën e fshatit \*\*\*; akti i ekspertimit datë 9.10.2023 i agronomit A. H., mbi përlllogaritjen çdo vit të të ardhurave neto nga toka bujqësore gjatë periudhës 1999 – 2023, ku në vitin 2015 të ardhurat neto janë 1,204,400 lekë.

## **Analiza financiare**

**5.7** Bazuar në të gjitha dokumentet dhe shpjegimet e subjektit, duket se prindërit e bashkëjetuesit: (i) janë banorë të fshatit \*\*\*; (ii) kanë paguar sigurime shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 deri kur kanë dalë në pension; (iii) kanë paguar taksën e tokës dhe tarifatat vendore dhe nuk kanë asnjë detyrim deri në vitin 2023; (iv) janë pajisur me NIPT fermeri nga muaji shkurt 2021; (v) nuk u provua vlera reale e të ardhurave të përfituara nga prodhimet e tokës bujqësore, pasi mbjellja e tokës me produkte bujqësore dhe shitja e produkteve të tokës bujqësore mbetën në nivel deklarativ.

**5.8** Nga verifikimi dhe analizimi i legjislacionit tatimor ndër vite, rezulton se të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët) nuk kanë pasur detyrim për regjistrimin në organin tatimor. Gjithashtu, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e prodhimeve bujqësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi, nuk janë parashikuar si të ardhura të tatueshme. Për herë të parë, koncepti i fermerit është parashikuar në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9848, datë 17.12.2007), aktualisht i shfuqizuar, ku në nenet 58/1, 58/2, 58/3 dhe 58/4 të këtij ligji përcaktohet skema e kompensimit të fermerëve<sup>71</sup>.

**5.9** Në interpretim të këtyre dispozitave, e vetmja mundësi që i vetëpunësuarit në bujqësi (fermeri) ka pasur për të provuar me dokumentacion ligjor faktin e shitjes së produkteve bujqësore dhe vlerën e të ardhurave të përfituara nga shitja, është rasti i përfshirjes së tyre në skemat e kompensimit, pra shitjes së produkteve bujqësore në subjekte tregtare të regjistruara.

**5.10** Sidoqoftë, nga dokumentacioni dhe shpjegimet e subjektit, krijohet bindja që prindërit e bashkëjetuesit e punojnë tokën dhe marrin prej saj produkte bujqësore e, për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se nuk kanë pasur mundësi të krijojnë kursime familjare, qoftë edhe vetëm nga konsumi vetjak i këtyre prodhimeve, kursime të cilat mund t’ia kishin dhuruar djalit të tyre.

**5.11** Sa më lart, në kushtet kur nuk janë provuar të ardhurat 600,000 lekë në vitin 2014 dhe 500,000 lekë në vitin 2015 nga shitja e produkteve, si dhe për shkak të pamundësisë për të matur të ardhurat që mund të jenë kursyer në vlera monetare konkrete, Komisioni nuk mund ta konsiderojë si të ardhur të ligjshme shumën 500,000 lekë (të krijuar në vitin 2015 kur subjekti bashkëjetonte me shtetasin I. F.) dhe ta përfshijë në analizën financiare, por vlerëson të reduktohen shpenzimet e jetesës së subjektit dhe bashkëjetuesit të saj për vitin 2015, në masën 48.7%, e cila përbën shportën e konsumit ushqimor<sup>72</sup>, duke pranuar që ata konsumojnë produkte bujqësore nga prindërit e bashkëjetuesit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.12** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ndaj pamundësisë financiare prej -533,191 lekësh, rezultuar në vitin 2015 për mobilimin e apartamentit (shihni pikën 1.119 e vijuese më lart), ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, i cili në analizën financiare të këtij viti nuk ka përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore që prindërit i kanë dhuruar

<sup>71</sup> Referuar këtyre dispozitave, përfitojnë nga skema e kompensimit fermerët që nuk janë regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen sipas këtij ligji, por që janë të pajisur me një kod personal të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe që furnizojnë personat e tatueshëm me mallra me prejardhje nga prodhimi bujqësor e blegtoral. Në nenin 58/4 të këtij ligji përcaktohet se është blerësi (personi i tatueshëm) ai që lëshon faturë tatimore për shitësin fermer, për çdo furnizim të marrë prej tij. Gjithashtu, referuar neneve 145, 146 dhe 147 të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, u është dhënë mundësia prodhuesve bujqësorë të pajisen me numër identifikimi si person i tatueshëm nga DRT-ja ku ushtron aktivitetet, kjo për efekt të përfshirjes së tyre në skemën e kompensimit të TVSH-së, por gjithsesi pa iu nënshtruar detyrimit për deklarimin e TVSH-së, sipas nenit 106 të këtij ligji.

<sup>72</sup> Shihni Anketën e buxhetit të familjes për vitin 2015, INSTAT, zërin “Ushqim dhe pije joalkoolike” [file:///C:/Users/User/Downloads/abf\\_2015.pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/abf_2015.pdf)

bashkëjetuesit, por ka reduktuar shpenzimet e jetesës të saj dhe bashkëjetuesit. Subjekti sjell në vëmendje të njëjtat argumente dhe prova të paraqitura gjatë hetimit administrativ, duke argumentuar se ajo ka provuar që prindërit e bashkëjetuesit posedojnë e punojnë tokë bujqësore, marrin prodhime e gjenerojnë të ardhura prej saj, të cilat për vitin 2015 janë në vlerën 1,204,400 lekë<sup>73</sup>. Gjithashtu, subjekti qëndron e bindur në argumentin e saj se është botërisht i njohur fakti që banorët e këtyre zonave kanë si të ardhura të tyre të ardhurat nga bujqësia dhe pemëtaria. E gjithë zona merret me bujqësi dhe burimi kryesor i të ardhurave është nga ky aktivitet. Sikurse rezultoi nga hetimi administrativ, prindërit e bashkëjetuesit të saj nuk kanë qenë për shumë vite në marrëdhënie pune, por kanë derdhur kontributet si të vetëpunësuar në bujqësi, sipas nenit 9, paragrafi 5 i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, duke filluar nga viti 1993.

**5.13** Sa i takon faktit nëse këto të ardhura janë të tatueshme apo jo, subjekti sjell në vëmendje vendimin nr. \*\*\*, datë 14.6.2022, ku Kolegji ka mbajtur qëndrimin se të ardhurat nga kulturat bujqësore nuk janë të ardhura që i nënshtrohen tatimit dhe prandaj ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat nga produktet bujqësore.

**5.14** Në përfundim, subjekti kërkon të bëhet korigjimi i analizës financiare, duke përfshirë të ardhurat në shumën 500,000 lekë që bashkëjetuesi ka marrë dhuratë prej prindërve të tij nga produktet bujqësore dhe të mos bëhet reduktimi i shpenzimeve të jetesës.

**5.15** Bashkëjetuesi ka pasur gjendje *cash* nga periudhat e kaluara, por për shkak të pasaktësisë në deklaratimet e kryera prej tij në cilësinë e subjektit deklarues, nuk janë përfshirë në analizën financiare. Shumën 1,000,000 lekë si kursime ndër vite nga pagat, ai e ka deklaruar vetëm në deklaratën e datës 10.2.2014 të para fillimit të detyrës si Avokat Shteti. Këtë shumë subjekti kërkon që Komisioni ta përfshijë në të ardhurat e realizuara në pemëtari nga familja e bashkëjetuesit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**5.16** Në lidhje me faktet shkresore dhe argumentet e sjella nga subjekti gjatë hetimit administrativ, por edhe në këto prapësime, Komisioni çmon se:

i) Subjekti ka provuar që prindërit e bashkëjetuesit jetojnë prej shumë vitesh në fshat, disponojnë tokë bujqësore dhe e punojnë atë. Ata përfitojnë produkte nga kultivimi i saj e rrjedhimisht edhe të ardhura<sup>74</sup>.

ii) Sa i takon anës sasiore të të ardhurave, Komisioni bazohet në shkresat e Ministrisë së Bujqësisë<sup>75</sup>, e cila pasqyron sasinë e përftuar dhe rendimentin e disa bimëve të arave dhe pemëve frutore, të cilat kultivohen në fshatin \*\*\* të prindërve të subjektit. Por, kjo shkresë nuk jep të dhëna për kohën specifike/vitin të cilit i takojnë këto të dhëna; po ashtu shkresa nuk vërteton nëse kulturat bimore që ajo përcakton kanë qenë ose janë praktikisht të mbjella nga familja e bashkëjetuesit të subjektit e, për këtë arsye, ajo ka vlerë thjesht indikative. Nga ana tjetër, pavarësisht karakterit indikativ të këtij akti, mund të thuhet se përmbajtja e tij është e përafërt dhe përfaqëson një realitet faktik, pasi Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë, qoftë edhe për arsye statistikore, e njeh dhe ka informacion të plotë e të saktë mbi kulturat, rendimentet, sasinë e mbjella në çdo zonë që ajo mbulon dhe çdo njësi më të vogël të saj (fshat). Pra, të dhënat e

<sup>73</sup> Nëpërmjet të dhënave nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Rrethi Korçë, mbi çmimin për kg të perimeve dhe pemëve frutore në zonën e fshatit \*\*\*, si dhe nëpërmjet akt ekspertimit datë 9.10.2023 nga agronomi A. H. janë përllogaritur të ardhurat neto nga toka bujqësore për secilin vit gjatë periudhës 1999 – 2023 dhe për vitin 2015 të ardhurat neto janë 1,204,400 lekë.

<sup>74</sup> Vërtetimet nr. \*\*\*, datë 19.6.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 22.9.2023, nga Njësia Administrative \*\*\*; vërtetimet nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nga DRSSH Korçë; 8 deklaratat notoriale të bashkëfshatarëve të bashkëjetuesit të subjektit.

<sup>75</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023, të Ministrisë së Bujqësisë.

informuara nëpërmjet këtij akti zyrtar mund të konsiderohen si të përafërta me ato reale dhe që mbartin informacion edhe për tokën e prindërve të bashkëjetuesit.

iii) Për rrjedhojë, edhe akti i ekspertimit<sup>76</sup> i cili është ndërtuar mbi të dhënat e informuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe mbi deklarin e shtetasit Xh. F., babai i bashkëjetuesit dhe pronar i tokës bujqësore, është një akt i plotë dhe i mirëstrukturuar dhe që mund të përcaktojë, qoftë edhe përafërsisht, sasinë e produkteve bujqësore të marra nga familja F. gjatë 2015.

iv) Në konsiderimin e këtyre të ardhurave, Komisioni e gjen të nevojshme të bazohet gjithashtu edhe në qasjen që ai vetë ka mbajtur në raste të ngjashme, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit. Nga të gjitha këto vendime të mëparshme të Komisionit<sup>77</sup> ka rezultuar se janë analizuar pretendimet e subjekteve në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore dhe ligjshmërinë e tyre, në konsideratë të disa fakteve, si: mbajtja në pronësi ose në përdorim e tokës bujqësore, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”; pagimi i takës mbi tokën; vërtetimi i tjetërsimit apo dhënies së tokës në përdorim; vërtetimi i ushtrimit të aktivitetit bujqësor nga anëtarët e familjes bujqësore apo qenia e tyre banorë në rrethin ku ndodhet toka; fakti që ata e kultivojnë tokën; pagesë sigurimesh shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi; vërtetime të ardhurash nga shitja etj. Por, në përfundim, është evidentuar se vlerësimi i provave është bërë rast pas rasti në raport me kushtet specifike të secilit prej subjekteve.

v) Në vendimet e mësipërme, Komisioni ka shqyrtuar dy elemente, konkretisht: vlerën monetare të dhuruar apo të dhënë hua, si dhe peshën specifike që ka zënë kjo dhuratë/hua në totalin e të ardhurave të dhuruesit, të gjeneruara gjithsej nga toka bujqësore. Pra, në këto raste të ngjashme, shumat e dhuruara janë marrë në konsideratë, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, pasi duke qenë shuma modeste, mundësia për të dhënë hua ose ndihmë është më reale.

vi) Në rastin e bashkëjetuesit të subjektit, evidentohet se dhurata e dhënë nga prindërit e tij është në një masë të moderuar prej 500,000 lekësh dhe gjithashtu rezulton se ajo përbën rreth 40% të vlerës së të ardhurave të përfituara nga toka bujqësore e tyre për vitin 2015, e njoftuar nga aktet e Agjencisë Rajonale të Ekstencionit dhe akti i ekspertimit i administruar gjatë hetimit administrativ.

vii) Nëse do të konsiderojmë këtu edhe faktin që prindërit e subjektit kanë shumë vite<sup>78</sup> që e kultivojnë tokën e tyre, atëherë viti 2015 nuk është as viti i parë dhe as i vetëm që ata marrin produkte bujqësore dhe të ardhura prej tyre. Pra, ata e kanë pasur mundësinë e akumulimit të këtyre të ardhurave ndër vite. Për më tepër, viti 2015 shënon edhe fillimin e bashkëjetesës së djalit të tyre me subjektin dhe kjo dhuratë, që në proporcion me shumën e të ardhurave të tyre, qoftë për vitin 2015, por edhe ndër vite, është modeste, duket edhe një veprim i natyrshëm i traditës së një familjeje shqiptare.

viii) Sa i takon pretendimit të subjektit në lidhje me vlerën 1 milion lekë që bashkëjetuesi e kishte të kursyer nga paga e tij para detyrës<sup>79</sup>, ky është një pretendim i cili ngrihet për herë të parë në parashtrime dhe nuk mund të krijojë lidhje me barrën e provës, derisa si burim për shumën 500,000 lekë bashkëjetuesi ka deklaruar “Të ardhurat e tokës bujqësore” dhe jo “Kursim nga të ardhurat e

<sup>76</sup> Datë 9.10.2023 nga agronomi A. H..

<sup>77</sup> Vendim nr. 234, datë 4.2.2020, paragrafi 3.39 (subjekti i rivlerësimit M. M.); vendim nr. 229, datë 28.1.2020, paragrafi 6.4 (subjekti i rivlerësimit D. B.); vendim nr. 241, datë 26.2.2020, pika 24.8.10; vendim nr. 372, datë 22.4.2021 (subjekti i rivlerësimit R.A.).

<sup>78</sup> Referuar dy shkresave nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Korçë, prindërit e subjektit nuk figurojnë në asnjë marrëdhënie punë, por vetëm si të vetësiguruar në bujqësi që nga viti 1993 e në vijim.

<sup>79</sup> Shumë e deklaruar në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2014: “Kursimet nga paga si kancelar në Gjykatën e Apelit Korçë dhe aktivitet mësimdhënie”.

tij”. Për këtë arsye, ky pretendim nuk mund të konsiderohet nga Komisioni. Pavarësisht këtij përfundimi, vlen të nënvizohet faktin se bashkëjetuesi i subjektit vetëm me të ardhurat e tij të ligjshme nga punësimi arrin të krijojë këtë shumë prej 500,000 lekësh.

**5.17** Për të gjitha arsyet e mësipërme, duke konsideruar edhe ligjin e kohës mbi tatueshmërinë e të ardhurave nga toka bujqësore<sup>80</sup>, Komisioni vendos që të marrë parasysh kërkesën e subjektit për të konsideruar si të ardhura të ligjshme dhuratën prej 500,000 lekësh që prindërit i kanë bërë bashkëjetuesit e, si të tillë, ta përfshijë atë në analizën financiare. Po ashtu, për shkak se reduktimi i shpenzimeve të jetesës me përqindjen që zë shporta e konsumit ushqimor në shpenzimet e jetesës ishte bërë për shkak të njohjes së përfitimit “në natyrë” të produkteve bujqësore nga ana e çiftit (subjekti dhe bashkëjetuesi), ky reduktim nuk do të jetë më i vlefshëm dhe shpenzimet e jetesës do të konsiderohen sipas standardit të ILDKPKI-së.

**5.18** Sipas analizës së rishikuar të Komisionit, rezultati financiar i vitit 2015 nga -533,191 lekë bëhet -252,363 lekë.

**5.19 Komisioni arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për të ardhurat e bashkëjetuesit të saj në shumën 1,100,000 lekë nga veprimtaria bujqësore e familjes së origjinës, është i saktë.**

#### ❖ Pasuri të deklaruara nga shtetasi I. F., bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit

**6. Tokë bujqësore e përfituar sipas ligjit nr. 7501 datë 19.7.1991 “Për tokën”,** si anëtar i familjes bujqësore me kryefamiljare S. F.. (Sqarim: sipas AMTP-së nr. \*\*\*, familja bujqësore ka përfituar 12,008 m<sup>2</sup> tokë arë, me vendndodhje fshati \*\*\*, Korçë. Nga sipërfaqja prej 12,008 m<sup>2</sup> kam në pronësi 1/5 pjesë të pandarë në natyrë (12,008 m<sup>2</sup>/5 anëtarë = 2,401 m<sup>2</sup>). Zotëroj 100%).

**6.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) me nr. regjistri \*\*\*, të tokës bujqësore me sip. 12,008 m<sup>2</sup> në emër të shtetases S. F.; (ii) certifikatë e gjendjes së familjes së shtetases S. F., në datën 1.8.1991, ku janë 5 anëtarë.

**6.2** Në deklaratën e vitit 2014 para fillimit të detyrës si Avokat i Shtetit në Zyrën Vendore Korçë, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: “Tokë bujqësore 4,200 m<sup>2</sup>, e përfituar si familjar i familjes bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 7501, “Për tokën”. Pjesa takuese: 100%”.

**6.3** Gjatë hetimit administrativ, bazuar në shpjegimet e subjektit, në dokumentacionin e depozituar prej saj dhe atij të administruar nga Komisioni, u provua ligjshmëria e origjinës së kësaj prone, e cila në kohën e deklarimit *Vetting* nuk ishte e regjistruar, për shkak të mosazhornimit të zonës dhe më pas proceseve gjyqësore, objekt i të cilave ishte kjo pasuri, e cila u bë e mundur të regjistrohej në vitin 2019 në emër të familjes së bashkëjetuesit të subjektit.

**6.4 Për sa më lart, rezulton se deklarimi i bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit përputhet më dokumentacionin e depozituar prej saj dhe të administruar nga Komisioni, si dhe nuk ka problematika për këtë pasuri.**

**7. Automjet tip “Daimler Chrysler” (D),** viti i prodhimit 2004, me targë \*\*\*, blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2010, në vitin 2010, me të ardhurat e familjes së origjinës në vlerën 4,500 euro. Pjesa takuese: 100%.

---

<sup>80</sup> Ligji nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH” (ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9848, datë 17.12.2007).

**7.1** Ky automjet është deklaruar fillimisht në deklaratën e vitit 2011 para fillimit të detyrës si kancelar në Gjykatën e Apelit Korçë, pastaj në DIPP-në e vitit 2011 dhe në deklaratën e vitit 2014 para fillimit të detyrës si Avokat i Shtetit në Zyrën Vendore Korçë.

**7.2** Meqenëse kjo është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni hetoi fillimisht në lidhje me ligjshmërinë e origjinës së kësaj pasurie. Nga hetimi i kryer rezultoi se kjo pasuri është blerë nga bashkëjetuesi i subjektit në vlerën 4,500 euro sipas kontratës së shitjes<sup>81</sup> së lidhur në datën 21.5.2010, kohë kur subjekti i rivlerësimit nuk ishte njohur ende me bashkëjetuesin e saj; midis shitësit të automjetit dhe subjektit të rivlerësimit nuk u konstatua ndonjë situatë konflikti interesi; DPSHTRR-ja konfirmon<sup>82</sup> regjistrimin e pronësisë së automjetit në emër të shtetasit I. F.; çmimi 4,500 euro është më i lartë se çmimi 2,500 euro me të cilin e ka blerë vetë shitësi, çka nuk e bën këtë çmim preferencial.

**7.3** Për sa më lart, rezulton se pronësia e kësaj pasurie ka origjinë të ligjshme dhe meqenëse kjo pasuri rezulton të jetë krijuar vite më parë sesa subjekti të fillonte jetesën me bashkëjetuesin, ky fakt nuk e vendos bashkëjetuesin në kategorinë e personave që parashikojnë pikat 13 dhe 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, prandaj Komisioni nuk mund të hetojë për mundësinë e burimit financiar të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

#### ❖ Pasuritë e deklaruara nga shtetasi H. V., babai i subjektit të rivlerësimit

**8. Apartament banimi me sipërfaqe 84 m<sup>2</sup>**, regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, si pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë, në adresën: rruga “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, me datë lëshimi 5.3.2013, e regjistruar me pronar H. V.. Fitimi i pronësisë sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003, në vlerën 1,900,000 lekë. Pjesa takuese ½, si pasuri e fituar gjatë martesës.

**8.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Në DIPP-në e vitit 2008, babai i subjektit ka deklaruar njësoj si në deklaratën *Vetting*.

**8.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003, ku shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i shet blerësit H. V. këtë apartament me çmimin 1,900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale; certifikatë pronësie datë 5.3.2013 nga ZVRPP Korçë, për apartamentin e regjistruar në pronësi të shtetasit H. V..

**8.3** Komisioni administroi<sup>83</sup> dosjen e kësaj pasurie nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë, që provon regjistrimin e apartamentit në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., më pas shitjen e tij tek shtetasi H. V. me kontratën e datës 18.1.2003 dhe regjistrimin e kësaj kontrate në ZVRPP Korçë.

**8.4** Në pyetësorin nr. 2<sup>84</sup>, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në këtë apartament banojnë prindërit dhe vëllai i saj, për periudhën përpara muajit janarit 2015 e deri tani.

**8.5** FSHU-ja konfirmon<sup>85</sup> kontratën e furnizimit me energji elektrike, të llojit “familjare”, datë 15.8.2005, në emër të shtetasit H. V., në adresën: rruga “\*\*\*\*”, Korçë.

**8.6** Sa i takon mundësinë së prindërve të subjektit për ta blerë këtë apartament, u krye analiza financiare e prindërve të subjektit deri në fund të vitit 2002, nga ku rezultoi se familja e saj ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e tij, duke marrë në konsideratë se në datën 23.5.2002 prindërit e saj kanë përfituar shumën 1,900,000 lekë nga shitja e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*,

<sup>81</sup> Kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.5.2010.

<sup>82</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021, nga DPSHTRR-ja, dërguar Komisionit.

<sup>83</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2023, të ASHK Drejtoria Vendore Korçë.

<sup>84</sup> Përgjigja nr. 2 e pyetësorit nr. 2.

<sup>85</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2023, e FSHU-së.

z. k. \*\*\*, apartament me sip. 63.1 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të shtetasve H., A. e Q. V., i fituar me kontratën e privatizimit datë 15.4.1993<sup>86</sup>.

**9. Garazh me sipërfaqe 40.3 m<sup>2</sup>**, i regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, si pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë, në adresën rruga “\*\*\*\*”, sipas certifikatës për vërtetimin pronësie datë 5.3.2013, regjistruar me pronar H. V.. Fitim i pronësisë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003, në vlerën 700,000 lekë. Pjesa takuese: 1/2.

**9.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga nëna e subjektit të rivlerësimit, ndërsa në DIPP-në e vitit 2008, babai i subjektit ka deklaruar njësoj si në deklaratën *Vetting*.

**9.2** ASHK Drejtoria Vendore Korçë konfirmon<sup>87</sup> këtë pasuri të regjistruar në emër të shtetasit H. V., në bazë të kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003, me shitës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 700,000 lekë, të likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**9.3** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë konfirmon<sup>88</sup> se në emër të shtetasit H. V. është lidhur kontrata e furnizimit me ujë nr. \*\*\*, në shkurt të vitit 2015, për këtë pasuri.

**9.4** FSHU-ja konfirmon<sup>89</sup> se në emër të shtetasit H. V. është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike e llojit “privat”, në datën 14.9.2005, me adresë në Korçë.

## **Analiza financiare**

**9.5** Gjatë hetimit administrativ<sup>90</sup>, subjekti ka shpjeguar se prindërit i kanë dhuruar nënës së saj gjatë vitit 2002 shumën 500,000 lekë, që ata e kanë përfituar nga shitjet e pasurive deri në këtë vit. Kjo shumë së bashku me shumën 200,000 lekë që buron nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.1997, të cilat janë mbajtur *cash* në banesë<sup>91</sup>, kanë shërbyer për blerjen e garazhit nga babai i subjektit, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003.

**9.6 Në konkluzion**, nga analiza financiare e familjes së subjektit para detyrës, ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e garazhit.

**10. Automjet tip “Marcele-Benz” (D), viti i prodhimit 1996. Blerë me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.11.2006, në vlerën 250,000 lekë. Pjesa takuese: 1/2.**

**10.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

**10.2** Në DIPP-në e vitit 2008, nëna e subjektit ka deklaruar blerjen e këtij automjeti me çmimin 250,000 lekë sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.11.2006, me shitës S. S. dhe blerës H. V., me burim “Dhurata me vlerë 1,600,000 lekë nga S. K.(pa kontratë dhurimi), babai i nënës së subjektit, e siguruar nga shitja e disa pronave”.

**10.3** Referuar dosjes<sup>92</sup> së automjetit provohet se me kontratë shitjeje datë 12.10.2006, pronari A. G. ia shet automjetin blerësit S. S. me çmimin 2,200 euro. Me aktin e zhdoganimit datë 15.10.2006, automjeti është zhdoganuar në favor të shtetasit S. S., me vlerë totale zhdoganimi 467,086 lekë (2,200 euro x 123,02 kursi i këmbimit + 196,442 taksë zhdoganimi).

<sup>86</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2017, të ZVRPP-së Korçë, dërguar ZQRPP-së (faqet 468 dhe 479-489 të dosjes *Vetting*).

<sup>87</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2021, të ASHK-së Korçë, dërguar Komisionit.

<sup>88</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, të UK-së Korçë, dërguar Komisionit.

<sup>89</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2023, e FSHU-së.

<sup>90</sup> Në pyetësorin nr. 2.

<sup>91</sup> Në përgjigjen nr. 1 të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., babai i saj ka shitur një truall dhe ka përfituar shumën totale 330,000 lekë, nga të cilat janë mbajtur si kursime në banesë vetëm 200,000 lekë dhe pjesa tjetër është shpenzuar.

<sup>92</sup> Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

**10.4** Nga AMF-ja rezulton se shtetasi H. V. figuron pronar i automjetit nga data 11.12.2007 deri më 7.5.2021.

**10.5** Për sa më lart, rezulton se kjo pasuri është krijuar përpara emërimit të subjektit në detyrë.

**10.6** Duke marrë në cilësinë e provës deklarimin e babait të subjektit në DIPP-në e vitit 2008, si dhe sqarimet e subjektit në pyetësorin nr. 2, duket se burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit ka qenë një pjesë e shumës 1,600,000 lekë që nëna e subjektit ka marrë si dhuratë nga prindërit e saj gjatë viteve 2004 – 2006.

**10.7** Sa i takon ligjshmërisë së këtyre të ardhurave prej 1,600,000 lekësh, rezultoi se gjyshërit e subjektit, S. dhe N. K., kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të bërë dhuratë këtë shumë, me të cilën është blerë mjeti nga babai i subjektit në datën 28.11.2006 (trajtuar hollësisht në pikën 14 në vijim).

**10.8 Për sa më lart, rezulton se deklarimi në deklaratën *Vetting* përpunet me shpjegimet e subjektit dhe provat e administruara gjatë hetimit, si dhe nuk konstatohen mangësi për këtë pasuri.**

**11. Njësi shërbimi me sipërfaqe 14.5 m<sup>2</sup>**, e regjistruar me vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, si pasuria nr. \*\*\*, Korçë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 22.2.2006, e regjistruar me pronar A. V.. Fitimi i pronësisë sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.1995, kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.3.1996 dhe kontratës së pjesëtimit vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.2.2006. Vlera e objektit 81,710 lekë dhe vlera e truallit 4,176 lekë. Pjesa takuese 50%, si pasuri e fituar gjatë martesës.

**11.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar këtë pasuri, duke përcaktuar edhe burimin e saj: *“Fituar në bazë të autorizimit datë 13.7.1995, të dhënë nga Agjencia e Privatizimit për A. V. e A. G.. Pjesëtohet me kontratë pjesëtimi vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.2.2003. Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.1995, objekti njësi tregtare, adresa: Lagjja \*\*\*, sip. 29 m<sup>2</sup>, kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.3.1996, blerëse A. dhe A., shitës Agjencia e Privatizimit, objekti truall nën dyqan”*.

**11.2** Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, ndër të tjera, dokumentet:

- i) Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.1995, me palë shitëse \*\*\* Korçë dhe palë blerëse A. V. e A. G., për blerje njësie me sip. 29 m<sup>2</sup>, vlera 81,710 lekë. Kjo kontratë është regjistruar në hipotekë me nr. \*\*\*, datë 30.8.1995.
- ii) Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.3.1996, me palë shitëse Agjencia Kombëtare e Privatizimit Korçë dhe palë blerëse A. V. e A. G., për blerje të truallit nën dyqan, me sip. 29 m<sup>2</sup>, në vlerën 4,176 lekë. Kjo kontratë është regjistruar në hipotekë me nr. \*\*\*, datë 30.4.1996.
- iii) Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.2.2003, ku shtetasit A. V. e A. G. pjesëtojnë njësinë me sip. 29 m<sup>2</sup>, duke përfutur secila nga ½ pjesë = 14.5 m<sup>2</sup>.
- iv) Certifikatë për vërtetim pronësie datë 22.2.2006 nga ZRPP Korçë, për njësinë me sip. 14.5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* e regjistruar në pronësi të shtetasës A. V..

**11.3** ASHK Drejtoria Vendore Korçë konfirmon<sup>93</sup> njësinë me sip. 14.5 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në pronësi të shtetasës A. V. Bashkëlidhur kartela e pasurisë + praktika.

<sup>93</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2021, të ASHK Korçë, drejtuar Komisionit.



## 11.4 Për sa më lart, rezultoi se kjo pasuri është krijuar me dokumentacion të rregullt ligjor, përpara se subjekti i rivlerësimit të caktohej në detyrë.

### 12. Vlerë monetare *cash* si kursime të familjes, në vlerën 700,000 lekë

**12.1** Në lidhje me gjendjen *cash* të prindërve të subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ është evidentuar se: (i) Subjekti<sup>94</sup> ka mbajtur qëndrimin se prindërit e saj nuk kanë pasur detyrim ligjor për të deklaruar, referuar neneve 21 e 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”; (ii) Prindërit e saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2008, ku tek kjo e fundit duket<sup>95</sup> që deklarimi është bërë për shkak se subjekti e ka kuptuar gabim ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, duke pasur parasysh që ishte në fillim të detyrës në dy muajt e fundit të vitit 2007 dhe, sipas saj, deklarimi i plotë ka qenë në vitin 2018, ashtu sikurse ajo e ka kuptuar këtë ligj. Pas konsultimit me ILDKPKI-në, ka mësuar se prindërit e saj, referuar neneve 21 e 22 të këtij ligji, nuk kishin detyrim të deklaronin; (iii) E pyetur në lidhje me depozitat e prindërve që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit ku subjekti banon (trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi); kohën dhe shumat e dhuruara nga gjyshërit, si dhe përdorimin e tyre (trajtuar në pikën 14 të këtij vendimi), subjekti midis të tjerash ka shpjeguar hollësisht se cilat shuma janë mbajtur *cash* prej prindërve të saj ndër vite; (iv) shpjegimet e subjektit janë krahasuar me lëvizjet e llogarive bankare për lëvizjet e shumave *cash* (depozitime-tërheqje), si dhe pagesat e kryera me to.

**12.2** Këto shpjegime janë treguar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Vitet	Shuma në <i>cash</i> gjendje (lek)	Sqarimet e subjektit në pyetësorin nr. 2
2006	1,500,000	500,000 lekë depozituar tek ABA Bank nga nëna, datë 9.1.2006 dhe tërhequr në datën 10.10.2006. Mbajtur <i>cash</i> në banesë deri në datën 11.2.2007, kur shuma është depozituar në Raiffeisen Bank 1,000,000 lekë nga DIPP 2008/DV dhe pyetësorët konkludohet që kjo shumë ka qenë <i>cash</i> që në fund të vitit 2006 (kursime nga aktiviteti privat i nënës).
2007	1,000,000	500,000 lekë depozitohet tek Raiffeisen Bank në datën 11.2.2007 1,000,000 lekë mbartet nga viti 2006
<b>DIPP 2008/ deklaratat <i>Vetting</i></b>	<b>1,000,000</b>	<b>DIPP 2008:</b> 1,000,000 lekë, shumë <i>cash</i> në banesë. Burimi: kursime nga të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar i subjektit fizik “A. V.”, që ka filluar veprimtarinë që në vitin 1997 <b>Deklarata <i>Vetting</i>:</b> 1,000,000 lekë <sup>96</sup> . Burimi: “Dhuratë nga prindërit e nënës gjatë 2004 – 2006”
2009	2,750,000	1,000,000 mbartur nga viti 2008 1,000,000 u tërhoq nga babai nga ABA Bank, datë 6.2.2009 (dep. ***/2005) 500,000 lekë u tërhoq nga nëna nga Raiffeisen Bank, datë 1.2.2009 (dep. ***/2007) 250,000 lekë dhuratë nga gjyshërit <sup>97</sup> (në vitet 2009 – 2010, dhuruar shuma 500,000 lekë)
2010	3,000,000	2,750,000 mbartur nga viti i kaluar 250,000 lekë dhuratë nga gjyshërit (në vitet 2009 – 2010, dhuruar shuma 500,000 lekë)
2011	0	Gjendja <i>cash</i> e vitit të kaluar është depozituar në ISP Bank datë 11.1.2011
2012	1,500,000	3,000,000 lekë tërhiqet nga ISP Bank, datë 11.1.2012 1,500,000 lekë paguhet kësti i parë i apartamentit -1,500,000 lekë <i>cash</i> në banesë
2013	-	1,000,000 paguhet kësti i dytë i apartamentit Nuk thuhet asgjë për 500,000 lekë që mbetën.

<sup>94</sup> Përgjigjja nr. 13/c e pyetësorit nr. 2.

<sup>95</sup> Referuar shpjegimeve që subjekti ka dhënë në përgjigjen nr. 13, shkronja “c” e pyetësorit nr. 2.

<sup>96</sup> Deklaruar nga prindërit për vlerën e krijuar për blerjen e apartamentit me sip. 104 m<sup>2</sup>, trajtuar në pikat 1.46-1.49 të vendimit.

<sup>97</sup> Meqenëse subjekti nuk e saktëson vitin, por deklaron në vitet 2009 – 2010, atëherë shuma 500,000 lekë është ndarë në mënyrë të barabartë midis dy viteve.

2014	-	
2015	-	
2016	-	
Deklarata Vetting	700,000	Vlerë monetare <i>cash</i> si kursime të familjes

**12.3** Nga sa më sipër: (i) ka përrputhje midis shpjegimeve të subjektit me veprimet bankare dhe pagesat e kryera për apartamentin; (ii) referuar ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003, sipas të cilit detyrimin për deklarim e kanë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët madhorë të subjektit deklarues, prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë bërë deklarime periodike për pasuritë e tyre; (iii) saktësia e shpjegimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ provohet edhe nga shuma e deklaruar nga babai në deklaratën *Vetting*, e cila duket një vazhdim i veprimeve në menaxhimin e gjendjes *cash* nga prindërit e subjektit. Për këto arsye, është vlerësuar të mbahen në konsideratë deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, për vlerat monetare të mbajtura *cash* nga prindërit e saj.

**12.4** Gjendjet *cash*, sikurse trajtuar në tabelën e mësipërme, janë përfshirë në analizën financiare të familjes, duke filluar nga viti 2006 deri në vitin 2013.

**12.5** Sa i takon mundësisë së familjes së subjektit për të krijuar kursimet *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, familja ka pasur të ardhura të mjaftueshme gjatë viteve 2015<sup>98</sup> dhe 2016 për t'i krijuar këto kursime.

**12.6** Ky përfundim vjen si rezultat i mundësisë për kursime, të cilat janë krijuar nga familja deri në fund të vitit 2014, kur subjekti ka jetuar me familjen e origjinës, të cilat konsiderohen si mundësi potenciale për t'u kursyer dhe akumuluar nga prindërit e subjektit<sup>99</sup>.

#### ❖ Pasuritë e deklaruar nga shtetasja A. V., nëna e subjektit të rivlerësimit

**13.** Të ardhura nga veprimtaria tregtare e “Shitblerje artikuj ushqimorë”, aktivitet i regjistruar me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. I regjistruar në QKB, me NIPT \*\*\*. Të ardhurat e relaturoja janë fituar në periudhën pas fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Vlera: 2,384,422 lekë.

**13.1** Në DIPP-në e vitit 2008, nëna e subjektit ka deklaruar: “Shumë *cash* 1,000,000 lekë në shtëpi, kursime nga të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar i subjektit fizik “A. V.”, që ka filluar veprimtarinë nga viti 1997 deri sot”.

#### Hetimi i kryer nga Komisioni

**13.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* disa dokumente, që konfirmojnë aktivitetin tregtar të ushtruar nga nëna e saj në periudhën 2003 – 2016<sup>100</sup>.

<sup>98</sup> Nga viti 2015 familja e subjektit është analizuar më vete.

<sup>99</sup> Shihni vendimin nr. 20, datë 3.5.2023, të Kolegjit, paragrafi 11.11/ii, ku arsyetohet se: “...verifikimi i mundësisë financiare të tyre për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duhet të përfshijë edhe të ardhurat/kursimet në *cash* që nga analiza financiare rezultojnë ...si mundësi potenciale për t'u kursyer nga prindërit e subjektit, duke u bazuar në indikatorët financiarë, si të ardhurat e ligjshme që prindërit kanë pasur në dispozicion, mbulimi i kostove të jetesës, investimet e kryera dhe huat e dhëna prej tyre”.

<sup>100</sup> (1) Autorizim nr. \*\*\*, datë 15.2.2005, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria Rajonale Korçë (DRT) për aktivitetin “dyqan artikuj ushqimor”, me kod fiskal \*\*\*, i regjistruar me vendim të gjykatës nr. \*\*\*, datë 18.2.1998; (2) vendim nr. \*\*\*, datë 18.2.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për regjistrimin e personit fizik privat “A. V.”, për të ushtruar aktivitet privat “tregti me pakicë”; (3) certifikatë e deklarimit të aktivitetit tregtar në Inspektoratin Shtetëror të Punës, datë 9.5.2007, lëshuar në emër të shtetasës A. V.; (4) certifikatë datë 14.6.2011 nga QKR-ja, që konfirmon regjistrimin e personit fizik “A. V.”, me NIPT \*\*\*, në datën 11.3.2003; (5) shkresat nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, të DRT Korçë, sipas të cilave subjekti “A. V.”, me NIPT \*\*\* ka realizuar respektivisht fitim në periudhën vitit 2008 – 2015 dhe fitimin në shumën 326,597 lekë,

**13.3** Sipas QKB-së<sup>101</sup>, personi fizik “A. V.” figuron i regjistruar në datën 11.3.2003, me NIPT \*\*\*, për aktivitet “Tregti me pakicë” dhe ka status “çregjistruar” që nga data 22.6.2018.

**13.4** Nga dokumentacioni i administruar, ku vërehen data të ndryshme regjistrimi të personit fizik “A. V.”, si dhe nisur nga deklarimi i saj në DIPP-në e vitit 2008 “*Shumë cash 1,000,000 lekë në shtëpi, kursime nga të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar i subjektit fizik “A. V.”, që ka filluar veprimtarinë nga viti 1997 deri sot*”, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të saktësojë dhe të provojë me dokumentacionin ligjor vitin e fillimit të aktivitetit tregtar të nënës.

**13.5** Në përgjigje<sup>102</sup>, subjekti ka shpjeguar se data e saktë e fillimit ligjërisht të aktivitetit tregtar të nënës A. V. është data e regjistrimit të saj si person fizik në vitin 1998. Deri në pajisjen me NIPT, personat që ushtronin aktivitet tregtar regjistroheshin nga organi tatimor me kod fiskal dhe nga viti 2003 numri unik i identifikimit të subjektit u aplikua për identifikimin e subjekteve.

**13.6** DRT Korçë konfirmon<sup>103</sup> ndër të tjera se shtetasja A. V. në periudhën 2008 – 2016 ka deklaruar të ardhura dhe ka realizuar fitime, nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

**13.7** DPT-ja konfirmon<sup>104</sup> se A. V. figuron e regjistruar dhe ka paguar sigurimet shoqërore e shëndetësore për periudhën dhjetor 2011 – prill 2018. Sipas kësaj shkrese, subjekti tregtar “A. V.”, me NIPT \*\*\* ka këto të dhëna mbi të ardhurat, fitimin e realizuar dhe normën e fitimit, nga viti 2005 deri në vitin 2016. Bashkëlidhur, u administruan deklaramet vjetore të subjektit tregtar “A. V.” në Zyrën e Tatim Taksave, për çdo vit kalendarik të ushtrimit të aktivitetit.

**13.8** Për vitin ushtrimor 2010, në këtë shkresë vërehet se fitimi është 26,000 lekë. Në lidhje me këtë vit, subjekti ka sqaruar në pyetësin nr. 1 se ky deklarim ka qenë një lapsus dhe se në fakt fitimi atë vit ka qenë 260,000 lekë.

**13.9** Nga i njëjti dokument “Formular i deklarimit dhe pagesës të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël” për vitin 2010, i përcjellë nga dy shkresa të ndryshme të DRT Korçë dhe DPT-së<sup>105</sup>, rezultoi se fitimi i personi fizik “A. V.” është 26,000 lekë<sup>106</sup>. Ky fitim, si diferencë e të ardhurave me shpenzimet, është 26,000 lekë dhe është konsideruar në analizën financiare si e ardhur nga biznesi i nënës së subjektit për vitin 2010.

**13.10** DRT Korçë konfirmon<sup>107</sup> ushtrimin e aktivitetit tregtar nga subjekti tregtar “A. V.” për vitet 1999 – 2018, pagesat përkatëse të tatimeve dhe sigurimeve dhe të ardhurat e deklaruara.

**13.11** Bashkia Korçë konfirmon<sup>108</sup> se subjekti tregtar “A. V.”, me NIPT \*\*\* e aktivitet “Tregti artikuj të ndryshëm”, e regjistruar pranë Drejtorisë së të Ardhurave të kësaj bashkie, ka likuiduar taksat e tarifat lokale deri në vitin 2017, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

---

në vitin 2016. Bashkëlidhur deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2008, 2009, 2010, 2012 e 2013; (6) mandate bankare për veprime me Raiffeisen Bank të kryera nga shtetasja A. V..

<sup>101</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, nga QKB-ja.

<sup>102</sup> Përgjigjja nr. 15 e pyetësin nr. 2.

<sup>103</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2017, nga DRT Korçë.

<sup>104</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, nga DPT-ja.

<sup>105</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, e DRT Korçë, drejtuar ILDKPKI-së dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, nga DPT-ja, drejtuar Komisionit.

<sup>106</sup> Për vitin 2010, personi fizik “A. V.” ka deklaruar: të ardhurat 1,800,000 lekë, shpenzimet 1,774,000 lekë, fitimi 260,000 lekë. Këto vlera janë verifikuar edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, dërguar Komisionit nga DRT Korçë.

<sup>107</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, e DRT Korçë.

<sup>108</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2017, nga Bashkia Korçë.

**13.12** ISSH-ja konfirmon<sup>109</sup> pagën bruto e neto të subjektit tregtar “A. V.”, me NIPT \*\*\*, për periudhën janar 2012 – janar 2017.

**13.13** Gjatë hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të paraqesë dokumente mbi të ardhurat e nënës së saj nga viti 1993, kur nëna ka filluar të krijojë pasurinë e saj. Në përgjigje<sup>110</sup>, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin që provon regjistrimin e nënës A.V. si e vetëpunësuar, të ardhurat e realizuara, detyrimet tatimore të paguara dhe periudhat e sigurimit<sup>111</sup>.

**13.14** Në përmbledhje, sipas këtij dokumentacioni, duket se shtetasja A. V. është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë në vitin 1993 dhe vitet 1999 – 2011; është regjistruar si person fizik në DRT Korçë në vitet 1999 – 2000, 2002 – 2015 dhe vetëm për vitet 2005 – 2006 ka deklaruar të ardhura dhe ka paguar tatim të thjeshtuar mbi fitimin; është regjistruar në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Korçë, ku ka paguar taksat e tarifave vendore për periudhën 2004 – 12.4.2018 dhe ka deklaruar qarkullim vjetor të parashikuar për periudhën 2007 – 2013.

### Të ardhurat e ligjshme të personit fizik “A. V.”

**13.15** Bazuar në informacionin e mbledhur nga të gjitha shkresat e mësipërme, duke kombinuar të dhënat e marra nga DRT Korçë dhe Bashkia Korçë, është përllogaritur xhiroja dhe/ose fitimi për ato vite që mungojnë, sikurse paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Vitet	Xhiro e parashikuar/e përllogaritur * (në lek)	Tatimi i paguar (në lek)	Fitimi i dokumentuar/i përllogaritur** (në lek)
1998	<i>DRT Korçë nuk disponon të dhëna</i>		
1999	1,600,000*	20,000	251,630**
2000	1,600,000*	20,000	251,630**
2001	-	-	-
2002	1,600,000*	40,000	251,630**
2003	-	-	-
2004	1,600,000*	<i>Paguar tarifë</i>	251,630**
2005	802,000	22,696	126,129**
2006	1,800,000	27,000	283,083**
2007	1,600,000*		251,630**
2008	1,700,000	25,000	250,000
2009	1,900,000	26,000	260,000
2010	1,800,000	26,000	26,000
2011	1,240,000	0	240,000

<sup>109</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2017, nga ISSH-ja.

<sup>110</sup> Përgjigjet nr. 3 dhe nr. 15 të pyetësorit nr. 2.

<sup>111</sup> (1) Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2023, nga DRSSH Korçë, për regjistrimin e A. V. si person fizik, nr. \*\*\*, për periudhën 1.9.1993 – 31.12.1993 dhe bashkëlidhur vërtetimet për bazën e vlerësuar si person fizik nr. \*\*\* për vitet 1999 – 2000; si person fizik nr. \*\*\* për vitet 2001 – 2004; si person fizik me NIPT \*\*\*, për vitet 2005 – 2011; ka përfutur pension pleqërie nga data 9.7.2018 e në vijim, në shumën totale 1,082,086 lekë dhe bashkëngjitur tabela përmbledhëse; (2) Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2023, e DRT Korçë, për personin fizik “A. V.”, bashkëngjitur kopje të regjistrit dhe formularët e deklarimit të tatimit të thjeshtuar për vitet 2005 – 2006, që konfirmon se për A. V., për vitin 1998, nuk disponohen të dhëna; në regjistrin e vitit 1999 A. V. është e regjistruar me kod fiskal \*\*\* datë 21.7.1999, me aktivitet “Tregti me pakicë” dhe me paradhënie 20,000 lekë; në regjistrin e vitit 2000 është e regjistruar me kod fiskal \*\*\* datë 5.4.2000, me aktivitet “Ambulant” dhe me paradhënie 20,000 lekë; në regjistrin e vitit 2002 është e regjistruar me kod fiskal \*\*\* datë 21.2.2002 me aktivitet “Ambulant” dhe me paradhënie 20,000 lekë; për periudhën 11.3.2003 – 12.4.2018 personi fizik “A. V.” figuron i regjistruar me NIPT \*\*\*, me aktivitet “Tregti me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane”. Në datën 12.4.2018 ka kaluar me status i çregjistruar. Për vitet 2005 – 2006, ky person fizik ka deklaruar të ardhura dhe ka paguar tatim të thjeshtuar mbi fitimin sipas tabelës më poshtë, ndërsa të ardhurat për vitin 2007 janë deklaruar pranë administratës tatimore vendore; (3) Shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Korçë, ku për personin fizik “A. V.” ka konfirmuar pagesat e taksave dhe e tarifave vendore për vitet 2004 – 2018.

<sup>112</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023.

2012	1,280,000	0	260,000
2013	1,300,000	0	380,000
2014	1,254,600	25,000	300,225
2015	1,926,200	25,000	341,600
2016	2,806,014	0	333,727
<b>Total</b>			<b>4,058,912</b>

**13.16** Për vitet 1999, 2000, 2002 dhe 2004, e dhënë e disponueshme ishte vetëm tatimi i paguar në formë paradhënie. Bazuar në tatimin e paguar dhe ligjet në fuqi të kohës<sup>113</sup>, qarkullimi për këto vite i takon/korrespondon vlerës 0 - 2 milionë lekë/vit. Për vitin 2007, qarkullimi është po ashtu 0 - 2 milionë lekë/vit, bazuar në të dhënat e informuara nëpërmjet shkresës së Bashkisë Korçë.

**13.17** Për të përcaktuar një vlerë konkrete të qarkullimit në intervalin nga 0 - 2 milionë lekë, Komisioni është bazuar në xhiron e viteve 2005 – 2006 dhe 2008 – 2016, vite për të cilat ka të dhëna të konfirmuara nga DRT Korçë. Nga përllogaritjet, xhiroja mesatare ka rezultuar 1,600,000 lekë/vit.

- Sa i takon përllogaritjes së fitimit për të njëjtat vite, Komisioni është bazuar në fitimin e viteve 2008 – 2016, fitim ky i konfirmuar nga DRT Korçë, duke përllogaritur një normë mesatare fitimi në masën 15.73%<sup>114</sup>. Duke aplikuar këtë normë fitimi, është përllogaritur fitimi i personit fizik “A. V.” për vitet 1999 – 2000, 2002, 2004 deri në 2007-ën.

- Pagat për efekt të pagimit të sigurimeve shoqërore nuk janë përfshirë në analizën financiare për të gjitha vitet kur ka pasur fitim të biznesit, pasi për personat fizikë fitimi përfaqëson të ardhurat nga aktiviteti, ndërkohë që pagesat e sigurimeve shoqërore kryhen për efekt detyrimi/pensionit dhe jo për efekt të marrjes së pagës.

- Për vitet 1998, 2001 dhe 2003 nuk ka të dhëna të konfirmuara nga organet tatimore apo Bashkia për pagesa të detyrimeve tatimore; po ashtu subjekti nuk arriti të provonte me dokumente faktin se nëna e saj i është nënshtruar pagesave tatimore për shkak të ushtrimit të biznesit në vijimësi<sup>115</sup> në mënyrë që të mund të përllogariteshin xhiroja dhe fitimi për këto vite.

- Për këtë arsye, në këto vite janë konsideruar të ardhura minimale, të cilat janë nga pagat e konfirmuara nga Drejtoria Rajonale e ISSH Korçë, që në total janë në vlerën 274,054 lekë.

**13.18 Si përfundim**, deklarimi i nënës së subjektit të rivlerësimit është i saktë<sup>116</sup> për të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të saj, të cilat i takojnë periudhës kur subjekti ka qenë në detyrë.

**14. Vlerë monetare 3,500,000 lekë, të dhënë nga prindërit N. K. dhe S. K.**, të përfituar prej tyre nga shitja e pronave të fituara sipas vendimeve të ndryshme të Komisionit të Kthimit të Pronave. Vlera e deklaruar është dhënë në shumën të ndryshme, në data të ndryshme prej vitit 2008 deri në fund të vitit 2014, provuar me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.2.2016.

**14.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.12.2016, ku nëna e subjektit dhe prindërit e saj N. dhe S. K. deklarojnë se këta të fundit, nga shumt e përfituara nga shitja e pronave prej vitit 2008 deri në fund të vitit 2014, i kanë dhënë vajzës së tyre A. V. (nënës së subjektit) një shumë prej 3,500,000 lekësh. Kjo shumë është dhënë

<sup>113</sup> Ligji nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël” dhe ligji nr. 8715, datë 15.12.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, sipas të cilëve bizneset e vogla paguajnë kuota fikse për qarkullimin nga 0 deri në 2 milionë/vit.

<sup>114</sup> Shihni tabelën në pikën 16.7

<sup>115</sup> Sipas nenit 4 të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”: *Organet tatimore pajisin me “certifikatë regjistrimi” çdo person të regjistruar... personi që ushtron në vijimësi biznes, duke qenë subjekt i tatimit, është i detyruar të reregjistrohet me fillimin e vitit kalendarik, brenda muajit shkurt të çdo viti”.*

<sup>116</sup> Sipas deklaratës *Vetting*, të ardhurat e nënës për periudhën e rivlerësimit janë 2,384,422 lekë dhe sipas të dhënave të DRT Korçë, për të njëjtën periudhë 2008 – 2016, ato janë 2,391,552 lekë.

në kohë të ndryshme dhe vlera të ndryshme, por për shkak të marrëdhënies prindër - fëmijë, nuk janë dokumentuar me kontrata dhurimi.

**14.2** Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni mori në shqyrtim dy aspekte: (i) burimin e krijimit të shumës 3,500,000 lekë dhuratë; (ii) kohën dhe vlerën që prindërit i kanë dhuruar ndër vite nënës së subjektit të rivlerësimit.

**14.3** Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 3,500,000 lekë dhuratë në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur, përveç deklaratës noteriale si më lart, edhe; (i) 14 kontrata shitblerjeje, ku shtetasja N. K. (H.) dhe bashkëpronarët e tjerë, gjatë viteve 1995 – 2012 kanë shitur pronat e paluajtshme të tyre të fituara me vendim të KKKP-së; (iii) VKM nr. 169, datë 30.3.2001 dhe VKM nr. 549, datë 27.8.2014, për shpronësimin në interes publik, ku respektivisht trashëgimtarëve H. u shpronësohet sip. 1,130 m<sup>2</sup> (tokë, truall, ndërtesë), me çmimin 4,000 lekë/m<sup>2</sup>, si dhe shtetasen N. K. e 4 bashkëpronarëve të tjerë u shpronësohet sip. 250 m<sup>2</sup> truall, me vlerën totale 2,788,750 lekë; (iv) certifikatë familjare datë 25.10.2016 e gjendjes familjare të familjes K., në vitin 1974, ku bëjnë pjesë edhe shtetasit N. e S. K. (gjyshja e gjyshi i subjektit të rivlerësimit), si dhe shtetasja A. K. (nëna e subjektit të rivlerësimit).

**14.4** Për të provuar shitjen e pronave nga të cilat nëna dhe gjyshërit e subjektit të rivlerësimit kanë realizuar të ardhura, subjekti iu kërkua që të paraqesë dokumentacionin ligjor në lidhje me: (i) pronësinë e gjyshërve mbi këto pasuri dhe origjinën e pasurive; (ii) pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurive sipas tabelës vijuese; (iii) mandatpagesat/çdo dokument bankar etj., që provon përfitimin e shumave monetare të pjesës takuese të gjyshit/gjyshes, sipas VKM-së nr. 169, datë 30.3.2001 dhe VKM-së nr. 549, datë 27.8.2014, për shpronësim në interes publik.

**14.5** Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të provuar pronësinë e pasurive dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e tyre, subjekti depozitoi dokumentacionin shoqërues për secilën nga 14 kontratat e shitjes<sup>117</sup>:

**14.6** Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të provuar përfitimin e shumave monetare të pjesës takuese të gjyshit/gjyshes sipas VKM-së nr. 169, datë 30.3.2001 dhe VKM-së nr. 549, datë 27.8.2014, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar<sup>118</sup> se pronat e shpronësuara me këto VKM kanë origjinë vendimin nr. \*\*\*, datë 23.9.1999, të KKKPP të Këshillit të Rrethit Korçë, ndryshuar pikat

---

<sup>117</sup> Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.9.1995: vërtetimi hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.9.1995; kartela e kësaj pasurie ku pasqyrohen 5 pronarët e mëparshëm dhe pronari aktual. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.11.1997: vërtetimi hipotekor nr. \*\*\*, datë 19.11.1997; kartela e pasurisë nr. \*\*\* së mbetur me sip. 5,222 m<sup>2</sup>, e regjistruar në emër të 5 bashkëpronarëve, përfshirë edhe shtetasen N. K. dhe blerësin. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.9.2000: e regjistruar në ZRPP me nr. \*\*\*, datë 4.9.2000; mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 4.9.2000, shuma 2,500 lekë, e paguar si tatim për vlerën 500,000 lekë; kartela e pasurisë nr. \*\*\*, ku shtetasja N. K. ka 1/3 pjesë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.3.2001: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 12.3.2001, për pagimin e shumës 35,000 lekë si tatim për vlerën 3,500,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.8.2002: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 15.8.2002, për pagimin e shumës 9,000 lekë si tatim mbi vlerën 1,800,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.8.2002: mandatarkëtimi nr. \*\*\* datë 29.8.2002, për pagimin e shumës 2,500 lekë si tatim mbi vlerën 500,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2003: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 8.10.2003, me shumën 40,000 lekë, si tatim mbi vlerën 4,000,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.2.2004: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 24.2.2004, me shumën 7,500 lekë, si tatim mbi vlerën 1,500,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2005: mandatarkëtimet nr. \*\*\*, datë 28.12.2005 dhe nr. \*\*\*, datë 28.12.2005, për shumën 5,000 lekë, si tatim mbi vlerën 1,000,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.9.2006: mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 18.9.2006, për shumën 2,500 lekë, si tatim mbi vlerën 120,000 lekë. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.1.2009: formulari standard i ZVRPP-së Korçë, ku pasqyrohet shuma e taksës/tarifës 101,700 lekë për kalim pronësie me shënimin “U arkëtua”. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.7.2011: “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë” dhe mandatpagesë pranë Tirana Bank, datë 7.7.2011, për pagimin e shumës 1,365 lekë, me përshkrimin “Tatim mbi shitjen”. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2012: “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë” dhe 2 mandatpagesa datë 24.1.2012 për pagesat e shumave 5,600 lekë dhe 600 lekë pranë \*\*\*. Për kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2012: “Pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë” dhe 2 mandatpagesa datë 24.1.2012 për pagesën e shumave 12,000 lekë dhe 5,400 lekë pranë \*\*\*.

<sup>118</sup> Përgjigjja nr. 14/c e pyetësorit nr. 2.

1 dhe 1/a të tij me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.11.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilat subjekti ia ka bashkëlidhur shpjegimeve. Gjyshja N. H.(K.), si trashëgimtare ligjore e babait të saj I. H. (P.), është bashkëpronare në 1/3 pjesë dhe ka përfituar 1/3 e shumës së përfituar nga qeveria, në rastin e shpronësimeve për interesa publikë<sup>119</sup> (bashkëlidhur ka depozituar vendimin nr. \*\*\*, datë 14.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit I. H., ku vajza e tij N. H., gjyshja e subjektit të rivlerësimit, është trashëgimtare e 1/3 pjesë së çdo pasurie të tij).

**14.7** Në lidhje me dokumentacionin që provon tërheqjen e shumës takuese, sipas VKM-së nr. 169, datë 30.3.2001, subjekti shpjegon se nuk ka mundur të gjejë dokumentacionin sepse gjyshja ka ndërruar jetë, koha e përfitimit të shumës është shumë e hershme, ndërsa në banka nuk ka funksionuar sistemi elektronik dhe kërkimi manual është i vështirë<sup>120</sup>.

**14.8** Në lidhje me dokumentacionin që provon tërheqjen e shumës së akorduar me VKM-në nr. 549, datë 27.8.2014, nga gjyshja N. K., subjekti shpjegoi se gjyshja e ka tërhequr shumën totale prej 929,000 lekësh nga Raiffeisen Bank, dega Korçë, me 2 këste: në datën 17.12.2014, shumën 500,000 lekë; në datën 18.12.2014, shumën 429,000 lekë<sup>121</sup>, si dhe shuma 929,000 lekë i takon vetëm gjyshes dhe përbën 1/3 e shumës totale 2,788,750 lekë që përfituan bashkëpronarët H.<sup>122</sup>.

**14.9** Shumat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme janë treguar më mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, ku në kolonën e parafundit është përlloritur pjesa takuese e gjyshit dhe gjyshes së subjektit. Janë konsideruar si të ardhura të ligjshme ato për të cilat është provuar përfitimi fizik i tyre dhe është paguar tatimi mbi të ardhurat nga shitja e pronës/ave.

Nr.	Pasuria e shitur	Data e shitjes	Vlera e kontratës	Pjesa takuese e gjyshërve	Shuma e përfituar nga gjyshërit	Paguar tatim	Shuma e përfituar për të cilat është provuar pagesa e tatimit
1	Truall 255 m <sup>2</sup> , *** – Korçë	4.9.1995	450.000	1/6	75.000	Po <sup>123</sup>	75.000
2	Truall 620 m <sup>2</sup> rruga Korçë – ***	19.11.1997	1.240.000	1/3	413.333	Po	413.333
3	Truall 571 m <sup>2</sup> , Korçë	4.9.2000	500.000	1/3	166.667	2.500	166.667
4	Truall 2.176 m <sup>2</sup> + ndërtesë 2.297 m <sup>2</sup>	12.03.2001	3.500.000	6/10	2.100.000	35.000	2.100.000
5	Truall 342 m <sup>2</sup> , Korçë	15.8.2002	1.800.000	1/3	600.000	9.000	600.000
6	Truall 210 m <sup>2</sup> , Korçë	29.8.2002	500.000	1/4	125.000	2.500	125.000
7	Truall 1.642 m <sup>2</sup> , Korçë	7.10.2003	4.000.000	1/3	1.333.333	40.000	1.333.333
8	Truall 124 m <sup>2</sup>	24.2.2004	1.500.000	1/3	500.000	7.500	500.000
9	Truall 1.268 m <sup>2</sup> , Mborje – Korçë	23.12.2005	1.000.000	1	1.000.000	5.000	1.000.000
10	Truall 309 m <sup>2</sup> , Korçë	13.9.2006	500.000	2/6	166.667		166.667
11	Truall 101.7 m <sup>2</sup> , Korçë	20.1.2009	900.000	3/9	300.000	Po	300.000
12	Truall 245 m <sup>2</sup> + banesë 86 m <sup>2</sup> , Korçë	6.7.2011	2.450.000	3/9	816.667	1.365	816.667
13	Truall 300 m <sup>2</sup> , Korçë	23.1.2012	2.500.000	3/9	833.333	5.600	833.333
14	Truall 253 m <sup>2</sup> , Korçë	23.1.2012	2.000.000	3/9	666.667	5.400	666.667

<sup>119</sup> Sqaruar në përgjigjen nr. 3 të pyetësorit nr. 3.

<sup>120</sup> Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti depozitoi kërkesën datë 9.10.2023, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

<sup>121</sup> Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti depozitoi dy mandatet “Tërheqje nga llogaria”, datë 17.12.2014 e datë 18.12.2014, nga Raiffeisen Bank.

<sup>122</sup> Përgjigjja nr. 3 e pyetësorit nr. 3.

<sup>123</sup> Pagesa ndaj shtetit bëhej në formën e pullave fiskale dhe në dosje nuk pasqyrohet mandatpagesë.

15	Truall përfituar me VKM-në nr. 169, datë 30.3.2001	<i>Nuk provohet</i>	4.250.000	1/3	1.416.667	<i>Nuk paguhet</i>	_124
16	Truall përfituar me VKM-në nr. 549, datë 27.8.2014	2014	2.788.750	1/3	929.000	<i>Nuk paguhet</i>	929.000
	<b>Total</b>		<b>29.878.750</b>		<b>11.442.33</b>		<b>10.025.667</b>

**14.10** Të ardhurat e gjyshërve, të cilat kanë shërbyer si burim për dhurimin e shumës 3.5 milionë lekë, të përfituara nga shitja e pasurive për vitet 1995 – 2014, e provuar me kontratat e paraqitura nga subjekti dhe për të cilat është paguar tatimi në burim, janë në total 9,859,000 lekë<sup>125</sup>. Kjo shumë, e ndarë sipas periudhave kur është përfituar, të cilat përkojnë me deklaratimet e subjektit dhe familjarëve të saj, rezulton si vijon: (i) nga viti 2004 deri në vitin 2006 – përfituar vlera 1,666,667 lekë, e cila përkon me shumën 1,600,000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, që i është dhuruar prindërve të subjektit gjatë kësaj periudhe; (ii) nga viti 2008 deri në vitin 2014 – përfituar vlera 3,545,667 lekë, e cila përkon me shumën 3,500,000 lekë, dhënë prindërve të subjektit gjatë kësaj periudhe, sipas deklaratës noteriale të gjyshërve.

**14.11** Gjatë hetimit administrativ, subjekti u pyet<sup>126</sup> nëse kanë përfituar edhe 3 fëmijët e tjerë të ardhura nga shitja e pasurive të prindërve të tyre S. dhe N. K. apo ka përfituar vetëm nëna e saj. Nëse kanë përfituar, të sqarojë dhe provojë me dokumentacion ligjor, kohën dhe vlerën e përfituar nga secili prej tyre.

**14.12** Sipas shpjegimeve të subjektit<sup>127</sup>, kanë përfituar vlera monetare nga shitja e pronave të prindërve të tyre edhe 2 fëmijët e tjerë, A. K. dhe L. B., por ata nuk posedojnë kontrata dhurimi ose dokument tjetër, për shkak të marrëdhënies së ngushtë prind-fëmijë dhe sepse paratë janë dhënë *cash* ashtu siç janë marrë nga shitjet. Për të provuar shpjegimet, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratat noteriale të dy motrave dhe vëllait të nënës së saj, që konfirmojnë këto shpjegime<sup>128</sup>.

**14.13** Nga sa më sipër, rezultoi se gjyshërit e subjektit të rivlerësimit kanë përfituar gjithsej në mënyrë të ligjshme shumën 11,442,333 lekë, nga viti 1995 deri në fund të vitit 2014 dhe krijohet bindja e mbështetur edhe në prova se ata iu kanë dhuruar tre fëmijëve të tyre shumën totale prej 11,400,000 lekësh.

### **Në lidhje me kohën dhe vlerën që prindërit i kanë dhuruar ndër vite nënës së subjektit të rivlerësimit**

**14.14** Nisur nga deklarimi i nënës së subjektit në deklaratën *Vetting* se vlera 3,500,000 lekë është dhënë në shuma të ndryshme, në data të ndryshme prej vitit 2008 deri në fund të vitit 2014, por nuk ka përcaktuar shumën e dhuruar çdo vit as në deklaratën *Vetting* dhe as në DIPP-në e viteve 2008 – 2014, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të shpjegojë dhe provojë me dokumentacion

<sup>124</sup> Nuk është provuar nëse dhe kur janë marrë fizikisht shumat e përfituara me VKM-në nr. 169/2001.

<sup>125</sup> Këtu nuk janë përfshirë shumat e përfituara nga kontratat e paraqitura në rreshtat 10 dhe 15 të tabelës.

<sup>126</sup> Pyetja nr. 4 e pyetësorit nr. 3 (nga certifikata familjare bashkëlidhur deklaratës *Vetting* rezulton se shtetasit S. dhe N. K., gjyshërit e subjektit, përveç nënës së subjektit, kanë edhe 3 fëmijë të tjerë, L., L. dhe A. K.).

<sup>127</sup> Përgjigjja nr. 3 e pyetësorit nr. 3.

<sup>128</sup> Deklaratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.11.2023, e shtetasit A. K.: “*Ka përfituar nga tjetërsimi i pronave në periudhën 1995 – 2014 shumën totale 4,400,000 lekë, sikurse rezulton nga kontratat e depozituara nga subjekti*”; deklaratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.11.2023, e shtetasit L. B.: “*Ka përfituar në periudhën viti 2002 – 2014 shumën totale 3,500,000 lekë, por në këtë deklaratë nuk specifikohet nëse shuma e përfituar rrjedh nga kontratat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit, apo edhe nga shitja e pronave të tjera*”; deklaratë nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 29.11.2023, e shtetasit L. Q. (K.): “*Nuk ka përfituar nga shitja e pronave, pasi ka qenë në gjendje shumë të mirë ekonomike, si bashkëpronare në shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., e nuk ka pasur nevojë*”.



justifikues vlerën e secilës shumë monetare dhuratë që ka përfituar nëna e saj; kohën kur i ka përfituar ato; për çfarë është përdorur secila nga këto shuma dhe kohën e përdorimit të tyre.

**14.15** Në përgjigje<sup>129</sup>, subjekti ka shpjeguar se dhurimet nuk kanë asnjë motiv tjetër përveç marrëdhënies prind-fëmijë, ku prindërit kanë dashur të ndihmonin ekonominë familjare të vajzës së tyre (nënës së subjektit), prandaj bazuar mbi këtë marrëdhënie, si dhe për shkak se prindërit e subjektit nuk kanë pasur ndonjëherë detyrimin për të deklaruar, ata nuk kanë pasur kujdesin e shtuar për t'i dokumentuar dhurimet me kontratë dhurimi apo ndonjë akt tjetër dhe as të ruajnë dokumente të ndryshme që provojnë dhurimin e shumave, në total 3.5 milionë lekë. Shumat janë dhënë në *cash*, jashtë sistemit bankar (pjesën takuese në çmimin e shitjeve). Gjyshërit kanë ndërruar jetë para shumë vitesh dhe prindërit nuk mund të kujtojnë datën e saktë të dhurimit për secilën shumë, por dhurimet janë bërë në raste festash e momente të veçanta familjare kur kryenin shpenzime apo blinin sende/pasuri etj., apo në kohën e përafërt kur janë shitur pronat nga prindërit e nënës së subjektit. Sipas prindërve të subjektit:

a) Gjatë vitit 2002 janë dhënë gjithsej 500,000 lekë të përfituara nga shitjet deri në këtë vit. Kjo shumë së bashku me shumën 200,000 lekë, që buron nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.1997, që janë mbajtur *cash* në banesë, kanë shërbyer për blerjen nga babai i subjektit të një garazhi, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2003.

b) Gjatë periudhës 2004 – janar 2005 është dhënë shuma totale 1,200,000 lekë (500,000 lekë si të ardhurat ndër vite të gjyshes N. K. nga tjetërsimi i pronave ku ajo ka qenë bashkëpronare + 700,000 lekë nga të ardhurat prej shitjes së pronave ku gjyshi ishte bashkëpronar).

c) Në fund të dhjetorit 2005 ose fillim janari i vitit 2006 është dhënë shuma 400,000 lekë nga të ardhurat e gjyshit, i cili sapo kishte tjetërsuar një pronë (sipas shpjegimeve, subjekti mendon se janë përfituar nga shitja sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2005).

ç) Gjatë periudhës 2009 – 2010 janë përfituar 500,000 lekë që janë mbajtur *cash* në banesë dhe janë përdorur për të krijuar depozitën në datën 11.1.2011.

d) Në fund të dhjetorit 2014 janë përfituar 400,000 lekë, sapo gjyshja N. K. ka përfituar të ardhurat nga ekzekutimi i VKM-së nr. 549, datë 27.8.2014, për shpronësimin për interesa publikë.

dh) Diferenca 500,000 lekë nga totali 3,500,000 lekë është dhënë në kohë të ndryshme, në vlera të vogla, por prindërve nuk u kujtohet koha dhe shuma konkrete. Janë përdorur për shpenzimet e përditshme.

**14.16** Pra, sipas këtyre shpjegimeve, në vitet 2004 – 2006 prindërit e subjektit kanë përfituar gjithsej 1,600,000 lekë, siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, nga të cilat 250,000 lekë janë shpenzuar nga babai i subjektit për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” (D) në datën 28.11.2006; shuma 1,000,000 lekë është mbajtur *cash* në banesë deri kur babai i subjektit ka krijuar depozitën prej 3,000,000 lekësh, në datën 11.1.2011 pranë Intesa Sanpaolo Bank, dega Korçë (kjo gjendje *cash* është deklaruar dhe në DIPP-në e vitit 2008); diferenca 350,000 lekë është shpenzuar gjatë periudhës 2004 – 2006, duke i lënë mundësi prindërve të shtonin kursimet nga të ardhurat prej aktivitetit tregtar të nënës.

**14.17** Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se shuma 1,600,000 lekë është pjesë e shumës 3,500,000 lekë që nënës ia kanë dhuruar prindërit e saj sipas deklaratës noteriale datë 8.12.2016. Gjithashtu, në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, për të provuar deklaratimet e tyre, gjyshërit dhe nëna kanë deklaruar dhe kanë nënshkruar para noterit deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.12.2016, ku megjithëse si datë fillimi kanë pasqyruar vitin 2008, në fakt

<sup>129</sup> Përgjigjja nr. 13 e pyetësorit nr. 2.

kanë pasqyruar shumën totale të dhënë në tërësi ndër vite prej vitit 2002, pra edhe para vitit 2008. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2008, prindërit e saj kanë deklaruar se shuma është dhënë nga shtetasi S. K. (babai i nënës) dhe prindërit bëjnë me dije se duke u shprehur kështu kanë dashur të thonë që shumat janë dorëzuar fizikisht nga gjyshi si kryefamiljar, por në fakt të ardhurat janë siguruar edhe nga shitja e pronave ku gjyshja ishte bashkëpronare.

**14.18** Në mënyrë të përmbledhur, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi dhurimin e shumës totale prej 3,500,000 lekësh nga gjyshërit tek nëna e saj A. V., në kohë dhe vlera sipas viteve, janë treguar në tabelën vijuese.

Vitet/periudha	2002	Janar 2004 – janar 2005	Dhjetor 2005 – janar 2006	2009 – 2010	Dhjetor 2014	Kohë e pacaktuar	Totali
Vlera e dhuruar (lek)	500.000	1.200.000	400.000	500.000	400.000	500.000	<b>3.500.000</b>

**14.19** Komisioni, duke marrë në cilësinë e provës deklaratën noteriale të vitit 2016, deklarin në DIPP-në e vitit 2008, si dhe shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, ka vlerësuar që vlerat dhe koha e përfitimit të shumave nga nëna e subjektit të konsiderohen si vijon:

- i) Shuma e dhuruar deri në vitin 2006 ka qenë 2,100,000 lekë<sup>130</sup>; këto vlera janë përdorur për krijimin e depozitave bankare në vitet 2005 – 2006.
- ii) Diferenca prej 1,400,000 lekësh është dhuruar në periudhën 2008 – 2016.

**14.20** Komisioni ka verifikuar mundësinë e gjyshërve të subjektit për t'i dhuruar vajzës së tyre/nënës së subjektit shumën 3,500,000 lekë.

**14.21** Sipas tabelës përmbledhëse të shumave që kanë përfituar gjyshërit si më sipër, rezulton se kanë përfituar nga shitja e pronave të tyre shumën 10,025,667 lekë nga muaji shtator 1995, kur është shitur prona e parë, deri në fund të vitit 2014. Kjo shumë përfaqëson të ardhura për të cilat është paguar tatimi në burim dhe i mbulon tërësisht dhuratat e gjyshërve ndaj nënës së subjektit.

**14.22** Për sa më sipër, u provua dhurimi tek prindërit e subjektit i vlerës monetare prej 3.5 milionë lekësh dhe mundësia financiare e gjyshërve për ta poseduar këtë shumë nga burime të ligjshme. Meqë këto dhurata janë menaxhuar nga prindërit e subjektit, ato u përfshinë në analizën financiare në këtë mënyrë: (i) shuma 2,100,000 lekë në analizën financiare kumulative të subjektit dhe familjes së saj deri në fund të vitit 2006, para emërimit në detyrë të subjektit; (ii) shuma 1,400,000 lekë si e kursyer dhe e mbartur prej prindërve, pasi ata janë shkëputur nga bashkëjetesa me subjektin. Analizuar në pikën 12.5 të këtij vendimi.

**14.23** Është konsideruar që gjyshërit kanë përballuar shpenzimet e jetesës me pensionet e tyre<sup>131</sup> dhe në këtë mënyrë vlerat monetare të përfituara nga shitjet e pasurive kanë qenë fonde të lira për t'ua dhuruar fëmijëve të tyre.

**14.24 Në konkluzion të të gjithave sa më sipër**, ka rezultuar se gjyshërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhuruar vajzës së tyre A. V. shumën 3,500,000 lekë ndër vite. Këto dhurime janë përfshirë si të ardhura të ligjshme përkatësisht në analizën financiare të subjektit dhe familjes para detyrës së saj dhe në analizën financiare të prindërve pas shkëputjes së subjektit nga trangu familjar.

<sup>130</sup> Në DIPP-në e vitit 2008, babai ka deklaruar dhuratë nga gjyshërit e subjektit në vlerën 1.6 milionë lekë, ndërkohë që shuma prej 500,000 lekësh e dhuruar në vitin 2002 është shpenzuar në vitin 2003 e, për këtë arsye, nuk ka qenë pjesë e inventarit të deklaruar në këtë deklaratë.

<sup>131</sup> Në analizë nuk përfshihen as pensionet dhe as shpenzimet e jetesës, pasi efekti financiar i tyre është 0 (zero).

## ❖ Pasuritë e deklaruara nga shtetasi E. V., vëllai i subjektit të rivlerësimit

**15. Llogari depozite e hapur në datën 4.3.2015**, me afat maturimi 1-vjeçar, e hapur pranë BKT-së, dega Korçë. Shuma e depozitës është 1,000,000 lekë nga të cilat 500,000 lekë kursime nga paga (të kaluara nga llogaria rrjedhëse në llogari depozitë) dhe 500,000 lekë të dhëna nga familja, nga të ardhurat e tyre. Pjesa takuese: 100%.

**15.1** Në deklaratën *Vetting*, shtetasi E. V. ka deklaruar edhe: “*Vlerë monetare 464,840 lekë në llogarinë rrjedhëse të kreditimit të pagës si punëmarrës në shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., e hapur pranë BKT sh.a, dega Korçë. Zotëroj 100%*”.

**15.2** Nga shqyrtimi i dokumenteve bashkëlidhur deklaratës *Vetting*<sup>132</sup>, si dhe i lëvizjes së llogarisë së shtetasit E. V., evidentohet se në llogarinë rrjedhëse nr. \*\*\* në emër të tij, e çelur në mars të vitit 2013, është kredituar paga çdo muaj nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Në datën 4.3.2015, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 507,140 lekë. Po në këtë datë, shtetasi E. V. ka kaluar në depozitë shumën 500,000 lekë e njëkohësisht ka depozituar *cash* 500,000 lekë, duke krijuar shumën 1,000,000 lekë, që e ka investuar në depozitë me afat 1-vjeçar.

**15.3** Kështu, depozita 1,000,000 lekë me afat 1-vjeçar, për shumën 500,000 lekë, e krijuar nga pagat e patërhequra të shtetasit E. V. që nga prilli 2013 deri më 31.12.2014, ka pjesërisht burim të ligjshëm. Sa i takon mundësisë së vëllait të subjektit për të kursyer këto paga, rezulton se ai ka pasur mundësinë të krijojë këto kursime gjatë viteve 2013 dhe 2014<sup>133</sup>.

**15.4** Gjithashtu, në datën e deklaratës *Vetting*, llogaria rrjedhëse kishte gjendje shumën 464,840 lekë, e krijuar nga pagat e patërhequra të vëllait të subjektit pas datës 31.12.2014. Kështu, krijimi i balancës së llogarisë vjen nga një burim i ligjshëm dhe sipas analizës financiare duket se shtetasi E. V. ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar shumën 464,840 lekë, pasi analiza financiare e tij dhe e prindërve për vitet 2013 dhe 2014 rezulton me balanca pozitive, të cilat janë potencial kursimi për familjen e origjinës së subjektit, si subjekte jodeklaruese.

**15.5** Meqë subjekti nuk provoi me dokumentacion burimin e deklaruar në deklaratën *Vetting* të shumës 500,000 lekë, dhënë shtetasit E. V. nga familja e tij, shumë që e ka depozituar *cash* në llogarinë rrjedhëse, atëherë Komisioni i kërkoi subjektit që të sqarojë dhe provojë me dokumentacion ligjor kohën kur e ka marrë vëllai këtë shumë dhe a ka kontribuar ajo në krijimin e këtyre kursimeve.

**15.6** Në përgjigje<sup>134</sup>, subjekti ka shpjeguar se në datën e krijimit të depozitës nga vëllai ajo ishte shkëputur nga familja, pasi kishte filluar bashkëjetesën në një tjetër banesë. Në ditën e krijimit të depozitës, babai i ka dhënë vëllait shumën 500,000 lekë *cash*, pa ndonjë dokument, për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare. Subjekti nuk i ka dhënë vëllait para *cash* në mënyrë të drejtpërdrejtë për krijimin e kësaj depozite, por ka kontribuar në krijimin e kursimeve familjare me të ardhurat e saj ndër vite që nga fillimi i punës si gjyqtare deri në fillimin e bashkëjetesës. Këto të ardhura të saj, përveç shumave që në fund të çdo viti figurojnë në bankë si kursime të saj personale apo që kanë mbuluar ndonjë shpenzim (udhëtim/pushime), i dorëzonte në familje, pasi ishin prindërit që në përditshmëri i administronin të ardhurat dhe shpenzimet për nevojat familjare. Sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, prindërit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, prandaj nuk kanë pasur detyrimin t’i deklarorin kursimet që kanë krijuar ndër vite.

<sup>132</sup> (i) Kontratë depozite datë 3.3.2016 e lidhur midis shtetasit E. V. dhe BKT-së; (ii) *statement* datë 18.10.2016 nga BKT-ja, e llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në emër të shtetasit E. V.; (iii) vërtetim datë 17.10.2016 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., që konfirmon se shtetasi E. V. është i punësuar pranë saj që nga muaji mars 2013, me pagë mujore 31,500 lekë.

<sup>133</sup> Shihni rezultatin financiar për vitet 2013 e 2014, në tabelën përmbledhëse në fund të këtij vendimi.

<sup>134</sup> Përgjigjja nr. 11 e pyetësorit nr. 2.

## **Analiza financiare**

**15.7** Komisioni ka verifikuar mundësinë e familjes së subjektit, të vëllait dhe prindërve të saj, në krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, sipas së cilës ka rezultuar se familja e subjektit ka pasur mundësi për t'i dhënë vëllait shumë 500,000 lekë *cash*, për t'i depozituar në llogari dhe për të krijuar depozitën 1,000,000 lekë. Analiza dhe argumentet për të janë pasqyruar në pikën 12.5 të këtij vendimi.

## **ANALIZA FINANCIARE**

**16.** Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kishte komunikuar subjektit të rivlerësimit analizën financiare, duke përfshirë dy periudha:

i) *Periudhën para detyrës, 1993 – 5.10.2007*, sipas së cilës ishte analizuar mundësia e familjes së subjektit për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet e krijuara (në bankë dhe *cash*) deri në datën 5.10.2007, likuiditete të cilat u përdorën për të blerë apartamentin në vitet 2012 dhe 2013 kur subjekti ishte në detyrë. Nga kjo analizë kishte rezultuar një mungesë burimesh të ligjshme nga ana e prindërve të subjektit, në vlerën totale prej -1,051,706 lekësh.

ii) *Periudhën gjatë detyrës, 5.10.2007 – 31.12.2016*, sipas së cilës kishte rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet e saj, si dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet, për shkak të një balance negative në vlerën -544,304 lekë dhe konkretisht shuma -10,386 lekë në vitin 2014 dhe -533,919 lekë në vitin 2015.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare**

**16.1** Në përmbledhje të prapësimeve të saj, sa i takon analizës financiare, subjekti ka kërkuar nga Komisioni si vijon:

- Shtrirjen e analizës financiare nga viti 1993 deri në fund të vitit 2008, për verifikimin e mundësisë së prindërve për të kursyer, sipas deklaratimit të këtyre të fundit në DIPP-në e vitit 2008, pretendim ky i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni.
- Konsiderimin e të ardhurave nga personi fizik "H. V." për vitin 1993, pretendim ky i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni.
- Korrigjimin e të ardhurave të personit fizik "A. V.", duke përlogaritur një marzh fitimi më të lartë, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni.
- Konsiderimin e të ardhurave nga shitja e kamionit nga babai i saj, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni.
- Zerimin e balancës negative të vitit 2014 për shkak të potencialit kursyes të prindërve të saj, pretendim i cili është marrë parasysht.
- Heqjen e reduktimit të shpenzimeve të dy bashkëjetuesve për vitin 2015 dhe pranimin e të ardhurave në vlerën 500,000 lekë, të dhuruara bashkëjetuesit nga prindërit e tij si rezultat i shitjes së produkteve bujqësore, pretendim i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni.

**16.2** Gjithashtu, në përfundim të analizës financiare, në prapësimet e saj, subjekti, duke u nisur nga vlera e vogël e mungesës së të ardhurave të ligjshme për të krijuar pasuritë, kërkoi që Komisioni të zbatojë parimin e proporcionalitetit me qëllim që në vlerësimin e saj dhe ndaj saj të mos aplikohet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e pasurisë, duke sjellë në vëmendje disa

vendime nga praktika e Komisionit<sup>135</sup>, që kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar, dhe e Kolegjit<sup>136</sup>, si dhe duke pretenduar se:

- Ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj.
- Nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorimin të saj.
- Pasuria neto në pronësinë e saj e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit në raport me të ardhurat është disa herë më e vogël, ndërkohë që neni D i Kushtetutës parashikon si masë disiplinore shkarkimi, rastin kur subjekti ka një pasuri më tepër se dyfishi i të ardhurave të ligjshme.

## Vlerësimi i Komisionit

**16.3** Në përfundim të hetimit administrativ, prapësimeve dhe shpjegimeve në seancën dëgjimore, Komisioni, duke marrë parasysh disa nga pretendimet e subjektit, sikurse janë trajtuar hollësisht

<sup>135</sup> Vendimi nr. 188, datë 24.7.2019: "...trupi gjykues çmon se bilanci përfundimtar, i konstatuar në vlerën negative prej 1.170.217 lekësh, ...në vetvete dhe në tërësinë e fakteve dhe rrethanave, nuk vlerësohet shkak i mjaftueshëm që të pasjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi për sa i përket përlllogaritjeve dhe rezultateve financiare, të cilat kryhen nëpërmjet një analizetë thelluar, strikte dhe gjithëpërfshirëse, ato duhet të vlerësohen në harmoni me kuadrin e plotë të rrethanave dhe provave të arritura, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit". Vendimi nr. 218, datë 10.12.2019: "Subjekti në analizën financiare të realizuar nga Komisioni rezultoi me një diferencë në vlerë 856.228 lekë (referuar dy momenteve të blerjes së dy pasurive ku subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme)... E njëjta logjikë, e bazuar në parimin e proporcionalitetit, vlen dhe duhet të përdoret në analizimin në harmoni të të gjitha kritereve të këtij procesi rivlerësimi, përfshirë këtu edhe kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se diferencat e konstatuara në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk mund të çojnë në një përfundim të përgjithshëm mbi mungesën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk mund të pasjellin shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra". Vendimi nr. 215, datë 4.12.2019: "50. Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2015, pas analizës financiare të përditësuar në vlerën prej -602,850 lekësh, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit". Vendimi nr. 176, datë 8.7.2019: "Komisioni vlerëson se balancat negative vetëm për dy vite 2005 dhe 2007, në shumën totale 388,371 lekë, janë vlera të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit, nëse do marrim në konsideratë metodologjinë e përdorur për analizën financiare... trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, ...në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, subjekti ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit".

<sup>136</sup> Vendimi nr. 31, datë 18.11.2020: "...rezultoni se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për të likuiduar kështu e parë të apartamentit, në vlerën 838.738 lekë, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, por kjo situatë, në vlerësimin e trupit gjykues, është e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkak shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë". Vendimi nr. 38, datë 6.12.2021: "...Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagimin e kështit të parë prej 9.000 euro, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68,8 m<sup>2</sup>, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, por e cila u konkludua nga trupi gjykues se nuk është e mjaftueshme për t'u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016". Vendimi nr. 2, datë 2.2.2023: "19.21 Kolegji vlerësoi mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 872.576 lekësh, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit dhe në konsideratë të faktit se kjo vlerë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit". Vendimi nr. 4, datë 16.2.2023: "Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me kryerjen e pagesave të kësteve për pasurinë apartament banimi ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë dhe shpenzimet e investimet e kryera në vitet 2006, 2008 dhe 2015, e cila rezultoi në shumën 981.732 lekë, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. Vendimi 19, datë 10.6.2022: "29.13. Kolegji i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 1.272.570 lekë. 29.14. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2006 – 2016, trupi gjykues ... vlerëson se bilanci negativ rezultoi të jetë konsiderueshëm më i vogël se ai i konstatuar nga Komisioni. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo problematikë nuk mund të shërbejë për t'u kualifikuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. 30. Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

në arsyetimin e këtij vendimi, ka kryer analizën financiare të subjektit, duke përfshirë: (i) periudhën 1993 – 31.12.2008 dhe atë gjatë detyrës, 5.10.2007 – 31.12.2016.

**16.4** Analiza financiare për periudhën 1993 – 2008 analizon pasuritë e blera dhe likuiditetet e krijuara (në bankë dhe *cash*) nga prindërit e subjektit të rivlerësimit deri në datën 31.12.2008, kur ato janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2008. Kjo analizë ka synuar verifikimin e mundësisë financiare të prindërve të subjektit, si subjekte me detyrim deklarimi vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për të krijuar kursime në vlerën 2.5 milionë lekë, të cilat u përdorën për pagesën e një apartamenti me sip. 104 m<sup>2</sup>, në Korçë, pagesa të kryera në vitet 2012 dhe 2013, apartament ky i blerë gjatë kohës kur subjekti ka qenë në detyrë dhe që ajo e ka në përdorim nga janari i vitit 2015.

**16.5** Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara të subjektit nga Shkolla e Magjistraturës dhe punësimi gjatë viteve 2007 – 2008, të ardhurat e prindërve të subjektit, dhurata nga gjyshërit dhe çdo e ardhur tjetër e evidentuar gjatë hetimit administrativ. Sipas analizës së rishikuar të Komisionit, ka rezultuar se subjekti dhe familja e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre depozitave/kursimeve për periudhën e sipërcituar.

**16.6** Fakti që analiza kumulative shtrihet edhe brenda periudhës kur subjekti është emëruar në detyrë, ka të bëjë me faktin e kursimeve familjare, të cilat: (i) burojnë nga të ardhurat e prindërve; (ii) administrohen prej tyre. Kështu që, duke mos qenë subjekte deklaruese prindërit e subjektit janë përfshirë në këtë analizë me të gjitha të ardhurat, pasuritë, shpenzimet dhe likuiditetet e tyre, duke iu njohur të drejtën që ata të mund të përdorin kursime nga të ardhurat familjare, të cilat vijnë nga vite të mëparshme. Pra, balancat pozitive të viteve 2007 dhe 2008 konsiderohen si kursime potenciale të prindërve të subjektit, të cilat ata mund t'i përdorin për të krijuar depozitat në *cash* gjatë këtyre dy viteve. Kjo qasje e Komisionit është bazuar në përvojën e tij në raste të ngjashme dhe në standardin tashmë të konsoliduar të Kolegjit për çështjen e prindërve të subjektit dhe pasurive të tyre si persona të lidhur<sup>137</sup>.

**16.7** Nga ana tjetër, përfshirja e viteve 2007 dhe 2008 në periudhën e analizës kumulative nuk ka penguar Komisionin që analizën për periudhën e rivlerësimit ta shtrijë nga data 5.10.2007 e në vijim, pa krijuar mbivendosje. Kjo sepse subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se jeton me prindërit e saj, ka detyrimin të deklarojë çdo vit kursimet e saj në *cash* dhe analiza financiare për të bëhet me bazë vjetore dhe jo duke përdorur metodologjinë kumulative.

Përshkrimi	1993 – 31.12.2008
<b>Pasuri</b>	<b>5,516,544</b>
Blerë apartament me privatizim 15.4.1993	8,510
Apartament 84 m <sup>2</sup>	1,900,000
Garazh 40.3 m <sup>2</sup>	700,000
Blerë dyqan me privatizim	40,855
Blerë tokën e dyqanit me privatizim	2,088
Mercedes-Benz, me targë ***, vit prodhimi 1996, datë 28.11.2006	250,000
<i>Shtesa/pakësime e likuiditeteve</i>	<i>2,615,091</i>
<b>Të ardhura, dokumentuar</b>	<b>10,901,202</b>
Të ardhurat e babait nga paga 1993 – 1999	156,021
Të ardhurat nga pensioni i invaliditetit të babait nga 18.8.1999	719,587
Të ardhurat nga ndihma ekonomike babait nga Bashkia 08/2005	63,800

<sup>137</sup> Vendimi nr. 20, datë 3.5.2023, i Kolegjit.

Të ardhurat e babait si PF nga viti 1993	1,400,000
Të ardhurat e nënës nga paga (vërtetime ISSH)	280,063
Të ardhurat e nënës nga PF nga viti 1998	1,917,360
Të ardhurat e subjektit	1,853,174
Nga shitja e apartamentit fituar me privatizim 1993	1,900,000
Nga shitja e apartamentit fituar me dhurim 13.3.1995	330,000
Të ardhurat nga interesat bankarë	181,198
Dhuratë nga gjyshi tek nëna e subjektit	2,100,000
<b>Shpenzime</b>	<b>5,329,947</b>
Shpenzime jetese për 4 persona	4,879,297
Paguar kur është privatizuar dyqani + toka	13,300
Paguar në Hipotekë kur janë blerë apartament + garazh	1,950
Paguar në Hipotekë për regjistrim kur është pjesëtuar dyqani	1,400
Paguar qira për subjektin gjatë studimeve	434,000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>54,711</b>

**16.8 Analiza financiare gjatë ushtrimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit,** nga data 5.10.2007 deri më 31.12.2016, e cila është kryer së bashku me familjen e origjinës deri në fund të vitit 2014 dhe më pas me bashkëjetuesin e saj për vitet 2015 dhe 2016.

**16.9** Pas parashtrimeve të subjektit, nga ana e Komisionit janë konsideruar disa elemente, të cilat janë trajtuar në pikën 16.1 të këtij vendimi.

- Të ardhurat e dokumentuara të anëtarëve të familjes dhe shpenzimet e tyre, sipas përbërjes familjare të viteve përkatëse; likuiditetet e familjes (*cash* dhe bankë) sipas dokumenteve bankare dhe për gjendjen *cash* sipas shpjegimeve të saj të dhëna gjatë hetimit administrativ, të cilat korrespondojnë edhe me lëvizjet bankare edhe me pagesat për apartamentin ku banon subjekti i rivlerësimit.
- Dhurata nga gjyshërit dhënë tek nëna e subjektit në shumën 500,000 lekë gjatë viteve 2009 – 2010.
- Të ardhurat e bashkëjetuesit të dhuruara nga prindërit e tij në shumën 500,000 lekë në vitin 2015.
- Çdo e ardhur dhe shpenzim tjetër, të evidentuara gjatë hetimit administrativ.

**16.10** Sipas analizës së rishikuar, rezultati financiar për të gjithë periudhën e rivlerësimit është një pamundësi në total në vlerën -252,363 lekë nga -544,305 lekë që ishte me rezultatet e hetimit.

**16.11** Komisioni, duke u nisur nga vlera e vogël e mungesës së të ardhurave të ligjshme për të krijuar pasuritë, si dhe bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, i aplikuar në praktikën e gjerë të Kolegjit për raste të ngjashme, vlerëson që ndaj subjektit të rivlerësimit nuk mund të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e pasurisë.

### **Konkluzion për kriterin e pasurisë**

**17.** Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të, si dhe duke arsyetuar mbi bazën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se:

- Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në këtë deklaratë pasuritë e saj, personave të lidhur me të dhe personave të tjerë të lidhur, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara dhe nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht.
- Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj.

**17.1 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.**



## Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit

Përshkrimi	Nga 5.10.2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>-37,738</b>	<b>936,464</b>	<b>566,119</b>	<b>258,441</b>	<b>584,429</b>	<b>-270,510</b>	<b>461,307</b>	<b>646,756</b>	<b>-719,311</b>	<b>-196,965</b>
Apartament 104 m <sup>2</sup>						1,500,000	1,000,000			
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>-37,738</i>	<i>936,464</i>	<i>566,119</i>	<i>258,441</i>	<i>584,429</i>	<i>-1,770,510</i>	<i>-538,693</i>	<i>646,756</i>	<i>-719,311</i>	<i>-196,965</i>
Gjendja e likuiditeteve	1,678,628	2,615,091	3,181,211	3,439,652	4,024,081	2,253,572	1,714,879	2,361,635	1,642,324	1,445,359
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>491,861</b>	<b>1,530,184</b>	<b>1,643,858</b>	<b>1,324,598</b>	<b>1,456,836</b>	<b>1,268,658</b>	<b>1,707,672</b>	<b>1,741,176</b>	<b>2,408,530</b>	<b>2,071,782</b>
Të ardhurat subjekti nga paga	406,050	737,742	951,697	921,018	926,759	837,222	994,494	1,011,428	1,225,577	1,189,724
Të ardhurat babai nga pensioni	22,904	95,724	102,588	106,644	110,068	113,004	115,777	120,246		
Të ardhurat nëna nga PF	62,907	250,000	260,000	26,000	240,000	260,000	380,000	300,225		
Të ardhurat nga vëllai E.							198,576	294,414		
Të ardhurat nga interesat bankarë		60,676	79,573	20,936	180,009	58,432	18,825	14,863	0	0
Të ardhurat nga paga bashkëjetuesi									671,071	882,058
Dhuarat nga gjyshërit			250,000	250,000						
Likuiditete të mbartura nga BSH (sistemim) veprimi)									11,882	
Të ardhurat nga toka bujqësore bashkëjetuesi									500,000	
<b>SHPENZIME</b>	<b>143,557</b>	<b>546,480</b>	<b>568,427</b>	<b>546,480</b>	<b>636,375</b>	<b>773,006</b>	<b>693,790</b>	<b>1,104,805</b>	<b>3,380,205</b>	<b>1,487,798</b>
Shpenzime jetese për 4 persona	130,257	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	448,552	470,184
Shpenzime udhëtimi TIMS	13,300	0	21,947	0	89,895	192,814	129,694	16,813	425,476	317,614
Kontribut për pension vullnetar						22,000				
Shpenzime mobilimi sipas deklarimeve të subjektit									2,000,000	700,000
Derdhje shumash nga vëllai E. në BKT								208,000		
Marrja e depozitave të prindërve ***/2014 (sistemim veprimi)									506,176	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>386,042</b>	<b>47,240</b>	<b>509,312</b>	<b>519,677</b>	<b>236,031</b>	<b>766,162</b>	<b>552,575</b>	<b>0</b>	<b>-252,363</b>	<b>780,949</b>

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar<sup>138</sup> pranë Komisionit raportin nr. \*\*\*, datë 2.11.2022 mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2023, të KDZH-së.

2. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës së AKSIK-së, në përfundim të verifikimit, ka konkluduar se:

a) *Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.*

b) *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

**Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.**

3. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2024, AKSIK-ja ka dërguar pranë Komisionit raportin e përditësuar nr. \*\*\*, datë 2.4.2024, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.5.2024, të KDZH-së.

4. Në këtë raport, Grupi i Punës konfirmon se:

- *Për subjektin Sonjela Voskopi nuk disponohen të dhëna dhe nuk ka sinjalizime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.*

- *Informacionet/të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese flasin vetëm për bashkëjetuesin e znj. Sonjela Voskopi, ku informohemi se në cilësinë e avokatit, ai mund të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm me qëllim favorizimin e të pandehurve.*

- *Gjithashtu, bëhemi me dije se autoritetet verifikuese kanë ndarë informacione të përditësuara me SPAK-un, ku e kanë përmendur bashkëjetuesin e znj. Sonjela Voskopi.*

- *Nga SPAK-u informohemi se ka një procedim penal, i cili është në fazën e hetimeve paraprake dhe nuk rezulton të ketë persona të regjistruar si persona nën hetim.*

5. Në lidhje me konstatimet e Grupit të Punës sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë edhe informacionin e pasqyruar në kapitullin “Konstatime të tjera”, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë po me ushtrim ndikimi të paligjshëm dhe jo vetëm, për të cilat Komisioni rezervon të drejtën e ruajtjes së sekretit hetimor në mbështetje të vendimit të GJEDNJ-së “Regner kundër Republikës Çeke”, subjektit iu kërkua që të japë shpjegime të qarta dhe shteruese.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6. Në prapësime, subjekti, duke e vlerësuar shterues, të plotë dhe objektiv hetimin që ka bërë Komisioni, ka shpjeguar se: *Së pari*, pavarësisht se AKSIK-ja ka administruar<sup>139</sup> nga autoritetet verifikuese informacionin se bashkëjetuesi “*në cilësinë e avokatit mund të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm me qëllim favorizimin e të pandehurve*” dhe përmend që autoritetet verifikuese kanë ndarë informacione të përditësuara me SPAK, nga ana tjetër AKSIK-ja ka thelluar hetimin, duke kërkuar informacion në SPAK, nga i cili i është bërë me dije se bashkëjetuesi i saj nuk është regjistruar si person nën hetim në ndonjë procedim penal; *Së dyti*, këtë verifikim e ka bërë edhe

<sup>138</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2023, të AKSIK-së.

<sup>139</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2024, drejtuar Komisionit.

vetë Komisioni, duke kërkuar informacion të detajuar sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2014, dhe nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kthyer përgjigje me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2024, se nuk rezulton që në emër të shtetasit I. F. të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

**6.1** Neni 38 i ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, përcakton standardet e kontrollit të pastërtisë së figurës për subjektet e rivlerësimit: *bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme*. Nëse këto standarde do të përdoren edhe për verifikimin e pastërtisë së figurës së personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, atëherë këto prova të kërkuara nga ligji për të penalizuar një person nuk ekzistojnë në rastin konkret dhe informacionet janë të pabesueshme dhe të pabazuara, përderisa kanë kaluar në filtrin e SPAK-ut dhe ndaj bashkëjetuesit nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

**6.2** Subjekti ka shprehur bindjen e saj se bashkëjetuesi si “Avokat” nuk ka bërë dhe nuk do të bënte asnjë veprim të paligjshëm që përbën vepër penale apo shkelje etike të profesionit të avokatit dhe asnjë veprim që do të cenonte imazhin e saj si gjyqtare.

**6.3** Duke cituar çështjet penale që Komisioni ka administruar dhe shqyrtuar për shkak të të dhënave të organeve ligjzbatuese në lidhje me veprimet e bashkëjetuesit të saj si avokat, si dhe konkluzionet që ka arritur Komisioni për këto çështje se: (i) *Duket se në veprimet e subjektit nuk ka veprime që e ngarkojnë atë me përgjegjësi;* (ii) *Duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk konstatohen mangësi në veprimet e saj,* subjekti ka pretenduar se këto konkluzione tregojnë që vendimmarrjet e saj kanë qenë të bazuara në ligj dhe, si rrjedhim, rrëzojnë çdo dyshim që mund të jenë ndikuar nga të tretët.

**6.4** Duke shpjeguar se bashkëjetuesi i saj nuk e ka filluar profesionin “Avokat” si një jurist i thjeshtë e pa eksperiencë, subjekti ka përmendur mjaft kualifikime, tituj, diploma, trajnime dhe pozicionet e punës së bashkëjetuesit, për të treguar eksperiencën e tij akademike dhe praktike, ambiciet dhe integritetin e tij si jurist<sup>140</sup>. Kjo përgatitje profesionale e bashkëjetuesit, si dhe rënia e numrit të çështjeve për shkak të riorganizimit të Gjykatave, ka sjellë ashpërsimin e konkurrencës mes avokatëve, duke përdorur edhe metoda të pandershme si: letërshkrues pranë agjencive verifikuese, duke përcjellë informacione që megjithëse janë të pabazuara dhe të pavërteta marrin “vëmendje” pikërisht sepse depozitohen pranë një agjencie verifikuese/ligjzbatuese.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**7.** Në lidhje me konstatimet mbi figurën e bashkëjetuesit I. F., të pasqyruara në rubrikën “Kontrolli i figurës”, duke risjellë në vëmendje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2024, AKSIK-ja që referon se për bashkëjetuesin e subjektit ka një procedim penal, i cili është në fazën e hetimeve paraprake, por emri i tij nuk është regjistruar si person nën hetim, Komisioni, për këtë informacion, vlerëson se ka vend të zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë, që për sa kohë personi nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit dhe as është vërtetuar fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së

---

<sup>140</sup> Diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (diplomë nr. \*\*\*, datë 18.4.2008) dhe në Fakultetin e Filozofisë – Departamenti i Shkencave Politike (diplomë nr. \*\*\*, datë 10.11.2009) me rezultate të shkëlqyera; diplomuar në Master Shkencor – Drejtimi Penal në Universitetin e Prishtinës (diplomë nr. \*\*\*, datë 2.12.2010); botues i disa librave dhe publikimeve në fushën e të Drejtës Penale, kriminalistikës dhe jurisprudencës; Pjesëmarrës në disa trajnime dhe specializime të organizuara nga Departamenti i Drejtësisë – Ambasada e SHBA Prishtinë dhe ABA \*\*\* (vitet 2007 – 2008, provuar me certifikatat përkatëse); pjesëmarrës me vlerësim maksimal në një sërë trajnimesh të fushës civile, penale (në vitet 2006 – 2007) të organizuara nga USAID dhe ABA \*\*\* pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Prokuroria Speciale Prishtinë; i vlerësuar me “Mirënjohje” nga Forumi Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës; i angazhuar në publikime të ndryshme tek revistat juridike “E Drejta e Fakultetit Juridik” dhe “Revista Politicum e Fakultetit të Shkencave Politike dhe Administratës Publike”; jurist pranë Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë; kryesekretar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; kancelar i Gjykatës së Apelit Korçë; Kryetar i Avokaturës së Shtetit Zyra Korçë; pedagog i jashtëm në disa universitete shtetërore e private; anëtar i Kolegjit të Avokaturës së Shtetit.

prerë, ai person nuk mund të quhet fajtor për kryerjen e një vepre penale. Kjo në analogji edhe të nenit 110, pika 1/d e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë vështrim, Komisioni vlerëson se ky informacion nuk është në nivelin e provës së mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

**7.1** Në vijim, duke mbajtur në konsideratë edhe nivelin, edhe integritetin profesional të bashkëjetuesit që rezulton nga provat e paraqitura prej subjektit në prapësime, çështjet penale të shqyrtuara gjatë hetimit nga Komisioni që rezultuan pa problematika, mungesën e kontakteve të papërshtatshme në kuptim të neneve 34, 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016 nga ana e subjektit ose bashkëjetuesit të saj, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet për të aplikuar ndaj saj nenin 61, pikat 2 dhe 5 të këtij ligji.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**8.** Grupi i Punës në KLGJ, në bazë të ligjeve nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, ka hartuar raportin<sup>141</sup> mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi, raport, i cili, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, është hartuar duke u bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit<sup>142</sup>.

<sup>141</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2022, i KLGJ-së.

<sup>142</sup> **5/i) Aftësitë profesionale**, ku përfshihen: (a) *Njohuritë ligjore* dhe (b) *Arsyetimi ligjor*. Në lidhje me *Njohuritë ligjore*, në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit përgjithësisht identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe arsyeton qartë mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; shfaq aftësi në interpretimin dhe zbatimin e ligjit; zgjidh drejt çështjen në gjykim; njezh dispozitat procedurale të gjykimit të çështjeve penale apo civile; njezh dhe zbaton parimet e procesit të rregullt ligjor. Në 3 dosjet e paraqitura nga subjekti dhe në 5 dosjet e përzgjedhura për vëzhgim janë ankimuar 4 prej tyre dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e subjektit, ndërsa në 4 rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.

Në lidhje me *Arsyetimin ligjor*, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi; vendimet e saj përpilohen qartë dhe të kuptueshme, kanë qartësi arsyetimi dhe referenca ligjore. Në ndërtimin dhe strukturimin e vendimeve respektohen kërkesat e legjislacionit procedural civil dhe atij penal. Tri dosjet e paraqitura nga subjekti dhe në pesë dosjet e përzgjedhura për vëzhgim nuk është evidentuar të jenë cenuar me vendim të Gjykatës së Apelit ose Gjykatës së Lartë. Në pesë dosjet e përzgjedhura për vëzhgim, subjekti i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

**5/ii) Aftësitë organizative**, ku përfshihen: (a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*; (b) *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*; (c) *Aftësia për të administruar dosjet*.

(a) Në lidhje me *Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë* – referuar të dhënavë që ka përcjellë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë rezulton se subjekti ka pasur një rendiment të përfundimit të çështjeve prej 94.7%, pra ngarkesa sasiore e çështjeve që ka gjykuar subjekti ka qenë mbi standardin minimal. Në 5 dosjet e përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë deri në 6 muaj e 7 ditë. Në dosjet nr. 1 dhe nr. 2, që janë pjesë e këtyre 5 dosjeve, çështjet familjare janë gjykuar përtej afatit standard të gjykimit, por ka rezultuar se seancat janë shtyrë për shkaqe të arsyeshme, ndërsa çështjet penale janë gjykuar brenda afatit standard të gjykimit. Në 3 dosjet e dorëzuara nga subjekti rezulton se dy dosjet (nr. 1 dhe nr. 3) janë gjykuar përtej afatit standard të gjykimit. Aftësia e subjektit për gjykim të shpejtë të çështjeve nuk është bërë objekt ankesash. Në 5 dosjet e përzgjedhura me short rezultoi se në dosjen nr. 5, vendimi është arsyetuar përtej afatit ligjor 5-ditor nga data e shpalljes së vendimit. Në përfundim të analizës së të dhënavë si më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur ngarkesë sasiore me çështje dhe përgjithësisht ka respektuar afatet standarde të gjykimit dhe të arsyetimit të vendimit; (b) Në lidhje me *Aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, subjekti ka aftësi të planifikojë dhe organizojë veprimet e nevojshme për përgatitjen e çështjeve për gjykim brenda afatit ligjor nga data e caktimit të shortit, si dhe për caktimin e seancave në vijimësi. Të gjitha seancat janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë regjistruar në sistemin audio. Subjekti i rivlerësimit orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, për çdo kërkesë apo hap procedural merr mendimin e palëve, kujdeset që të realizohet e drejta e përfaqësimit dhe e mbrojtjes për palët, disponon me vendim të ndërmjetëm çdo veprim procedural që kryen gjatë gjykimit. (c) Në lidhje me *Aftësinë për të administruar dosjet*, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të administruar dosjet, të gjitha aktet gjyqësore dhe provat e administruara janë të rregullta e të radhitura në mënyrën që lehtësojnë identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre.

**8.1** Gjithashtu, raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve si vijon:

### **Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**9.** Formulari i vetëdeklarimit, dorëzuar në KLD më 30.1.2017, paraqitet i nënshkruar nga subjekti, i plotë sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur.

**10.** Sipas formularit të vetëdeklarimit rezulton se znj. Sonjela Voskopi, në periudhën tetor 2007 – tetor 2016, ushtron detyrën e gjyqarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjatë periudhës maj 2009 – janar 2014, subjekti ka punuar edhe si pedagoge e jashtme pranë universitetit jopublik “\*\*\*”, në Fakultetin e Drejtësisë.

**11.** Referuar vërtetimeve<sup>143</sup> të lëshuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe certifikatave përkatëse të trajnimit, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në 19 trajnime të zhvilluara nga kjo shkollë dhe në 5 trajnime nga institucione të tjera.

### **Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit**

**12. Dokumenti nr. 1** – Vendimi penal nr. \*\*\*, datë 17.1.2014, që i përket të pandehurit S. X., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal)

**12.1** Nga verifikimi i praktikës konstatohet se gjykimi ka zgjatur 11 muaj e 11 ditë, i cili është jashtë afatit 9-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

**12.2** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, për konstatimin e lartpërmendur.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**12.3** Në prapësimet e saj, subjekti ka shpjeguar kronologjinë e seancave gjyqësore:

- Çështja penale është regjistruar në datën 6.2.2013. Në datën 15.2.2013, brenda afatit 10-ditor është planifikuar seanca e parë gjyqësore në datën 26.2.2013.
- Në intervalin kohor 26.2.2013 – 24.6.2013 gjykimi është pezulluar 3 herë sepse nuk paraqitej i pandehuri, duke depozituar edhe raportet mjekësore përkatëse.
- Në vijim janë zhvilluar seanca gjyqësore në datat 24.6.2013, 1.7.2013, 10.7.2013 dhe 24.7.2013 (i pandehuri ka kërkuar përjashtimin e subjektit dhe sipas nenit 18, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale është shtyrë gjykimi, derisa një tjetër gjyqtar të jepte vendim për kërkesën

---

**5/iii) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale** përfshin: (a) *Etikën në punë*; (b) *Integritetin*; (c) *Paanësinë*. (a) Në lidhje me *Etikën në punë* nuk rezulton të ketë pasur ankesa për qëndrime jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Gjithashtu, nuk rezulton të ketë asnjë kërkesë apo propozim për masë disiplinore. (b) Në lidhje me *Integritetin*, nga të dhënat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. (c) Në lidhje me *Paanësinë*, nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit; nuk ka kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar; asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

**5/iv) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**, ku përfshihen: (a) *Aftësitë e komunikimit*; (b) *Aftësia për të bashkëpunuar*; (c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*. (a) Në lidhje me *Aftësinë e komunikimit* rezulton se subjekti komunikon me etikë me palët në proces duke ruajtur paanësinë dhe barazinë e palëve në proces. (b) Në lidhje me *Aftësinë për të bashkëpunuar* nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Nuk ka pasur dështim të seancave gjyqësore për shkak të moskomunikimit të subjektit me administratën gjyqësore. (c) Në lidhje me *Gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti i ka marrë pjesë në 19 trajnime të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe që kanë lidhje me detyrën e saj si gjyqtare në fushën civile e penale të së drejtës.

<sup>143</sup> Vërtetimet nr. \*\*\*, datë 26.10.2016, nr. \*\*\*, datë 21.5.2015 dhe nr. \*\*\*, datë 22.6.2015, të Shkollës së Magjistraturës.

e të pandehurit. Kjo kërkesë nuk është depozituar me shkrim në sekretarinë gjyqësore, por nga ana e të pandehurit është paraqitur një shkresë më shkrim dore, ku shprehej “se heq dorë nga kërkesa për përjashtim”. Shqyrtimi gjyqësor ka vijuar në seancën datë 24.9.2013, pasi muaji gusht ka qenë pushim. Në vijim janë caktuar seancat në datat 7.10.2013, 22.10.2013, 5.11.2013 (e shtyrë për njoftimin e një dëshmitari sipas nenit 132/2 të Kodi të Procedurës Penale nëpërmjet policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Korçë, pasi adresa e disponuar nga prokurori ka rezultuar e paplotë për njoftimin e tij), 19.11.2013, 25.11.2013 (e shtyrë sipas kërkesës me shkrim të prokurorit në mungesë për shkak të angazhimit në veprime hetimore të ngutshme në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013), 6.12.2013, 20.12.2013, 7.1.2014 dhe 17.1.2014. Gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Janë pyetur 11 dëshmitarë.

**12.4** Pra, shpjegon subjekti, referuar akteve të dosjes gjyqësore rezulton se:

- Të gjitha seancat gjyqësore janë caktuar brenda afatit ligjor 15-ditor, përveç atyre të caktuara tej këtij afati, në respektim të rekomandimit të mjekëve mbi gjendjen shëndetësore të të pandehurit.
- Janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm seancash gjyqësore për shkak të llojit të gjykimit, si dhe kompleksitetit të çështjes.
- Disa nga seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të përligjura, të pavarura nga gjykata.
- Gjatë periudhës së gjykimit, në muajin gusht, gjyqtarët trajtohen me leje vjetore.

**12.5** Për sa më lart, subjekti vlerëson se afati 9-mujor i gjykimit është tejkaluar për shkaqe objektive. Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar akte të dosjes gjyqësore, që provojnë shpjegimet saj<sup>144</sup>.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**12.6** Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime nga subjekti, vëren se ajo ka argumentuar në mënyrë të detajuar duke provuar edhe me prova shkresore shkaqet ligjore dhe rrethanat e administrimit të gjykimit që e kanë kushtëzuar në këtë veprim, si dhe ka treguar kujdes për të zhvilluar një gjykim korrekt në respektim të dispozitave ligjore procedurale dhe në administrimin e afateve ligjore.

**12.7 Komisioni arriti në përfundimin se në gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti nuk u konstatuan mangësi dhe zvarritje të procesit gjyqësor në kohë për faj të subjektit të rivlerësimit, duke mos e ngarkuar atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.**

**13. Dokumenti nr. 2** – Vendimi penal nr. \*\*\*, datë 27.6.2014, për gjykimin e të pandehurve R. H., P. H. dhe G. V. të akuzuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” në bashkëpunim (nenet 88/1 e 25 të Kodit Penal)

**13.1** Rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për gjykimin e të pandehurve R. H., P. H. dhe G. V., për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” në bashkëpunim. Në përfundim të gjykimit, prokurori ka kërkuar deklarimin fajtor të të

---

<sup>144</sup> Fletën e parë të dosjes gjyqësore të çështjes ndaj shtetasit S. X.; vendim datë 15.2.2013 për caktimin e seancës gjyqësore; raportet mjekoligjore të datave 30.1.2013, 21.1.2013, 24.4.2013 dhe 22.5.2013; ekokardiografia; epikrizë mjekësore datë 13.1.2013 e shtetasit S. X. nga spitali i zemrës “R. Xh.”; kërkesë datë 24.6.2013 e shtetasit S. X. për heqje dorë nga kërkesa për përjashtim të subjektit nga gjykimi; fletëthirrje datë 22.10.2013, datë 5.11.2013, e subjektit drejtuar shërbimit të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Korçë; kërkesë datë 25.12.2013 për shtyrje seance gjyqësore; procesverbalet gjyqësore të datave 26.2.2013, 2.5.2013, 24.5.2013, 24.6.2013, 1.7.2013, 10.7.2013, 24.7.2013, 22.8.2013, 24.9.2013, 7.10.2013, 22.10.2013, 5.11.2013, 19.11.2013, 25.11.2013, 6.12.2013, 20.12.2013, 7.10.2013 dhe 17.1.2013.

pandehurve dhe dënimin e të pandehurit R. H. me 5 vjet burgim; të pandehurit P. H. me 5 vjet burgim; të pandehurit G. V. me 1 vit e 6 muaj burgim.

**13.2** Çështja është gjykuar me trup gjykues (ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese), i cili me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.6.2014, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurve për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” në bashkëpunim dhe dënimin e të pandehurve: R. H. me 3 vjet e 6 muaj burgim; P. H. me 3 vjet burgim; G. V. me 1 vit burgim. Në caktimin e këtyre masave të dënimit janë mbajtur parasysh midis të tjerave edhe mosha e të pandehurve, P. H. 19 vjeç dhe G. V. 17 vjeç, por që ky i fundit ishte edhe në proces gjykimi në gjendje të lirë për veprën penale “Vjedhje”.

**13.3** Vendimi është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2015, të Gjykatës së Apelit Korçë.

#### **13.4 Nuk u konstatuan mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**14. Dokumenti nr. 3** – Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 11.11.2015, që i përket kërkesit – E. Ç., ndërhyrës kryesor – A. Ç., objekt “Vendosje e të miturve A. C., O. Ç. në kujdestari dhe caktimi i E. Ç., daja i të miturve, si kujdestar”

**14.1** Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2015, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së shtetasit E. Ç., duke i vendosur fëmijët në kujdestarinë e tij; rrëzimin e kërkesës së ndërhyrësit kryesor A. Ç.”.

**14.2** Vendimi është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.3.2016, të Gjykatës së Apelit Korçë.

**14.3** Rezulton se çështja është regjistruar në datën 16.6.2015 dhe vendimi është shpallur në datën 11.11.2015.

**14.4 Konstatohet se gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 15 ditë, duke tejkaluar kështu afatin standard 4-mujor, parashikuar nga pika 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të gjyqtarëve.**

**14.5** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, për konstatimin e lartpërmendur.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**14.6** Në prapësimet e saj, subjekti ka shpjeguar kronologjinë e seancave gjyqësore, si vijon:

**14.7** Çështja e regjistruar në datën 16.6.2015 ka rënë për gjykim fillimisht pranë gjyqtares M. M.. Për shkak të transferimit të saj si gjyqtare në gjykatë tjetër, çështja është rishortuar sipas urdhrin nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2015, të Kryetarit të Gjykatës dhe në datën 23.7.2015 i është caktuar për gjykim subjektit.

**14.8** Sipas paragrafit 3 të nenit 181 të Kodit të Procedurës Civile, çështja ka filluar nga fillimi, prandaj në datën 30.7.2015 subjekti ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 11.9.2015, për shkak se gjatë muajit gusht gjyqtarët trajtohen me leje vjetore.

**14.9** Në seancën e datës 11.11.2015 ka përfunduar shqyrtimin gjyqësor, palët kanë dhënë konkluzionet përfundimtare dhe subjekti ka shpallur vendimin përfundimtar.

**14.10** Rezulton se të gjitha seancat janë zhvilluar në mënyrë produktive, janë shtyrë në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të plotë e shterues dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore për të administruar aktin e vlerësimit psikologjik dhe raportin nga shërbimet sociale pranë Bashkisë, duke pasur parasysh natyrën e çështjes. Seancat gjyqësore janë caktuar brenda një afati të arsyeshëm nga njëra-tjetra. Sipas subjektit, nëse zbriten periudhat kur dosja ka qenë në gjykim pranë gjyqtares M. M. (nga data e regjistrimit 16.6.2015 deri në datën e rishortimit 23.7.2015 dhe muaji gusht si

periudhë e lejes vjetore), rezulton se çështja është gjykuar nga subjekti brenda afatit caktuar nga pika 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

**14.11** Bashkëngjitur, subjekti ka depozituar akte të dosjes gjyqësore për të provuar shpjegimet e saj<sup>145</sup>.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**14.12** Pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime nga subjekti, konstatoi se gjykimi është kryer brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe subjekti është kujdesur të mos ketë zvarritje të gjykimit.

**14.13 Komisioni arriti në përfundimin se në gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti nuk konstatohen mangësi.**

### **Pesë dosjet e përzgjedhura me short për vlerësimin profesional**

**15. Dosja nr. 1** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 1.6.2016, për çështjen me paditës E. G., të paditur B. U., me objekt “Zgjidhje martesë, lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve tek paditësi dhe detyrimin e së paditurës të paguajë detyrim ushqimor 6,000 lekë për secilin fëmijë”.

**15.1** Nga shqyrtimi i dosjes ka rezultuar se padia është regjistruar në datën 11.12.2015. Janë zhvilluar 9 seanca me diferencë kohore 2-3 javë nga njëra-tjetra. Shtyrjet e seancave kanë pasur shkaqe të arsyeshme.

**15.2** Në përfundim të hetimit gjyqësor, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2016, subjekti ka vendosur pranimin e padisë për zgjidhjen e martesës, por referuar aktit të ekspertimit datë 5.4.2016, të ekspertit psikolog, si dhe qëndrimit të paditësit që ndryshoi gjatë gjykimit, fëmijët iu lanë për rritje dhe edukim nënës së tyre, së paditurës. Gjithashtu, subjekti ka përcaktuar edhe kohën e takimit të paditësit me fëmijët dhe masën e detyrimit ushqimor.

**15.3** Vendimi i subjektit nuk është ankimuar dhe në datën 17.6.2016 ka marrë formë të prerë.

**15.4 Konstatohet se gjykimi ka zgjatur 6.5 muaj, pra tej afatit 4-mujor për çështjet familjare, i përcaktuar në pikën 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të gjyqtarëve.**

**15.5** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për konstatimin e lartpërmendur.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**15.6** Në prapësimet e saj, subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar kronologjinë e seancave gjyqësore, shkaqet ligjore të shtyrjes së tyre të provuara për çdo rast, që konsistojnë në mungesën qoftë të paditësit, ashtu edhe të të paditurit, caktimin e ekspertit dhe afatin për hartimin dhe depozitimin e aktit të ekspertimit, marrjen e dokumenteve të duhura ligjore nga institucione në shtete të huaja, në formën e kërkuar nga ligji etj., duke pretenduar që disa prej tyre janë shtyrë për arsye ligjore dhe objektive, të pavarura nga vullneti i saj.

---

<sup>145</sup> Informacioni i printuar nga SIM i çështjeve gjyqësore; urdhri nr. \*\*\*, datë 22.7.2015, për rihedhje në short të çështjeve të gjyqtarës M. M.; procesverbale seancash të datave 11.11.2015, 11.9.2015, 29.10.2015, 2.10.2015; tri fletëthirrje datë 30.7.2015 për palët ndërgjyqëse; fletëthirrje datë 11.9.2015; shkresa “Kërkim informacioni” datë 2.10.2015, drejtuar Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Emigracionin Korçë; dy shkresa “Martje Informacioni” datë 2.10.2015, drejtuar Zyrës së Shërbimeve Sociale Bashkia Korçë dhe Bashkia Vlorë; vendim datë 30.7.2015, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.



**15.7** Bashkëngjitur prapësimeve, subjekti depozitoi akte të dosjes për të provuar shpjegimet e saj<sup>146</sup>.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**15.8** Nga shqyrtimi i prapësimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni vëren se subjekti ka argumentuar dhe provuar në mënyrë bindëse dhe shteruese shkaqet që kushtëzuan shtyrjen e gjykimit përtej afatit 4-mujor për çështje të llojit familjare.

**15.9 Komisioni arriti në përfundimin se në gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti nuk konstatohen mangësi.**

**16. Dosja nr. 2** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, për gjykimin e padisë me paditës E. S., të paditur T. S., me objekt “Zgjidhje martesë, lënien për rritje dhe edukim të fëmijës E. S. 4 vjeç tek paditësja dhe të fëmijës A. S.7 vjeç tek i padituri; paditësja të marrë mbiemrin e vajzërisë”.

**16.1** Ka rezultuar se padia është regjistruar në datën 14.1.2015. Janë zhvilluar 10 seanca me diferencë kohore 2-4 javë nga njëra-tjetra.

**16.2** Në përfundim të hetimit gjyqësor, subjekti ka vendosur pranimin e padisë sipas kërkimeve.

**16.3** Vendimi i subjektit nuk është ankimuar dhe në datën 31.8.2015 ka marrë formë të prerë.

**16.4 Komisioni ka konstatuar se gjykimi ka zgjatur 6 muaj, pra tej afatit 4-mujor për çështjet familjare, i përcaktuar në pikën 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të gjyqtarëve.**

**16.5** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për konstatimin e lartpërmendur.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**16.6** Në prapësimet e saj, subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar kronologjinë e seancave gjyqësore, shkaqet ligjore të shtyrjes së tyre të provuara për çdo rast, që konsistojnë në mungesën e të paditurit, sepse ai jetonte në shtetin grek, caktimin e ekspertit dhe afatin për hartimin dhe depozitimin e aktit të ekspertimit, marrjen e dokumenteve të duhura ligjore nga organet e pushtetit vendor etj.

**16.7** Bashkëngjitur prapësimeve, subjekti depozitoi akte të dosjes për të provuar shpjegimet e saj<sup>147</sup>.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**16.8** Me prapësimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, Komisioni vlerëson se provohet që subjekti ka treguar kujdes për një hetim objektiv e të thelluar gjyqësor, duke respektuar dispozitat dhe afatet procedurale.

**16.9 Komisioni arriti në përfundimin se në gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti nuk konstatohen mangësi.**

**17. Dosja nr. 3** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 16.7.2014 “Për gjykimin e procedimit penal 239, viti 2014”, për veprën penale “Deklarata të rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, në ngarkim të shtetasit A. M..

---

<sup>146</sup> Prokurat e posaçme nr. \*\*\*, datë 16.7.2015 dhe nr. \*\*\*, datë 30.6.2015, përkatësisht të znj. B. U. dhe z. E. G.; kërkesë datë 28.1.2015 e avokatit të znj. B. U. për gjykimin në mungesë të së paditurës B. U.; kërkesë datë 26.2.2016 e avokatit të z. E. G. për shtyrjen e seancës për shkak të grevës së avokatëve; raport mjekësor datë 27.4.2016 e avokatit të znj. B. U.; procesverbale të seancave gjyqësore datë 12.1.2016, 28.1.2016, 16.2.2016, 26.2.2016, 17.3.2016, 6.4.2016, 27.4.2016, 16.5.2016 e 1.6.2016.

<sup>147</sup> Kopje të dosjes gjyqësore të çështjes objekt hetimi, e njëjtë me kopjen e dosjes që ka administruar Komisioni nga KLGJ-ja.

**17.1** Nga hetimi ka rezultuar se në datën 28.2.2014 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “Mashtrimi” (neni 143 i Kodit Penal), pa cituar autorin e kësaj vepre. Në maj 2014, prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës gjykimin e këtij procedimi, por tashmë për veprën penale “Deklarimi i rremë para oficerit të policisë gjyqësore”, në ngarkim të shtetasit A. M..

**17.2** Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar dhe prokurori i çështjes ka qenë dakord me kërkesën e tij. Subjekti ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe ka kaluar në shqyrtim gjyqësor.

**17.3** Prokurori ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 120,000 gjobë dhe, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e shkurtuar, dënimin me 80,000 lekë gjobë.

**17.4** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.7.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sipas kërkesës së prokurorit edhe pagesën e gjobës me tri këste. Nuk rezulton që vendimi i subjektit të jetë ankimuar.

### **17.5 Nga analiza e kryer nuk u konstatuan mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**18. Dosja nr. 4** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 18.12.2013, për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2013, në ngarkim të shtetasve N. K. dhe R. Ç., për veprën penale “Vjedhja”, e kryer në bashkëpunim (neni 134/2 i Kodit Penal).

**18.1** Ka rezultuar se çështja e regjistruar në datën 3.9.2013 është gjykuar brenda 3.5 muajve.

**18.2** Në parashtrimin e kërkesave paraprake, të pandehurit N. K. dhe R. Ç., që janë kapur në flagrancë duke kryer në bashkëpunim (përkatësisht në cilësinë e organizatorit dhe të ndihmësit) vjedhjen e dy radiatorëve të vjetër makinash dhe 50 m kabllo elektrik në një banesë të braktisur, kanë kërkuar gjykim të shkurtuar dhe prokurori i çështjes ka qenë dakord me kërkesën. Subjekti ka pranuar këtë kërkesë dhe ka lejuar gjykimin e shkurtuar në përputhje me nenin 403 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

**18.3** Subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarinin fajtor të dy të pandehurve për veprën penale “Vjedhja” në bashkëpunim; dënimin e të pandehurit N. K. me 7 muaj burg dhe, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, zbritjen e 1/3-ës së dënimit dhe dënimin me 4 muaj e 20 ditë burgim; në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur të pandehurin në kohë prove me 2 vjet, që të mbajë kontakt me shërbimin e provës; dënimin e të pandehurit R. Ç. me 4 muaj burg dhe, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, zbritjen e 1/3-ës së dënimit dhe dënimin me 2 muaj e 20 ditë burgim; në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke e vendosur të pandehurin në kohë prove me 18 muaj, që të mbajë kontakt me shërbimin e provës.

**18.4** Mbi ankimin e Prokurorisë çështja u gjykua në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.6.2014, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 18.12.2013, të subjektit.

### **18.5 Nga analiza e kryer nuk u konstatuan mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**19. Dosja nr. 5** – Vendimi nr. \*\*\*, datë 26.7.2016 “Për deklarinin ikjeje” të shtetasit A. Gj. (neni 247 i Kodit Penal)

**19.1** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur masën e sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj shtetasit A. Gj., por kjo masë nuk është ekzekutuar, pasi ky person nuk gjendet në Shqipëri, ndonëse janë bërë të gjitha kërkimet, çka vërtetohet edhe me informacionin<sup>148</sup> e dhënë nga oficeri i policisë gjyqësore. Për këto arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kërkuar gjykatës “Deklarimin e ikjes” së këtij shtetasi.

<sup>148</sup> Procesverbal datë 20.7.2016; procesverbal datë 19.7.2016; raporti i shërbimit datë 19.7.2016.

**19.2** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Deklarimin e ikjes” të shtetasit A. Gj. dhe caktimin e një avokati kryesisht për këtë shtetas.

**19.3 Rezulton se zbardhja dhe depozitimi i vendimit në sekretari 4 muaj e 16 ditë pas shpalljes së vendimit është bërë në tejkalim të afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.**

**19.4** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për konstatimet e lartpërmendura.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**19.5** Në lidhje me konstatimin se zbardhja e vendimit gjyqësor është bërë përtej afatit procedural 5-ditor nga data kur është shpallur vendimi, subjekti ka shpjeguar se vendimi gjyqësor nr. \*\*\* regj., datë 26.7.2016 “Për deklarimin e ikjes”, është arsyetuar brenda ditës kur është shpallur dhe në po atë ditë i është vënë në dispozicion Prokurorisë.

**19.6** Për efekt të prapësimeve subjekti, pasi ka tërhequr dosjen e gjykimit të themelit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. Gj., dosje ku është administruar edhe fashikulli i hetimit të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, ka konstatuar se në këtë fashikull janë depozituar vendimi gjyqësor nr. \*\*\* regj, datë 26.7.2016 i saj “Për deklarimin e ikjes” dhe vendimi datë 27.7.2016 i prokurorit “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Vendimi datë 27.7.2016 është nënshkruar po në këtë datë , me shënimin se “Mori njoftim” pikërisht nga mbrojtësi që subjekti i rivlerësimit kishte caktuar kryesisht në vendimin gjyqësor nr. \*\*\* regj., datë 26.7.2016, çka tregon se vendimi gjyqësor nr. \*\*\* regj., datë 26.7.2016, që subjekti ka disponuar, është arsyetuar dhe u është bërë i njohur palëve një ditë pas shpalljes së tij.

**19.7** Bashkëlidhur prapësimeve dhe në seancën dëgjimore subjekti ka depozituar dokumentet provuese<sup>149</sup>.

**19.8** Në lidhje me depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari, përtej afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka shpjeguar se para se të dispononte vendimin “Për deklarimin e ikjes”, ka disponuar vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2016, për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj shtetasit A. Gj. dhe ka ngarkuar policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.

**19.9** Në referim të nenit 244, pika 1 dhe nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale të kohës, subjekti shpjegon se masa e sigurimit “Arrest në burg”, që caktohet nga gjykata, pa praninë e të dyshuarit/të pandehurit dhe që i njoftohet atij nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore dhe jo nëpërmjet gjykatës, sikurse ndodh me njoftimin e masave të tjera të sigurimit, i jep vendimit për këtë lloj mase sigurimi natyrë “sekrete”, me qëllim që të shmanget mundësia e ikjes së personit në kohën që do i komunikohet data e shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë për vendosje mase të sigurimit “Arrest në burg” apo në kohën që do i komunikohet vendimi gjyqësor për caktimin e kësaj mase sigurimi, përpara se vendimi të zbatohet nga policia gjyqësore. Vetëm pas zbatimit të kësaj mase vendimi dhe dosja përkatëse depozitohet në sekretarinë e gjykatës (sipas nenit 246, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale).

---

<sup>149</sup> (i) Prova gjatë prapësimeve: vendim datë 29.6.2016 i kancelarit të gjykatës për kalim praktike çështje gjyqësore; vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 26.7.2016, i subjektit të rivlerësimit; vendim datë 27.7.2016, i Prokurorisë së Rrethit Korçë; printim datë 26.2.2019 nga SIM i gjykatës për shortimin e çështjes; vendim nr. \*\*\*, datë 3.11.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 19.7.2016, i subjektit të rivlerësimit; (ii) Prova gjatë seancës gjyqësore; kopje kapaku regjistri me shënimin “Masa sigurimi nr.\*\*\*, viti 2016, me numër rendor \*\*\*”; kopje fletë regjistri themeltar penal e vitit 2016, me nr. rendor \*\*\*, datë 12.12.2016, për dorëzim të vendimit për caktim mase sigurimi “Arrest në burg” për shtetasin A. Gj.; kopje fletë regjistri themeltar penal e vitit 2016, me nr. rendor \*\*\*, datë 12.12.2016, për dorëzim të vendimit për “Deklarim ikjeje” të shtetasit A. Gj..

**19.10** Duke qenë se sipas procesverbalit datë 20.7.2016 të OPGJ-së nuk është bërë i mundur ekzekutimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” për shkak të mosgjetyes së shtetasit A. Gj., subjekti me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 26.7.2016, ka vendosur “Deklarimin e ikjes” së këtij shtetasi sipas nenit 247 të Kodit të Procedurës Penale.

**19.11** Dispozitat ligjore nuk përcaktojnë afat për dorëzimin e dosjes së vendimit “Për deklarimin e ikjes”, por subjekti ka vlerësuar se vlen i njëjti rregull si për rastin e vendimit për masën e sigurimit “Arrest në burg”, pra dorëzimi bëhet pas njoftimit ose zbatimit të masës së sigurimit, duke e konsideruar kështu “sekret” edhe vendimin e “Deklarimit të ikjes”. Për shkak të karakterit sekret, dosja dhe vendimi “Për deklarimin e ikjes” është depozituar në sekretari në datën 12.12.2016, së bashku me dosjen që i përket vendimit “Për caktim mase arrest në burg”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**19.12** Në lidhje me konstatimin se zbardhja e vendimit gjyqësor “Për deklarimin e ikjes” është bërë përtej afatit procedural 5-ditor nga data kur është shpallur vendimi, subjekti ka shpjeguar dhe provuar në mënyrë bindëse prapësimet e saj për kundërshtimin e këtij konkluzioni.

**19.13** Në lidhje me depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari përtej afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, Komisioni vlerëson se në momentin që gjykata disponon me vendim “Për deklarimin e ikjes” së të pandehurit dhe cakton avokat kryesisht për t’u njohur me veprimet procedurale të organit të akuzës dhe për të realizuar mbrojtjen e të pandehurit të deklaruar i ikur, atëherë masa e sigurimit “Arrest në burg” e ka humbur karakterin “sekret” dhe parandalues të ikjes së të pandehurit, pasi tashmë i pandehuri i ka ikur hetimit/gjyqimit.

**19.14** Neni 141 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se njoftimi i vendimeve të të pandehurit që nuk gjendet, bëhet duke ia komunikuar avokatit të caktuar kryesisht. Në rastin konkret, nga provat e depozituara rezulton se njoftimi i vendimit të masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe vendimit “Për deklarimin e ikjes” i është bërë në datën 27.7.2016 nga prokurori avokatit të caktuar kryesisht. Pas kësaj date, subjekti kishte detyrimin që të depozitonte në sekretari dosjet dhe vendimet e disponuara prej saj.

**19.15** Gjithashtu, neni 247, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: *“Me aktin që deklaron ikjen, gjykata i cakton personit që ka ikur një mbrojtës dhe urdhëron që të depozitohet në sekretari kopja e vendimit me të cilin është caktuar masa e zbatuar”*. Duke pasur parasysh që kjo dispozitë nuk përcakton afat standard, si dhe rëndësinë e faktorit kohë në fazën e hetimeve paraprake, kuptohet që urdhërimi për depozitimin e vendimit përkon me afatin e parashikuar në nenin 113 të Kodit të Procedurës Penale.

**19.16** Në përfundim, Komisioni i qëndron konstatimit të tij se depozitimi i vendimeve në sekretari 4 muaj e 16 ditë pas shpalljes së tyre është bërë nga subjekti në tejkalim të afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Por, duke e parë këtë veprim të subjektit në harmoni me veprimet për arsyetimin dhe njoftimin e vendimeve brenda një dite nga shpallja e tyre, në harmoni me faktin që mosdepozitimi i dosjeve në afat nuk ka sjellë pasoja procedurale të dëmshme për palët, si dhe në harmoni me rrethanat e shpjeguara nga vetë subjekti, Komisioni vlerëson se kjo mangësi nuk është e një rëndësie të tillë sa ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për mangësi profesionale.

### **Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së dhe prokurorive (gjetje, ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime)**

**20.** Me dekretin nr. \*\*\*, datë 5.10.2007, të Presidentit të Republikës, subjekti i rivlerësimit është emëruar si gjyqtare në stazh pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe me dekretin nr. \*\*\*, datë 25.3.2009, është emëruar gjyqtare pranë kësaj gjykate. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.3.2021,

të KLGJ-së, subjekti komandohet pranë Gjykatës së Apelit Korçë, ku vazhdon të jetë e punësuar deri në datën 17.12.2021<sup>150</sup>.

**21.** Referuar raportit të KLGJ-së, rezulton se për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi janë paraqitur 2 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së. Ankesa nr. \*\*\*, datë 27.11.2013, nga shtetasi R. H., është arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa ankesa nr. \*\*\*, datë 22.7.2015, nga shtetasi N. e A. P., e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, i është regjistruar subjektit për efekt të vlerësimit profesional etik. Nuk rezulton që për subjektin e rivlerësimit të ketë kërkesë për procedim disiplinor apo masë disiplinore.

**22.** Referuar informacionit të administruar nga prokuroritë e rretheve gjyqësore<sup>151</sup>, konfirmohet se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar kallëzim penal, procedim penal i filluar, i pushuar, i mosfilluar; nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të dhëna që cenojnë figurën e subjektit.

**23.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë konfirmon<sup>152</sup> se kjo Prokurori i ka kaluar për kompetencë tokësore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec kallëzimin penal nr. \*\*\* të shtetases V. T.<sup>153</sup> ndaj subjektit të rivlerësimit, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

**24.** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit e Krimit të Organizuar (PPKKO) konfirmon<sup>154</sup> se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

**25.** Gjithashtu, Komisioni, nisur nga disa *indicie* të referuara nga organet ligjzbatuese, kreu hetim edhe për shtetasin I. F., bashkëjetuesin e subjektit, i cili ka punuar në profesionin e lirë të avokatit dhe si kryetar i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Korçë. Nga ky hetim rezultoi<sup>155</sup> që pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit e Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda nuk është regjistruar ndonjë procedim penal ndaj këtij shtetasi.

## DENONCIME/ANKESA

Pranë Komisionit janë depozituar 14 denoncime nga 11 denoncues, si vijon:

**26. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 21.3.2019**, i shtetasi M. G., i cili në formularin e denoncimit dhe në kërkesën datë 20.3.2019, drejtuar Komisionit, pretendon për veprime të padrejta, zvarritje procesi, citon emrat e disa magjistratëve, midis të cilëve edhe të subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi, citon se ka filluar proces gjyqësor në datën 4.1.1997 me objekt çështje pronësie, ku 10 magjistratët

<sup>150</sup> Data 17.12.2021 kur shkresa nr. \*\*\* është dërguar nga KLGJ-ja (bashkëlidhur raportit të dërguar nga KLGJ-ja).

<sup>151</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga prokuroritë e rrethit gjyqësor: Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023; Pogradec nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Sarandë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2023; Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023; Lushnjë nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Mat nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Elbasan nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2023; Fier nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023; Krujë nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; Gjirokastrë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.10.23; Korçë nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Pukë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021; Dibër nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2023; Vlorë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2023; Përmet nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021; Durrës nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2023; Kukës nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2023; Berat nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2023; Kurbin nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Lezhë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2023; Tropojë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Kavajë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021.

<sup>152</sup> Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. \*\*\*, datë 29.9.2023, drejtuar Komisionit.

<sup>153</sup> Trajtuar më poshtë në denoncimet e kësaj shtetaseje ndaj subjektit: nr. \*\*\*, datë 26.6.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 19.3.2021.

<sup>154</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2023, e Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, drejtuar Komisionit.

<sup>155</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2024, të PPKKO-së drejtuar Komisionit.

që ai përmend në formular, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, nuk kanë bërë gjykime të drejta e të ligjshme, bëjnë gjykime pa dosje të palëve.

**26.1** Denoncuesi nuk ka përmendur në denoncimin e tij asnjë numër dhe datë akti, nuk ka bashkëlidhur asnjë akt gjyqësor, që provon përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimet apo proceset gjyqësore të padrejta që ai pretendon, ndaj Komisioni vlerësoi të mos e marrë në konsideratë këtë denoncim.

**27. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 11.9.2018**, i shtetasit J. O., i cili pretendon zvarritje me mbi 25 seanca të një procesi gjyqësor me paditës shtetasin J. O., të paditur P. O. etj., me objekt “Pjesëtim pasurie”. Zvarritjet janë bërë për shkak të mungesës së palës së paditur që pretendonte se ishte jashtë shtetit, ndërkohë që paditësi deklaronte në gjyq se i kishte parë në lagje. Gjithashtu, gjyqtarja ka caktuar gjatë procesit dy ekspertë, njëri me NIPT dhe tjetri pa NIPT, duke u kërkuar palëve që shpenzimet gjyqësore t’i paguajnë secila në mënyrë të barabartë. Pala paditëse nuk ka qenë dakord me ekspertin pa NIPT, i cili është paguar me 40,000 lekë. Bashkëlidhur denoncimit, subjekti ka depozituar disa dokumente<sup>156</sup>.

**27.1** Komisioni, pasi administroi<sup>157</sup> e shqyrtoi dosjen gjyqësore, vëren se:

- Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për zvarritje të seancave për shkak të mungesës së palës së paditur, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në respektim të dispozitave procedurale ka ndërmarrë të gjitha masat dhe hapat e duhur ligjorë për njoftimin e palëve dhe zhvillimin e përfundimit e procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

- Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për caktimin e ekspertit pa licencë dhe ndarjen e shpenzimeve gjyqësore midis palëve ndërgjyqëse, Komisioni ka konstatuar se subjekti, për të kryer aktekspertimin për pjesëtimin e pasurisë, ka caktuar dy ekspertë: inxh. L. L. me licencë e NIPT, ndërsa eksperti agronom A. H. pa licencë e NIPT. Duke iu përmbajtur praktikës gjyqësore së gjyqtarëve të tjerë, subjekti ka kërkuar caktimin e tij nga Drejtoria e Bujqësisë Korçë, pasi gjykata nuk ka në listën e saj ekspertë agronomë të licencuar dhe deri në datën 19.10.2018 gjykata nuk dispononin një regjistër elektronik të krijuar nga Ministria e Drejtësisë, ku pasqyroheshin emrat e ekspertëve dhe fushat përkatëse të njohurive<sup>158</sup>.

**27.2** Subjekti ka urdhëruar që në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të bëhet parapagimi i ekspertëve sipas tarifës që ata do të përcaktojnë dhe është provuar pagesa e ekspertëve<sup>159</sup>.

**27.3** Në përfundim, subjekti me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.9.2017, ka pranuar kërkesëpadinë dhe, në lidhje me shpenzimet gjyqësore, në pjesën e dispozitivit ka vendosur: “Vlera 44,000 lekë, që është ½ e shpenzimeve gjyqësore që pala paditëse ka parapaguar për kryerjen e aktekspertimit, i ngarkohen palës së paditur, ndërsa pjesa tjetër i mbeten palës paditëse, ashtu siç janë bërë”. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

<sup>156</sup> (i) Faqe nr. 1 dhe 8 të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit; (ii) faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 5.7.2017, me vlerë 48,000 lekë, të lëshuar nga eksperti L. L., me NIPT \*\*\*, për blerësin J. O., me qëllim kryerjen e aktekspertimit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për çështjen gjyqësore me paditës J. O., të paditur P. O. etj.; (iii) deklaratë datë 21.7.2017 pa emër, ku deklaruesi në cilësinë e ekspertit vlerësues në çështjen me paditës J. O. dhe të paditur P. O. ka kryer aktin e ekspertimit për të cilin është shpërblyer nga paditësi J. O. në shumën 40,000 lekë, në datën 21.7.2017; (iv) kërkesë e datës 25.10.2017 e shtetasit J. O. drejtuar subjektit për sqarim e interpretim të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.9.2017.

<sup>157</sup> Shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 26.2.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, drejtuar Komisionit.

<sup>158</sup> Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile lidhur me caktimin e ekspertëve nga regjistri elektronik i krijuar nga Ministria e Drejtësisë kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017, por udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë në zbatim të këtij ligji është miratuar në datën 19.10.2018.

<sup>159</sup> Me faturën tatimore nr. \*\*\*, datë 5.7.2017, eksperti L. L., me NIPT \*\*\*, është paguar nga paditësi J. O. në shumën 48,000 lekë për kryerjen e aktekspertimit të kërkuar nga Gjykata. Me deklaratën datë 21.7.2017, eksperti vlerësues A. H. deklaroi se për këtë çështje e ka kryer aktin e ekspertimit dhe është shpërblyer nga paditësi J. O. në shumën 40,000 lekë, në datën 21.7.2017.

**27.4** Në fazën e dytë të pjesëtimit nuk ka pasur shtyrje seancash. Subjekti, duke respektuar parashikimet e neneve 224 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, për caktimin e ekspertit, i ka ndarë shpenzimet gjyqësore në mënyrë të barabartë midis palëve, bazuar në nenet 104 dhe 106 të Kodit të Procedurës Civile.

**27.5** Për sa më lart, rezulton se që nga data e regjistrimit gjykimi ka zgjatur rreth 9.5 muaj, me 13 seanca, për shkaqe ligjore që kanë diktuar nevojën e shtyrjes së seancave. Gjithashtu, paditësi që ka depozituar këtë denoncim, në asnjë seancë gjyqësore nuk ka paraqitur ndaj subjektit ndonjë ankesë për zvarritjen e procesit apo për shpenzimet gjyqësore.

**Në përfundim nuk u konstatuan mangësi thelbësore e me pasoja në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi.**

**28. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 25.3.2019**, i shtetasit A. H., i cili pretendon se është gjykuar dhe shpallur fajtor në mënyrë të padrejtë nga trupi gjykues me tre gjyqtarë E. Gj., Sonjela Voskopi, S. P., për veprën penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” (neni 245/1 i Kodit Penal), duke e klasifikuar në paragrafin e dytë të këtij neni. Bashkëlidhur denoncimit, ka depozituar vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2011, i disponuar nga trupi gjykues i lartpërmendur ku subjekti është anëtare, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.1.2012, të Gjykatës së Apelit dhe rekursi nuk është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

**28.1** Sa më lart, Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka pretendime në lidhje me anën procedurale të gjykimit, por me themelin e çështjes, për të cilën mban parasysh nenin 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që përcaktojnë moskompetencën e Komisionit për të vlerësuar gjykimin e themelit të çështjes.

**28.2 Denoncimet nr. \*\*\*, datë 4.3.2020 dhe nr. \*\*\*, datë 27.2.2020**, të shtetasit J. Q., i cili pretendon se subjekti Sonjela Voskopi ka gjykuar dhe rrëzuar kërkesën e tij për përjashtimin e gjyqtarës A. K. nga gjykimi i padisë me objekt “Pavlefshmëri e testamentit të babait të tij, datë 29.9.2001”, gjykim ku denoncuesi është palë e paditur. Gjyqtarja A. K. është mbesë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, S. K., me të cilin denoncuesi pretendon se është në konflikt interesi për shkak të vendimit datë 22.12.2015, që ky gjyqtar ka dhënë ndaj denoncuesit.

**28.3** Subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2020, ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës A. K..

**28.4** Bashkëlidhur denoncuesi ka depozituar dokumentacionin provues<sup>160</sup>.

**28.5** Në arsyetimin e vendimit, subjekti citon se nuk ka shkak ligjor për përjashtimin e gjyqtarës, referuar shkaqeve për përjashtimin e gjyqtarit të parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Vërtet kjo gjyqtare është mbesa e gjyqtarit S. K., por ky ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i masës së sigurisë që kishte gjykuar kjo gjyqtare në shkallë të parë. Gjithashtu, çështja që po gjykon kjo gjyqtare nuk ka lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 4.9.2015, me palë të pandehur Gj. N. dhe të dëmtuar M. Q., procedim për të cilin gjyqtari S. K., me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2015, ka vendosur pushimin e çështjes dhe për të cilin shtetasja Xh. Q. ka paraqitur ankesë

<sup>160</sup> Certifikatat familjare datë 7.2.2020 dhe 10.2.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, të cilat i janë dërguar denoncuesit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020, të Prefekturës së Qarkut Korçë, që provojnë se shtetasi S. K. është vëllai i nënës së gjyqtarës A. K.; (ii) kërkesë datë 12.2.2020 e shtetasës Xh. Q. (vajza e denoncuesit J. Q.) drejtuar kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për përjashtimin e gjyqtarës A. K. nga gjykimi i çështjes, depozituar në datën 13.2.2020; (iii) vendim gjyqësor datë 17.2.2020 i subjektit për caktimin e datës së shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës A. K.; (iv) vendim nr. \*\*\*, datë 19.2.2020, me të cilin subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin të gjyqtarës A. K.; (v) procesverbal seance datë 5.12.2019 i Gjykatës së Apelit Korçë, ku pasqyrohet se shtetasi S. K., gjyqtar i trupit gjykues, ka dhënë dorëheqjen, sepse ka lidhje familjare me gjyqtaren që ka gjykuar kërkesën në shkallë të parë.

ndaj këtij gjyqtari në instancat kontrolluese të gjykatave. Neni 72, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile, e shtrin termin “Armiqësi” deri tek bashkëshorti/ja dhe bashkëjetuesi/ja e gjyqtares/it që gjykon çështjen.

**28.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim në përputhje me parashikimet e neneve 72, 74 e 75 të Kodit të Procedurës Civile dhe në lidhje me këtë çështje nuk konstatohen mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**29. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 23.4.2019**, i shtetasit E. H., ndaj vendimit datë 26.7.2018 që ka dhënë subjekti i rivlerësimit në dhomë këshillimi, duke rrëzuar kërkesën penale nr. \*\*\* të këtij shtetasi për kundërshtimin e vendimit datë 28.5.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë “Për pezullimin e hetimeve ndaj procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012”.

**29.1** Komisioni administroi<sup>161</sup> dhe shqyrtoi fashikullin gjyqësor të procedimit penal nr. \*\*\*/2012 për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, i regjistruar në datën 30.10.2012 nga Prokuroria e Rrethit Korçë.

**29.2** Ka rezultuar se në datën 27.10.2012 është konstatuar vrasja e shtetasit E. H. në lokalin që ai kishte me qira dhe ku ushtronte aktivitetin “Bar-kafe dhe lojëra fati”.

**29.3** Pasi janë kryer shumë veprime hetimore, në përfundim Prokuroria ka vendosur në datën 2.12.2013 pushimin e akuzës, ndërsa në datën 5.12.2013 ka vendosur pezullimin e hetimeve dhe kalimin e dosjes tek Drejtoria e Policisë Korçë për identifikimin e autorit të veprave penale.

**29.4** Referuar materialit të dërguar nga policia gjyqësore që përmban deklaratimet e djalit të viktimës dhe një CD me pamjet nga emisioni “\*\*\*\*”, i transmetuar në TV \*\*\*, në datën 31.5.2017, prokuroria ka vendosur rifillimin e hetimeve në datën 13.6.2017. Pas kryerjes së hetimeve, ky procedim penal u pezullua sërish me vendimin e prokurorisë datë 28.5.2018, për shkak se pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore, nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale.

**29.5** Shtetasi E. H., djali i viktimës, me ankimin penal nr. \*\*\* ka kundërshtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë vendimin datë 28.5.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë “Për pezullimin e hetimeve ndaj procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012”. Ky ankim është hartuar dhe nënshkruar nga studioja ligjore “Jurisprudenca” si përfaqësuese e shtetasit E. H. dhe është depozituar ankim në gjykatë, në datën 26.6.2018.

**29.6** Në datën 5.7.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të caktojë datën 20.7.2018 për shqyrtimin e ankimit në dhomë këshillimi, por nuk e gjykoj ankimin në datën 20.7.2018, sepse shtetasi E. H. ka depozituar dy kërkesa njëra pas tjetrës për përjashtimin e subjektit nga ky gjykim. Shkaqet për të cilat shtetasi E. H. kërkonte përjashtimin e subjektit, ishin se subjekti nuk e ka njoftuar që ajo është caktuar gjyqtare e çështjes dhe nuk i ka njoftuar as datën e seancës. Këto kërkesa përjashtimi janë rrëzuar me dy vendime nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë<sup>162</sup>.

**29.7** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2018, subjekti ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të prokurorisë për pezullim të hetimeve, duke argumentuar edhe shkaqet e mospranimit: (i) Prokura me të cilën shtetasi E. H. i ka dhënë studios ligjore “Jurisprudenca” tagrat e përfaqësimit në gjyq, është fotokopje, pra nuk provohet legjitimiteti për të paraqitur kërkesën për gjykim; (ii) Shtetasi E. H. pretendon se me vendimin datë 28.5.2018 të Prokurorisë “Për pezullimin e hetimeve” është njohur në datën 16.6.2018. Bashkëlidhur ankimit, ankuesi nuk ka depozituar asnjë dokument provues dhe rezultoi sipas mandatit të postës se studioja ligjore “Jurisprudenca” ka depozituar në postë, në datën 26.6.2018, ankimin ndaj vendimit datë 28.5.2018 “Për pezullimin e hetimeve”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pra jashtë afatit ligjor 10 ditë nga

<sup>161</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

<sup>162</sup> Me vendimet nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 27.7.2018.



njoftimi (neni 326, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale); (iii) Bashkëlidhur ankimit nuk është depozituar asnjë dokument për të bindur gjykatën se kërkesa e bërë nga shtetasi E. H. për hetime shtesë është e ligjshme. Gjykata, gjatë gjykimit në dhomë këshillimi, vendos duke u bazuar në ligj e në provat që i bashkëlidhen ankimit, dhe nuk ka asnjë të drejtë të investojë kryesisht apo të bëjë hetim gjyqësor për të mbledhur prova.

**29.8** Për sa më lart, rezulton se subjekti ka vepruar drejt duke vendosur mospranimin e ankimit.

**29.9 Në përfundim, Komisioni konstatoi se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk ka mangësi, që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.**

**30. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 21.10.2019**, i shtetasit K. D., i cili pretendon për sjellje të njëanshme të subjektit të rivlerësimit, favorizim të palës paditëse V. S. dhe rrëzimin arbitrar të kërkesave të palës së paditur K. D. në një proces gjyqësor civil, përfshirë edhe kërkesën për pezullim gjykimi, si dhe kërkon që të shqyrtohet në vijimësi ky proces gjyqësor.

**30.1** Referuar denoncimit dhe akteve bashkëlidhur denoncimit<sup>163</sup>, si dhe dosjes së administruar<sup>164</sup> nga Komisioni, rezulton se denoncuesi, babai i tij P. D. dhe shtetasja V. S. janë përfshirë në konflikte me natyrë juridiko-civile dhe penale, për shkak të mosmarrëveshjeve të pronësisë mbi pasuri të paluajtshme dhe detyrimin monetar prej 25 milionë lekësh, që K. D. i ka kreditores V. S..

**30.2** Në lidhje me burimin e shumës 25 milionë lekë, që shtetasja V. S. i kishte dhënë hua shtetasit P. D., në Prokurorinë e Rrethit Korçë është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2018, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, pa emër personi nën hetim<sup>165</sup>. Ndaj shtetasës V. S. dhe përmbauesit A. S. ka nisur edhe procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Ushtrimi pa licencë i veprimtarive bankare e financiare” dhe “Fshehja e të ardhurave”.

**30.3** Ndërkohë që shtetasi K. D. ka bërë denoncimin pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka qenë duke gjykuar padinë e regjistruar në gjykatë, në datën 10.5.2019, me palë paditëse V. S., palë të paditur K. D., me objekt “Detyrimi i të paditurit të pushojë cenimin e pronësisë së paditësit duke prishur ndërtimet në kufi të pronës së paditësit dhe mospërsëritjen në të ardhmen” (neni 302 i Kodit Civil).

**30.4** Në seancën datë 19.9.2019, i padituri K. D. ka kërkuar pezullimin e gjykimit civil deri në përfundimin e procedimeve penale të lartpërmendura, pasi çështja civile ka lidhje me këto procedime dhe nuk mund të zgjidhet pa i përfunduar ato, si dhe ka bashkëlidhur provat përkatëse.

**30.5** Subjekti i rivlerësimit e rrëzoi këtë kërkesë për pezullim si të pabazuar në ligj, sepse nuk ka lidhje me objektin e këtij gjykimi. Kërkesa është përsëritur në seancën e datës 1.11.2019 së bashku me disa akte. Në seancën pasardhëse datë 8.11.2019, subjekti e rrëzoi sërish kërkesën me të njëjtin arsyetim.

**30.6** Në lidhje me pezullimin e gjykimit civil, Komisioni vlerëson se objekti i kërkesëpadisë nuk ka lidhje me objektin e procedimit penal, prandaj ecuria e gjykimit të padisë nuk varej nga

---

<sup>163</sup> (i) Kërkesëpadi datë 10.5.2019 me paditës V. S., të paditur K. D., me objekt “Detyrim i të paditurit të pushojë cenimin e pronës...”; (ii) procesverbal i seancës gjyqësore datë 19.9.2019, mbajtur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, ku Prokuroria e Rrethit Korçë informon se ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, pa emër personi nën hetim; (iv) vendim nr. \*\*\*, datë 20.5.2019, i Bashkisë Korçë, për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh nga shtetasi K. S.; (v) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2019, nga ASHK Drejtoria Korçë, që konfirmon se shtetasi K. S. ka plotësuar formularin për legalizim të objektit të ndërtuar pa leje dhe dosja është pezulluar me urdhrin nr. \*\*\*, datë 3.7.2019.

<sup>164</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

<sup>165</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

përfundimi i procesit penal. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim të drejtë në përputhje me nenin 297, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile.

**30.7** Në datën 13.11.2019, i padituri K. D. ka paraqitur edhe kërkesën për përjashtimin e subjektit nga trupi gjykues, me pretendimin për gjykim të njëanshëm, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.11.2019.

**30.8** Në përfundim të gjykimit, me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 23.11.2021, subjekti ka rrëzuar kërkesëpadinë si të pabazuar në ligj e prova. Paditësi ka ankimuar vendimin e mësipërm dhe, nga verifikimi i kryer, rezultoi se kjo çështje e regjistruar pranë Gjykatës së Apelit është në përpunim dhe nuk ka kaluar për gjykim.

**30.9** Për gjithë sa më lart, rezultoi se të dyja palët ndërgjyqëse kanë paraqitur gjatë gjykimit kërkesa procedurale, që janë shqyrtuar e trajtuar me objektivitet dhe ligjshmëri nga subjekti. Të dyja palët kanë ngritur ndaj subjektit edhe pretendime për njëanshmëri, të cilat u rrëzuan nga gjykata, por edhe Komisioni nga ana e tij konstatoi se këto pretendime nuk qëndrojnë. Subjekti ka mbajtur qëndrim të paanshëm përballë palëve, duke i trajtuar ato në mënyrë të barabartë dhe duke respektuar dispozitat procedurale, veçanërisht nenet 4, 14, 20, 28, 77, 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

**30.10 Në përfundim nuk u konstatuan mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**31. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 26.1.2018**, i shtetases Xh. Q., e cila në objektin e denoncimit citon: *“Proces jo i rregullt ligjor, vendim në kundërshtim me ligjin dhe aftësitë profesionale”*. Denoncuesja pretendon se shtëpia e babait të saj në \*\*\*, Korçë, është dhunuar pa leje nga administratori i fshatit I. P. dhe fqinji R. Th., prandaj ka bërë kallëzim penal dhe Prokuroria e Rrethit Korçë me vendimin datë 5.7.2017 ka pushuar çështjen penale, me arsyetimin se veprimet e këtyre personave nuk përbëjnë vepër penale. Kundër këtij vendimi denoncuesja ka bërë ankim në gjykatë, ku subjekti i rivlerësimit ka vendosur prishjen e vendimit të Prokurorisë dhe kthimin e çështjes për rihetim. Për vendimin e subjektit Sonjela Voskopi, denoncuesja citon se pjesa e interpretimit të vendimit është plotësisht në kundërshtim me ligjin.

**31.1** Nga përmbajtja e denoncimit, e vendimit datë 5.7.2017 të Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe vendimit nr. \*\*\*, datë 19.9.2017, të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vëren se denoncuesja ka pretendime për zgjidhjen në themel të çështjes, pra për pjesën materiale të saj dhe jo për shkelje procedurale nga ana e subjektit.

**31.2** Në këto kushte, në respektim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi të veprimeve të subjektit të rivlerësimit, prandaj ky denoncim nuk merret në konsideratë.

**32. Denoncimet nr. \*\*\*, datë 26.6.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 19.3.2021**, të shtetases V. T., e cila në çështjen civile nr. \*\*\* që ka gjykuar subjekti i rivlerësimit, pretendon si shkelje, sa vijon: (i) Sekretarja e saj gjyqësore, Xh. V., dyshohet se ka njohje të afërta me bashkëshorten dhe vajzën e paditësit Gj. N.; (ii) Është shkelur parimi procedural i gjësë së gjykuar, sepse kjo çështje është me të njëjtat palë, të njëjtin shkak ligjor e të njëjtin objekt, si një çështje e gjykuar më parë, por me ndryshimin e vetëm se në çështjen e parë Gj. N. ka kërkuar “Njohjen pronar mbi pasurinë nr. \*\*\*...” , ndërsa në çështjen e dytë (që gjykon subjekti i rivlerësimit) ka kërkuar “Njohjen e të drejtave mbi pasurinë nr. \*\*\*...”; (iii) Subjekti i rivlerësimit ka disponuar në kundërshtim me ligjin për një mosmarrëveshje të zgjidhur më parë me vendim të formës së prerë dhe me vendimin saj të ndërmjetëm nr. \*\*\* akti, datë 18.6.2019, ka vendosur masën e sigurimit të padisë nëpërmjet sekuestros konservative mbi pasurinë nr. \*\*\* truall, me sip. 147 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 80

m<sup>2</sup> mbi truall; (iv) Ka legjitimuar pa asnjë dokument përfaqësimi përfaqësuesin e paditësit; (v) Ka gjykuar pa i dërguar njoftim palës së paditur.

**32.1** Denoncuesja ka depozituar bashkëlidhur denoncimit edhe disa dokumente provuese<sup>166</sup>.

**32.2** Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.7.2014<sup>167</sup>, ka vendosur: (i) Detyrimin e të paditurit kundërpaditës Gj. N. të njohë pronar dhe t'ua lirojë e dorëzojë këtë pronë paditësve të kundërpaditur V. T. etj., pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Korçë, pronësinë e së cilës këta e kanë fituar sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 25.11.1994, të KKKP-së Bashkia Korçë; (ii) Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së dhurimit, me të cilën shtetasi Gj. N. ka fituar këtë pronë nga shtetasi M. N. dhe detyrimin e ZVRPP-së Korçë të çregjistrojë këtë pronë nga emri i z. Gj. N. e ta regjistrojë në emër të bashkëpronarëve paditës të kundërpaditur; (iii) Rrëzimin e kundërpadisë së shtetasit Gj. N. për të detyruar paditësit e kundërpaditur që ta njohin pronar me parashkrim fitues me titull. Ky vendim nuk është ekzekutuar.

**32.3** Në datën 7.6.2018 është paraqitur në gjykatë padia me paditës Gj. N., të paditur V. T., etj., person i tretë ASHK Korçë, me objekt "Detyrim për njohje të drejtash mbi pasurinë nr. \*\*\* si ndërtesë e ndërtuar dhe investuar nga paditësi; marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur sekuestro konservative mbi pronën; regjistrimin e padisë pranë ASHK Vendore Korçë".

**32.4** Me vendimin e datës 12.6.2019, gjykata vendosi kthimin e akteve, sepse padia ka të meta me ndërgjyqësinë. Vendimi është ankimuar, por deri në datën 25.11.2019 kjo çështje nuk ishte gjykuar ende në Gjykatën e Apelit Korçë.

**32.5** Po në datën 12.6.2019 është paraqitur e njëjta padi, por me ndërgjyqësi të rregulluar, pasi është shtuar edhe znj. M. N. (Sh.), trashëgimtare e shtetasit N. Sh. dhe, në datën 13.6.2019, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë u regjistrua çështja civile nr. \*\*\*.

**32.6** Me vendimin e ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, në seancë përgatitore, subjekti ka vendosur masën e sigurimit të padisë, duke regjistruar padinë në ASHK Vendore Korçë dhe duke bllokuar regjistrimin e çdo veprimi juridik tjetërsimi në lidhje me pronën objekt gjykimi, deri në përfundimin e gjykimit me vendim të formës së prerë. Marrja e masës së sigurisë është gjykuar në prezencë të së paditurës V. T. dhe në mungesë të të paditurve të tjerë, për të cilët nuk ishte konfirmuar marrja njoftim. Për këtë, në vendim subjekti ka arsyetuar se kjo kërkesë ishte emergjente dhe kërkesa të tilla mund të gjykohen edhe në dhomë këshillimi.

**32.7** Kundër vendimit të ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, të subjektit të rivlerësimit, pala e paditur V. T. etj. ka bërë ankim duke kërkuar pushimin e gjykimit sepse: *Së pari*, ekziston situata e litispencës, pasi vendimi datë 12.6.2019 për kthimin e padisë nuk ka marrë formë të prerë, por po gjykohet në Gjykatën e Apelit; *Së dyti*, çështja përbën gjë të gjykuar, pasi është zgjidhur me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.7.2014, të formës së prerë; *Së treti*, subjekti ka legjitimuar përfaqësuesin e paditësit referuar prokurës që ndodhet në dosjen për të cilën gjykata vendosi kthimin e akteve; *Së katërti*, gjykata ka qenë e njëanshme, sepse sekretarja gjyqësore e subjektit dyshohet për lidhje të afërta me palën paditëse; *Së pesti*, masa e sigurisë së padisë është marrë në mungesë të palës së paditur; *Së gjashti*, kërkesa për masën e sigurisë është e paligjshme, sepse nuk ekziston rreziku që paditësit t'i shkaktohet një dëm i rëndë apo i pariparueshëm.

<sup>166</sup> Vendim nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës Sonjela Voskopi nga gjykimi i çështjes; vendim nr. \*\*\*, datë 25.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Korçë për gjykimin e çështjes civile nr. \*\*\* nga gjyqtarja A. K., e cila gjykoi çështjen pas përjashtimit të subjektit të rivlerësimit; vendimi nr. \*\*\*, datë 26.11.2020, i Gjykatës së Lartë.

<sup>167</sup> Vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2015, i cili ka marrë formë të prerë.

**32.8** Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2019, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, të subjektit të rivlerësimit. Mbi bazën e rekursit, çështja është gjykuar në Gjykatën e Lartë, e cila ka disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2020.

**32.9** Në lidhje me pretendimet se ekziston situata e litispencës, subjekti ka legjitimuar përfaqësuesin e paditësit referuar prokurës që ndodhet në dosjen për të cilën gjykata vendosi kthimin e akteve; ka njëanshmëri të gjykatës, sepse sekretarja gjyqësore e subjektit dyshohet për lidhje të afërta me palën paditëse; masa e sigurisë së padisë është marrë në mungesë të palës së paditur, rezultoi se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë i ka rrëzuar si të pabazuara në ligj e në prova. Gjithashtu, edhe Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjykatat.

**32.10** Në lidhje me pretendimin se vendimi i subjektit për marrjen e masës së sigurimit të padisë është në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve nr. \*\*\*, datë 18.6.2019, të subjektit dhe nr. \*\*\*, datë 25.7.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë, duke arsyetuar se: *“Padia objekt gjykimi është padi njohjeje pronar mbi pasuri të paluajtshme, që eventualisht do të çojë në dhënien e një vendimi njohjeje me natyrë deklarative dhe jo në nxjerrjen e një titulli ekzekutiv. Ky vendim deklarativ ka natyrë parandaluese dhe shërben për dhënien e një vendimi detyrimi në të ardhmen, prandaj këto padi nuk mund të sigurohen me “Masë sigurimi padie”. Neni 203/1 i Kodit të Procedurës Civile duhet interpretuar në mënyrë sistematike e teleologjike në raport me nenet 202 dhe 510/a të Kodit të Procedurës Civile. Sigurimi i padisë së njohjes pronar arrihet vetëm me regjistrimin e padisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sikurse parashikon edhe neni 197/b i Kodit Civil, me qëllim për të mbrojtur të tretët që mund të kryejnë veprime juridike përballë palëve ndërgjyqësore në lidhje me pronën. Kjo sipas neneve 451/a dhe 200 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë se vendimi gjyqësor është i detyrueshëm edhe për personat e tretë që kanë fituar të drejta nga palët gjatë gjykimit. Kjo do të thotë se në momentin që padia regjistrohet në zyrat e pasurive të paluajtshme, çdo person që kryen veprime juridike me pronën e regjistruar, prezumohet se ka dijeni për barrën që ka kjo pronë objekt konflikti gjyqësor dhe merr përsipër riskun që në të ardhmen mund ta humbasë këtë pronë, duke ua kthyer palëve që u përket. Për këto arsye, vendimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë duke bllokuar regjistrimin e çdo veprimi juridik tjetërsimi në lidhje me pronën objekt gjykimi, është i papërligjur dhe i pajustificuar, pasi të drejtat e paditësit janë në çdo rast të garantuara ex lege sipas këtyre dispozitave dhe nuk është e nevojshme të vendoset masë sigurimi padie. Si rrjedhojë, nuk plotësohet kriteri ligjor bazë se “ka rrezik që ekzekutimi i vendimit gjyqësor në të ardhmen do të bëhet i pamundur ose i vështirë”.*

**32.11** Për sa më lart, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se referuar dispozitave ligjore dhe vendimit të Gjykatës së Lartë subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për sigurimin e padisë në kundërshtim me nenin 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**32.12** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se pavarësisht se e respekton vendimin e Gjykatës së Lartë, nuk është dakord me të, duke paraqitur këto argumente:

a) Subjekti, në respektim të nenit 197, shkronja “b” e Kodit Civil, e ka dërguar padinë për regjistrim në ASHK Drejtoria Vendore Korçë, sikurse orienton edhe Gjykata e Lartë, por në kuptim të këtij neni subjekti nuk e vlerëson këtë veprim si një masë për sigurim padie dhe veprim që nuk e zëvendëson sigurimin e padisë, pasi paditë për njohjen e të drejtave të pronësisë dërgohen për regjistrim, pavarësisht nga kërkimi ose jo i palës.

b) Subjekti ka dhënë një vendim sipas bindjes së brendshme të saj, bazuar në mënyrën si e ka kuptuar dhe interpretuar ligjin procedural civil në mënyrë literale, ashtu siç është shkruar, pasi në

nenin 203 të Kodit të Procedurës Civile “*Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë*”, për padinë e njohjes nuk ka asnjë pengesë ligjore në marrjen e një mase sigurimi.

c) Në rastin objekt gjykimi, pala e paditur kishte titull pronësie mbi pasurinë dhe mund ta tjetërsonte atë, ndërkohë që pala paditëse pretendonte të drejtën e pronësisë mbi këtë pasuri. Nëse padia në fund të gjykimit do të pranohej, ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur ose i vështirë për palën paditëse, sepse, nëse prona tjetërsohet tek të tretët, minimalisht gjatë këtij gjykimi ose në një gjykim tjetër duhet të kërkohej pavlefshmëria e veprimit të tjetërsimit, duke shtrirë kërkimet edhe mbi persona që nuk janë në këtë moment palë në këtë gjykim, duke sjellë zvarritjen e gjykimit ose gjykime të tjera të njëpasnjëshme.

d) Gjatë gjykimit, prona posedohej nga paditësi, për shkak se vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. \*\*\*, datë 23.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që kishte disponuar lirimin dhe dorëzimin e sendit nga paditësi, nuk ishte ekzekutuar. Në këto kushte, paditësi nuk kishte interes juridik të kërkonte edhe lirimin e dorëzimin e sendit, kërkim që do ta bënte llojin e padisë padi detyrimi.

e) Teorikisht, nëse padia e njohjes pranohet, passjell një vendim gjyqësor deklarativ, për të cilin nuk lëshohet një urdhër ekzekutimi, sipas nenit 510, shkronja a e Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk përmban detyrim konkret për palën gjyqumbëse. Por, nga ana tjetër, interpretimi nuk mund të jetë kaq i ngushtë, duke u shprehur se “Paditë e njohjes nuk mund të sigurohen me mase sigurim padie”, sepse në fakt pala gjyqumbëse ngarkohet me detyrimin sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, pra me detyrimin që të njohë vendimin gjyqësor, detyrim që passjell për të disa pasoja, edhe pse jo të shprehura, prandaj në këtë rast nuk mund të vijojë të vërë në ekzekutim vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 23.7.2014 dhe nuk mund të kërkojë dorëzimin e sendit.

f) Vetë Gjykata e Lartë në vendimin e saj e pranon se regjistrimi i padisë në ASHK bëhet me qëllim për të mbrojtur personat e tretë që mund të kryejnë veprime juridike përballë palëve ndër gjyqëse në lidhje me pronën. Ndërsa, sipas subjektit të rivlerësimit, sigurimi i padisë lejohet “për mbrojtjen e paditësit” dhe jo të tretëve, nëse vlerësohet midis të tjerave se ekzekutimi i vendimit do të bëhet i vështirë ose i pamundur për paditësin. Gjithashtu, regjistrimi i padisë në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme nuk mjafton, sepse nuk i pengon transkriptimet e veprimeve juridike tjetërsuese të pasurisë së paluajtshme, ndërsa lloji i masës së sigurimit të padisë me të cilën ka disponuar subjekti, nuk lejon transkriptimin e veprimeve juridike për kalimin e pronësisë nga pala e paditur tek të tretët.

g) Vendimi i subjektit “Për sigurimin e padisë” nuk është dhënë në kundërshtim me ndonjë vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që të ketë interpretuar detyrimisht për zbatim nenin 203 apo nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile në raport me nenin 197, shkronja “b” e Kodit Civil dhe as në kundërshtim me ndonjë vendim njësuës të praktikës gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me 5 gjyqtarë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**32.13** Komisioni vëren se subjekti ka dhënë argumente bindëse në lidhje me caktimin e masës së sigurimit të padisë, rëndësinë dhe pasojat e kësaj mase. Në këto argumente evidentohet qartë ndërthurja e njohurive teorike që zotëron subjekti me përcaktimet ligjore me rrethanat e çështjes konkrete. Duke mbajtur parasysh të gjitha këto shpjegime, faktin që vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është unifikues, por as detyrues për rastin konkret (sepse çështja nuk është rikthyer për gjykim, por është rrëzuar padia nga Gjykata e Lartë), si dhe faktin që Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk i referohet ndonjë vendimi unifikues për raste të ngjashme, atëherë Komisioni vlerëson se qëndron plotësisht masa e sigurimit të padisë që ka dhënë subjekti. Subjekti nuk ka treguar

mosnjohje apo moszbatim të ligjit, por i ka zbatuar dispozitat ligjore përkatëse në përputhje të plotë me përmbajtjen e tyre, sikurse subjekti i ka interpretuar ato, si dhe në përputhje me rrethanat e çështjes dhe pozitën juridike të palëve.

**Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen mangësi në veprimet e subjektit.**

**33. Denoncimet nr. \*\*\*, datë 19.4.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 3.5.2019**, nga personi fizik “P. D.”, i cili pretendon për cenim të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, sepse subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur brenda afatit ligjor mbi kërkesën për pezullimin e veprimeve përmbartimore që ai ka paraqitur në gjykim, por e ka zvarritur këtë vendim për 3 seanca rresht, me arsyetimin që palët ta zgjidhin çështjen me pajtim.

**33.1** Bashkëlidhur këtij denoncimi, denoncuesi ka depozituar disa akte<sup>168</sup>.

**33.2** Referuar akteve bashkëlidhur denoncimeve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar padinë me paditës P. D., të paditur V. S. dhe Zyra e Përmbartimit A. S., person i tretë shoqëria tregtare “\*\*\*” sh.p.k., me objekt: “1) Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv “Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.9.2008, për shkak shuarje detyrimi”; 2) Kundërshtim/anulim i veprimit përmbartimor vendim nr. \*\*\* regj., datë 18.2.2019 “Për sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe vazhdimin e procedurave ligjore”; 3) Pezullim i veprimeve përmbartimore sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile etj.”.

**33.3** Padia në datën 8.3.2019 është shortuar për t’u gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.4.2019, ka rrëzuar kërkesën e paditësit mbi masën e sigurimit për pezullim të ekzekutimit të veprimeve përmbartimore. Pra, subjekti e ka dhënë vendimin 40 ditë pas shortimit.

**33.4** Komisioni pa u ndalur në themelin e këtij vendimi ka konstatuar se ky vendim nuk është marrë brenda afatit ligjor 5-ditor, të përcaktuar në nenet 202 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti i rivlerësimit, sikurse ka cituar në këtë vendim, për disa seanca ka bërë përpjekje për të orientuar palët që ta zgjidhin çështjen me pajtim dhe i është shmangur detyrimit procedural për të vendosur sa më shpejt në lidhje me kërkesën për pezullim të ekzekutimit të veprimeve përmbartimore.

**33.5** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit se subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim në lidhje me masën e sigurimit të padisë, në shkëlqje të afatit 5-ditor nga dita e kërkesës për këtë masë, afat i parashikuar nga nenet 202 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**33.6** Subjekti ka shpjeguar se që nga data 25.2.2019, kur padia është regjistruar në gjykatë, janë ndërruar dy gjyqtarë dhe subjekti si gjyqtar i tretë është shortuar në datën 18.3.2019. Në datën 19.3.2019, kur ka marrë në dorëzim fizikisht dosjen, ka caktuar një seancë të posaçme të datës

<sup>168</sup> (i) Procesverbale të seancave gjyqësore datë 21.3.2019, 29.3.2019 dhe datë 4.4.2019 të subjektit të rivlerësimit; (ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.9.2008, ku shtetasi P. D. pranon detyrimin që ka ndaj shtetases V. S.; (iii) vendim nr. \*\*\*, datë 3.5.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për deklaratën noteriale datë 26.9.2008; (iv) kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, truall me sip. 2,633 m<sup>2</sup>; (v) vendim nr. \*\*\*, datë 2.11.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 21.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për rrëzimin e padisë me objekt “Deklarim i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv “Deklarata noteriale datë 26.9.2008”; Anulim i veprimeve përmbartimore për shitjen e pasurisë nr. \*\*\* dhe kthimin e sendit paditësit; kundërshtim i veprimeve përmbartimore shkresa nr. \*\*\*, datë 26.10.2016; Pezullimin e ekzekutimit”; (vi) procesverbal datë 24.12.2018 i përmbartuesit A. S. për inventarizimin e sendeve të luajtshme makineri që ndodhen në magazinën e kreditorës V. S.; (vii) vendim datë 18.2.2019 i përmbartuesit A. S. për vendosjen e sekuestros konservative fizike mbi makineritë e inventarizuara si më lart; (viii) vendim datë 1.3.2019 i gjyqtarit M. Q. për pezullimin e veprimeve përmbartimore; (ix) vendim datë 13.3.2019 i Prokurorisë së Rrethit Korçë për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin ndaj përmbartuesit A. S. etj.

21.3.2019, vetëm për të shqyrtuar kërkesën për masë sigurimi. Kjo seancë është shtyrë për në datën 29.3.2019, me qëllim që subjekti të njihej me tërësinë e akteve të dosjes përmbartimore që janë paraqitur nga përmbartuesi gjyqësor vetëm në atë seancë, dosje e cila ishte shumë voluminoze (353 faqe). Në datën 29.3.2019, pala paditëse ka paraqitur një kërkesë për shtimin e objektit të padisë dhe seanca u shty për në datën 4.4.2019. Seanca e datës 4.4.2019 është shtyrë për në datën 18.4.2019, me qëllim që përmbartuesi gjyqësor të sillte edhe disa prova të tjera, ekzistenca e të cilave doli vetëm pas debatit të bërë në seancë.

**33.7** Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar dokumentacionin provues<sup>169</sup>.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**33.8** Komisioni vëren se brenda periudhës nga data 21.3.2019, kur subjekti pasi ka marrë në dorëzim dosjen, ka caktuar një seancë të posaçme vetëm për të shqyrtuar kërkesën për masë sigurimi të padisë dhe deri në datën 18.4.2019, kur ka disponuar në lidhje me këtë kërkesë, kanë kaluar 28 ditë. Në fillim të gjykimit, subjekti ka treguar kujdes që të shprehet mbi masën e sigurimit sa më shpejt të ishte e mundur.

**33.9** Duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjes së seancave deri në datën 4.4.2019, Komisioni i vlerëson ato të justifikueshme në respektim të së drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor dhe të kohës së nevojshme në dispozicion të subjektit për të vlerësuar aktet në interes të dhënies së një vendimi cilësor.

**33.10** Nga ana tjetër, caktimi i seancës në datën 18.4.2019 (14 ditë pas seancës paraardhëse), me qëllim që përmbartuesi gjyqësor të sillte edhe disa prova të tjera, ekzistenca e të cilave doli vetëm pas debatit të bërë në seancë, nuk e justifikon karakterin emergjent që ka veprimi procedural i caktimit të masës së sigurimit të padisë dhe nuk lejon shtyrjen “e gjatë” të momentit të vendimmarrjes për këtë masë.

**33.11** Për këto arsye, prapësimet e subjektit nuk janë plotësisht bindëse dhe Komisioni i qëndron konstatimit se subjekti ka disponuar me vendim në lidhje me masën e sigurimit të padisë, në shkelje të afatit 5-ditor nga dita e kërkesës për këtë masë, afat i parashikuar nga nenet 202 dhe 609 të Kodit të Procedurës Civile, por duke mbajtur në konsideratë disa nga shkaqet e justifikueshme të shtyrjes së afatit do ta çmojë këtë veprim në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit profesional të subjektit.

**34. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 5.10.2018**, i shtetas I. J. (E.), që pretendon se subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit as nuk e ka orientuar për rregullimin e ndër gjyqësisë, të cilën denoncuesja nuk e kishte bërë në mënyrën e duhur, as nuk i ka dhënë 5 ditë afat për plotësimin e kërkesëpadisë, por e rrëzoi padinë pa gjykim në themel sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 8.2.2012. Bashkëlidhur denoncimit, denoncuesja ka depozituar disa akte për të provuar pretendimet e saj.

**34.1** Rezulton se trashëgimlënësi S. E. J. ka disponuar me testament për pasurinë e tij të luajtshme e të paluajtshme pas vdekjes së tij, duke u lënë dy djemve të tij P. e G. E. J. të gjitha pasuritë aktuale dhe ato që mund të vijnë më pas, si dhe shumën 10,000 lekë/person fëmijëve I. e T. E. J. dhe bashkëshortes N. E. J..

**34.2** Në datën 28.7.2011, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është regjistruar padia me palë paditëse I. E. J., palë të paditur G. dhe P. E. J., me objekt “1) “Detyrimi i të paditurit ta njohë

---

<sup>169</sup> Kërkesëpadi datë 25.2.2019 e paditësit P. D.; kërkesë e paditësit P. D., datë 4.3.2019, për përjashtim gjyqtari; vendim nr. \*\*\*, datë 13.3.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; printime të datave 13.3.2019 e 18.3.2019 nga SIM i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; kërkesë datë 15.3.2019 për heqje dorë nga gjykimi; vendim datë 18.3.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; kërkesë datë 22.3.2019 për shtim objekti të padisë; pesë dëftesa komunikimi datë 26.3.2019 për palët ndër gjyqëse; procesverbale gjyqësore datë 21.3.2019, 29.3.2019, 4.4.2019 dhe datë 18.4.2019.

trashëgimtarë ligjore dhe t'i dorëzojë 1/5-at e pasurisë trashëgimore"; 2) Pavlefshmëria absolute e testamentit nr. \*\*\*, datë 5.5.1995; 3) Marrjen e masës së sigurimit të pasurisë trashëgimore etj.”.

**34.3** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.2012, subjekti ka rrëzuar padinë, duke arsyetuar meqë paditësja nuk ka ndërtuar drejt ndërgjyqësinë, sepse nuk ka thirrur si të paditur të gjithë trashëgimtarët testamentarë të babait të saj S. E. J., atëherë ndërtimi i drejtë i ndërgjyqësisë nuk mund të kryhet kryesisht nga gjykata, e cila nuk mund të shprehet kështu për themelin e çështjes, por për rrëzimin e padisë.

**34.4** Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.6.2012, e ka lënë në fuqi vendimin e subjektit. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2015, ka vendosur prishjen e vendimeve të subjektit dhe të Gjykatës së Apelit Korçë.

**34.5** Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë argumenton se vendimet e dy gjykatave më të ulëta janë marrë në interpretim e zbatim të gabuar të ligjit procedural, duke lejuar shkelje të dispozitave ligjore procedurale, që kanë të bëjnë me ndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë dhe identifikimin e saktë të pozitës procedurale të palëve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk ka përmbushur detyrimet procedurale për përgatitjen e çështjes për gjykim dhe kujdesin për qëndrimet që gjykata duhet të mbajë për realizimin e një gjykimi të rregullt, përfshirë edhe ndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë.

**34.6** Komisioni nga ana e tij ka vlerësuar që subjekti i rivlerësimit, në respektim të nenit 161, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile, ka identifikuar saktë se objekti i padisë shtrihet edhe ndaj trashëgimtarëve N. e T. E. J., të cilët paditësi nuk i ka thirrur si palë ndërgjyqëse (të paditur), edhe pse janë përfshirë në testament, pavarësisht nga vlera e vogël e pasurisë që ata kanë përfituar dhe, si rrjedhojë, cenimi i vlefshmërisë së testamentit do të sillte edhe cenimin e të drejtave që këta dy trashëgimtarë kanë përfituar nga ky testament. Pra, jemi në kushtet e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme.

**34.7** Nga ana tjetër, duke qenë në një linjë me vendimin e Gjykatës së Lartë, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka shkelur dispozitat procedurale, midis të cilave edhe nenin 161, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se: *“Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c” të këtij neni dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit”*. Duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 154/a, që përmendet në këtë dispozitë, veprimet që neni 161, paragrafi 2, parashikon si detyrim për gjyqtarin, për t'u kryer në seancën përgatitore kur gjyqtari studion dosjen dhe përgatit çështjen për gjykim, kjo nuk përjashton mundësinë që rregullimin e ndërgjyqësisë gjyqtari ta kryejë edhe kur konstaton bashkëndërgjyqësi të detyrueshme gjatë seancës gjyqësore.

**34.8 Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, se subjekti ka pushuar gjykimin e padisë në kundërshtim me nenet 161 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk ka zbatuar detyrimin procedural të gjykatës për të orientuar palët në rregullimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme.**

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**34.9** Subjekti ka prapësuar se në respektim të parimit të disponibilitetit, në momentin e shpalljes së vendimit nr. \*\*\*, datë 8.2.2012, të drejtën për të disponuar mbi padinë e ka pasur vetëm paditësi, përfshirë edhe të drejtën për rregullimin ose ndryshimin e ndërgjyqësisë dhe gjykata nuk mund të kishte rol aktiv, qoftë dhe për orientimin e palës, pasi do të shkelej parimi i paanshmërisë. Kjo mbështetet edhe në vendimin unifikues nr. 901, datë 14.7.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.



**34.10** Nëse Gjykata kryesisht mund të konstatojë pavlefshmërinë absolute të një akti, ajo nuk do t'i japë kryesisht ndonjë personi cilësinë e palës së paditur, pasi do të shkelte parimin dhe të drejtën e secilës nga palët ndërgjyqëse për të pasur një proces të paanshëm, si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Rrëzimi i këtij kërkimi ka passjellë edhe rrëzimin e kërimit për detyrimin e të paditurve që ta njohin paditësen si trashëgimtare ligjore dhe t'i dorëzojnë 1/5-at e pasurisë trashëgimore ekzistuese apo pasurisë që mund të vijë në të ardhmen, pasi subjekti ka çmuar se ky kërkim i dytë është i ndërvarur nga kërkim i parë, prandaj ka konkluduar edhe për rrëzimin e këtij kërkimi, duke rrëzuar padinë në tërësi.

**34.11** Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka çmuar se ka qenë detyrim i Gjykatës së Shkallës së Parë për të gjetur mjetet ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, për të zgjidhur drejt mosmarrëveshjen, por në fakt nuk referon në ndonjë dispozitë konkrete apo ndonjë mjet ligjor konkret që mund të përdorë Gjykata e Shkallës të Parë.

**34.12** Në lidhje me detyrimin procedural të gjykatës për të orientuar palët në rregullimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, subjekti prapëson se neni 161, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, që i jep gjykatës rol aktiv dhe që citohet në konstatimin e Komisionit, nuk është i aplikueshëm në rastin në gjykim, pasi ky nen ka hyrë në fuqi në vitin 2017, ndërkohë që padia është gjykuar në vitin 2012.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**34.13** Pasi Komisioni mori në shqyrtim prapësimet e subjektit të rivlerësimit, vëren se ato janë ligjërisht të bazuara, prandaj përfundimisht vlerëson se nuk konstatohen mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.

**35. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 1.9.2022**, i shtetas A. T., e cila pretendon se trupi gjykues me tre gjyqtarë, e kryesuar nga subjekti i rivlerësimit Sonjela Voskopi pranë Gjykatës së Apelit Korçë, kanë dhënë vendimin korruptiv nr. \*\*\*, datë 30.3.2022, ku ka mospërputhje midis pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit, veprim i cili në nenin 102, pika 4, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, përcakton si shkelje disiplinore nxjerrjen e akteve, ku pjesa përshkruese-arsyetuese parashtron arsyetime që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese të tij ose që nuk kanë lidhje me të. Gjithashtu, pretendohet se trupi gjykues ka ndryshuar masën e dënimit nga 8 muaj burgim, që kishte dhënë Gjykata e Rrethit Korçë, në 210,000 lekë gjobë për të pandehurin D. Ç..

**35.1** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec mbi kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Pogradec ka gjykuar të pandehurin D. Ç., i akuzuar për veprën penale “Largim nga vendi i aksidentit...”, neni 273 i Kodit Penal. Në gjykim, i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka qenë dakord me kërkesën e tij.

**35.2** Nga dëshmia e penaltetit, e administruar gjatë gjykimit në shkallë të parë, rezulton se i pandehuri është dënuar 3 herë për veprën penale “Vjedhje”, 1 herë për veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit”, 1 herë për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

**35.3** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka dënuar të pandehurin me 8 muaj burgim, pasi ka aplikuar 1/3-at e dënimit për gjykimin e shkurtuar. Gjykata e Apelit Korçë, ku trupi gjykues kryesohej nga subjekti, me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 30.3.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.6.2021 dhe dënimin e të pandehurit me gjobë 210,000 lekë dhe, duke ulur 1/3-at e dënimit nga gjykimi i shkurtuar, ka caktuar gjobën 140,000 lekë.

**35.4** Në vendimin e tij, trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Korçë<sup>170</sup> e argumenton ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.6.2021, duke iu referuar kritereve e rrethanave për individualizimin e dënimit të parashikuar në nenin 47 të Kodit Penal. Referuar rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, pavarësisht rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit që është dënuar disa herë më parë, nuk justifikohet dënimi maksimal me burgim prej 1 viti burgim. Por, nga ana tjetër, fakti që i pandehuri është disa herë i dënuar më parë, që është shprehje e rrezikshmërisë shoqërore të tij si person, nuk justifikon ligjërisht aplikimin e alternativës së ekzekutimit të dënimit me burgim sipas nenit 59 të Kodit Penal, që pretendon i pandehuri. Gjykata e Apelit Korçë çmon se në rastin në gjykim qëllimet e dënimit penal arrihen duke aplikuar dënimin me gjobë 210,000 lekë dhe, nga procedimi me gjykim të shkurtuar, e zbret me 140,000 lekë gjobën.

**35.5** Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, nuk u konstatuan mospërputhje midis pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të tij. Trupi gjyqësor ka caktuar masën e dënimit brenda kufijve të dënimit që ka përcaktuar dispozita ligjore përkatëse. Vendimi është i qartë dhe i kuptueshëm.

**35.6** Nuk u provuan rrethana që trupi gjyqësor të jetë korruptuar për dhënien e këtij vendimi, sikurse pretendon denoncuesi për vendim korruptiv.

**35.7** Gjithashtu, pretendimi që ngre denoncuesja dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit (si kryesues i trupit) në lidhje me masën e dënimit kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe, në bazë të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimi.

**35.8** Pavarësisht nga kjo, Komisioni ngre dyshime për favorizim të të pandehurit, duke ulur dënimin e tij në minimumin e masës që përcakton neni 273 i Kodit Penal, megjithëse i pandehuri është person me precedentë penalë.

**35.9** Për sa më lart, Komisioni i kërkon subjektit të japë shpjegime në lidhje me lehtësimin e masës së dënimit ndaj të pandehurit D. Ç..

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**35.10** Në prapësime, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sikurse ka arsyetuar në vendimin e saj, duke shtuar edhe këto argumente: (i) Në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, pasi është dakordësuar me anëtarët e tjerë të trupit gjykues, ka vlerësuar se vepra penale “Largimi nga vendi i aksidentit”, që dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit, nuk përbën krim, por kundërvajtje penale dhe, referuar marzhit të dënimit, është vepër me rrezikshmëri të ulët shoqërore; (ii) Duke qenë para një kundërvajtjeje penale, dënimi me maksimumin e dënimit 1 vit burgim, që kishte caktuar Gjykata e Shkallës së Parë, ishte joproportional, pavarësisht se i pandehuri ishte i dënuar më parë; (iii) Është mbajtur në konsideratë fakti që gjatë hetimit dhe gjykimit i pandehuri nuk ka qenë me masë sigurimi “Arrest në shtëpi” apo “Arrest në burg”; (iv) Gjatë periudhës mbi 1 vit, nga momenti i kryerjes së veprës deri në gjykimin në Apel, nuk ka rezultuar të jetë kryer ndonjë veprim tjetër i paligjshëm nga ana i pandehuri; (v) Sipas nenit 34, paragrafi 4 i Kodit Penal, gjoba jepet nga 50 mijë - 3 milionë lekë për kundërvajtje penale. Vlera e gjobës e dhënë në vendimin e subjektit është caktuar disa herë më e madhe se vlera minimale e gjobës që parashikon kjo dispozitë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**35.11** Pasi mori në shqyrtim argumentet e subjektit në prapësime, Komisioni vlerëson se të gjitha kanë bazë ligjore dhe trupi gjykues ka dhënë një vendim proporcional, duke respektuar “parimin e drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit”, të parashikuar nga neni 1/c i Kodit Penal.

<sup>170</sup> Paragrafët 1 dhe 2, faqe 5 e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.3.2022, të Gjykatës së Apelit Korçë.

**Në përfundim, Komisioni vlerëson se në veprimet e subjektit nuk konstatohen mangësi.**

## **KONSTATIME TË TJERA**

**36.** Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se shtetasi I. F., bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, ka qenë i punësuar si avokat e, më pas, si kryetar i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Korçë, në periudhën janar 2014 – gusht 2021.

**37.** Nga hetimi rezultoi<sup>171</sup> se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.11.2016, ka vendosur kthimin e padisë dhe akteve bashkëlidhur tek pala paditëse në lidhje me çështjen civile me palë paditëse shkolla e mesme profesionale “\*\*\*\*”, palë të paditur shtetasit S. B., F. B., përmbarues gjyqësor “\*\*\*\*”, person i tretë Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korçë, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”.

**38.** Komisioni vlerëson se meqë subjekti nëpërmjet kërkesëpadisë ka rënë në dijeni se Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Korçë që drejtohet nga bashkëjetuesi i saj I. F. është palë në këtë gjykim, atëherë, në bazë të nenit 72, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit duhej të hiqte dorë nga shqyrtimi i kësaj padie që në momentin kur është njohur me shortin e padisë dhe të mos kryente asnjë veprim procedural.

**39.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.6.2020<sup>172</sup>, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen me palë paditëse U. P., palë të paditur Këshilli i Ministrave dhe Bashkia Korçë, me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Korçë, objekt “Detyrim njohjeje pronar me parashkrim fitues i tokës dhe ndërtesës me sip. 71.71 m<sup>2</sup>”. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur pranimin e padisë.

**40.** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se subjekti i rivlerësimit, duke mos hequr dorë nga gjykimi i padisë në dy çështjet më lart, ku është palë ndërgjyqëse Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë, e drejtuar nga bashkëjetuesi i saj, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit referuar nenit 3, pika 1, nenit 4, nenit 5, pika 1, shkronjat “dh/i” dhe nenit 7 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**41.** Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës së bashkëjetesës me shtetasin I. F. kanë qenë në fuqi disa akte ligjore, të cilat nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që ajo dhe bashkëjetuesi të ushtronin funksionet respektive brenda të njëjtit juridiksion<sup>173</sup>.

**42.** Gjithashtu, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nenet<sup>174</sup> 6 e 7, si dhe Kodit të Procedurës Civile,

<sup>171</sup> Sipas shkresës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. \*\*\*, datë 4.1.2024, dërguar Komisionit.

<sup>172</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 21.12.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në përgjigje të shkresës nr. \*\*\*, datë 18.12.2023, të Komisionit.

<sup>173</sup> (1) Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” (neni 24, pika 2), si persona në konflikt interesi me avokatin e shtetit parashikon: “bashkëshortin/en, fëmijët, vëllain, motrën ose prindërit, por jo bashkëjetuesin. Kjo dispozitë është shfuqizuar me ligjin nr. 86/2018, duke i përfshirë edhe këta persona”; (2) Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (shfuqizuar me ligjin nr. 98/2016, datë 6.10.2016), në asnjë dispozitë të tij nuk parashikonte pengesë për rastin e bashkëjetuesve dhe nuk parashikonte rregullime ligjore për papajtueshmërinë ambientale; (3) Ligji nr. 96/2016, në nenin 8 nuk parashikon papajtueshmëri ambientale midis magjistratit dhe Avokatit të Shtetit.

<sup>174</sup> Neni 6 parashikon: “1) Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët. 2) Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit”. Neni 7 parashikon: “Çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi. 2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e

nenet<sup>175</sup> 72, 73, që parashikojnë institutin e heqjes dorë nga gjykimi për të shmangur konfliktin e interesit në kuptimin e nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, subjekti dhe bashkëjetuesi rast pas rasti kanë marrë masat për të shmangur konfliktin e interesit, duke paraqitur kërkesat për dorëheqje nga gjykimi i çështjeve, ku përfaqësues i Avokaturës së Shtetit ishte bashkëjetuesi i saj.

**43.** Subjekti ka paraqitur para Komisionit praktikën për disa çështje që i kalonin asaj për gjykim dhe ku ka qenë përfaqësues i Avokaturës së Shtetit bashkëjetuesi i saj. Për këto çështje subjekti ka paraqitur para kryetarit të gjykatës kërkesat për heqje dorë, të cilat janë pranuar prej tij<sup>176</sup>.

**44.** Në kohën e gjykimit të dy rasteve të identifikuar nga Komisioni, rezultoi se Avokatura e Shtetit është përfaqësuar nga Avokatja e Shtetit E. S..

**45.** Subjekti ka vlerësuar se nuk është në asnjë nga rastet e nenit 72 apo nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, që të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve, kjo për shkak se, referuar akteve ligjore e nënligjore për Avokaturën e Shtetit<sup>177</sup> në fuqi, Avokati i Shtetit pranë një zyre vendore emërohet, shkarkohet, i jepet masë disiplinore në përfundim të një procedimi disiplinor, si dhe varet administrativisht nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Njëkohësisht, ka varësi funksionale nga kryetari i Zyrës së Përfaqësimit Ligjor dhe nuk ka marrëdhënie varësie nga kryetari i Zyrës Vendore.

**46.** Referuar rregulloreve “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, që përcaktojnë se *Kryetari i Zyrës Vendore nuk ka të drejtë të ndikojë në linjën e mbrojtjes ose në qëndrimin që mban në gjykim një avokat shteti, që raportin e përgjigjet pranë Zyrës së Përfaqësimit Ligjor pranë gjykatave dhe/ose Zyrës së Inspektimit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit*, bashkëjetuesi i subjektit nuk ka shfaqur mendim juridik në çështjet e identifikuar nga Komisioni.

**47.** Meqë asnjë nga palët në dy çështjet e identifikuar nga Komisioni nuk ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga gjykimi i padisë, subjekti mendon që palët kanë vlerësuar se ajo si gjyqtare nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke pasur besimin e tyre për një gjykim të paanshëm dhe objektiv nga ana e saj.

---

*mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi mund të kërkohej dhe të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur. 3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet si rregull me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklarimet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe/ose në rregulloret e brendshme të institucionit publik, ku zyrtari ushtron funksionet e veta. 4. Deklarimi i interesit për rastet e përcaktuara në shkronjën “dh”, “iii”, “iv” dhe “v”, pika 1 e nenit 5 të këtij ligji, si dhe përkatësia në organizata politike në kuptim të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 5”.*

<sup>175</sup> Neni 72 parashikon: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërit apo tjetrit palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie...”.

<sup>176</sup> Kërkesa të subjektit për dorëheqje datë 14.4.2021, 6.7.2021, 24.3.2022, 14.5.2021, 25.11.2016 dhe datë 10.1.2022; dy kërkesa datë 14.6.2021; dy kërkesa datë 2.2.2022; vendime për pranimin e kërkesave për dorëheqje: nr. \*\*\*, datë 13.1.2022; nr. \*\*\*, datë 14.5.2021; nr. \*\*\*, datë 3.2.2022; nr. \*\*\*, datë 15.4.2021; nr. \*\*\*, datë 6.7.2021; nr. \*\*\*, datë 14.6.2021; nr. \*\*\*, datë 6.4.2017; nr. \*\*\*, datë 24.3.2022; nr. \*\*\*, datë 3.2.2022; datë 25.11.2016; nr. \*\*\*, datë 14.6.2021; (iii) vendime për gjykim themeli: nr. \*\*\*, datë 14.10.2021; nr. \*\*\*, datë 13.7.2021; nr. \*\*\*, datë 10.3.2020.

<sup>177</sup> (i) Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 86/2018, datë 22.11.2018 (nenet 21, 26, 31, 32); (ii) Rregullorja e brendshme nr. \*\*\*, datë 14.1.2009, e ministrit të Drejtësisë “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”; (iii) Rregullorja e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.3.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit (që ka shfuqizuar të parën) (neni 32).

## Vlerësimi i Komisionit

**48.** Pasi shqyrtoi prapësimet e subjektit, Komisioni vëren se argumentet e saj janë të bazuara në dispozitat ligjore e nënligjore që ajo referon, si dhe në provat që subjekti paraqiti bashkëlidhur prapësimeve.

**49.** Fakti që sipas ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar dhe rregulloreve të brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, avokatët e shtetit nuk kanë varësi administrative nga kryetari i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit, i bën ata të pandikueshëm përballë eprorit të tyre (në rastin konkret, prej bashkëjetuesit të subjektit) në administrimin e linjës së mbrojtjes dhe përfaqësimit të çështjeve që ata mbrojnë. Duke pasur parasysh këtë rrethanë që i diferencon këto dy raste nga rastet e tjera, kur subjekti kishte detyrimin për të dhënë dorëheqjen nga gjykimi, në zbatim të neneve 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile, Komisioni çmon se subjekti nuk është në rastet e konfliktit të interesit, që përcaktojnë neni 3, pika 1, neni 4, neni 5, pika 1, shkronja “dh/i”, neni 7 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

**50.** Sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke hequr dorë në gjithë çështjet e tjera që i caktoheshin asaj për gjykim dhe ku Avokatura e Shtetit përfaqësohej nga bashkëjetuesi i saj, tregon për dispozicionin e subjektit për të respektuar dispozitat ligjore nga i buronte ky detyrim dhe për të ruajtur të pacenuar paanësinë në gjykim dhe besimin e publikut tek drejtësia.

**51.** Në dy çështjet e evidentuara nga Komisioni, ku në njërin prej tyre Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë ishte person i tretë, subjekti ka kthyer padinë si të paplotë dhe nuk ka gjykuar themelin e çështjes, ndërsa në çështjen tjetër ku Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Korçë ishte palë e paditur, subjekti ka pranuar padinë, nuk ka disponuar në favor të Avokaturës, si dhe gjykimi rezulton të jetë i drejtë, përfundimi tregon se nuk ka *indicie* për të dyshuar mbi qëndrimin e njëanshëm të subjektit në favor të institucionit që përfaqëson bashkëjetuesi i saj.

**52.** Qëndrimi procedural korrekt në çështjen e parë dhe gjykimi i drejtë në çështjen e dytë, si dhe fakti që ndaj këtyre dy çështjeve nuk janë evidentuar ankime apo denoncime nga palët ndërgjyqëse, janë tregues i sjelljes së përgjegjshme të subjektit në aspektin profesional dhe të integritetit si ligjzbatuese. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në këto dy çështje nuk është në asnjë nga rastet e shkeljeve disiplinore të parashikuara nga nenet 101, 102 e 103 të ligjit nr. 96/2015.

**53. Duke mbajtur parasysh këto rrethana, në përfundim Komisioni çmon se prapësimet e subjektit janë bindëse dhe nuk konstatohen mangësi në dy çështjet që i janë caktuar asaj për gjykim.**

**54.** Për të verifikuar të dhënat nga organet ligjzbatuese, në lidhje me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në raport me veprimtarinë e bashkëjetuesit të saj I. F., Komisioni administroi<sup>178</sup> dhe shqyrtoi fashikujt e dosjeve gjyqësore për çështje të gjykuara nga subjekti ndaj disa shtetasve, si vijon:

**55. Çështja me objekt “Vlerësim i masës së arrestit dhe caktim mase sigurimi personal” ndaj të ndaluarit E. B., i dyshuar për veprën penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit”**

**55.1** Ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 29.7.2020, në ngarkim të personit nën hetim E. B.. Në datën 28.7.2020, rreth orës 1:00 ky shtetas është ndaluar dhe arrestuar në flagrancë nga patrulla e policisë, pasi drejtonte një autoveturë me të cilën udhëtonin edhe 2 shtetas sirianë dhe 2 shtetas egjiptianë.

<sup>178</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

**55.2** Në datën 30.7.2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë ka përcjellë në gjykatë kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë së masës së arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për shtetasin E. B..

**55.3** Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.7.2020, ka vendosur: “Vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit E. B.; caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” ndaj këtij shtetasi, i mbrojtur nga avokati A. L., i zgjedhur kryesisht nga gjykata”.

**55.4** Subjekti në vendimmarrjen e saj ka mbajtur parasysh disa rrethana: llojin dhe rëndësinë e veprës penale që nuk është drejtuar ndaj shëndetit, jetës apo pasurisë së personit; faktin që i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë dhe që është familjar me dy fëmijë të mitur, 7 dhe 9 vjeç.

**55.5** Për sa më lart, në veprimet e subjektit nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi.

**56. Çështja me objekt “Zëvendësimi i masës së sigurimit personal” ndaj shtetasve M. K., Y. D., F. K., A. Sh., A. Ç., O. V. dhe F. Q., të ndaluar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”**

**56.1** Ka rezultuar se me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 17.12.2020, subjekti me cilësinë e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në përputhje me kërkesën e bërë nga prokuroria, ka caktuar ndaj shtetasve të ndaluar M. K., Y. D., F. K., A. Sh. dhe A. Ç. masën e sigurimit personal “Arrest në burg” në përputhje me nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale, duke argumentuar se ekziston rreziku që të dyshuarit të kryejnë të njëjtën veprë penale, si dhe duke mbajtur parasysh masën e dënimit për këtë veprë penale dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre në mënyrë të vazhdueshme. Për shtetasit O. V. dhe F. Q. ka caktuar masën e sigurimit “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik” të detyrës së punonjësit të policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, meqë këta e kanë kryer veprën penale vetëm në një episod të saj dhe jo në mënyrë të vazhdueshme.

**56.2** Referuar përmbajtjes së vendimit të subjektit, ka rezultuar se ka dyshime të arsyeshme që këta shtetas kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 i Kodit Penal) nëpërmjet favorizimit të transportimit të lëndës drusore pa dokumentacionin e nevojshëm në zonën e \*\*\*, në Korçë, duke u dhënë transportuesve informacionin se kur e ku ka patrulla policie dhe cilët policë janë në patrullë.

**56.3** Në zbatim të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, brenda afati ligjor 3 ditë nga data e zbatimit të masës së sigurimit personal, në datën 20.12.2020 subjekti ka caktuar seancën gjyqësore të datës 21.12.2020. Në këtë seancë, të dyshuarit kërkuan zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën “Garanci pasurore” dhe revokimin e masës “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”, me argumentin se të dyshuarit janë pezulluar prej punëdhënësit nga puna si policë për shkak të kësaj ngjarjeje, por nuk paraqitën asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt, i cili do të eliminonte shkakun për të cilin gjykata kishte caktuar më parë këto masa sigurimi personal.

**56.4** Në përfundim, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për 5 shtetasit që kanë këtë masë, duke argumentuar se ekziston rreziku që këta shtetas, duke qenë në detyrën e policit, mund të kryejnë të njëjtën veprë penale për të cilën dyshohen apo më të rëndë se ajo.

**56.5** Në datën 28.12.2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, pesë shtetasit e ndaluar, të përfaqësuar nga av. N. T., kanë kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” me masën “Garanci pasurore në vlerën 300,000 lekë”, duke argumentuar se: (i) janë proceduar me masën “Pezullim nga detyra” nga punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

së Shtetit (DPPSH), deri në momentin që statusi i tyre juridik do të ndryshojë me vendim gjyqësor, kështu që nuk ekziston më rreziku se duke qëndruar të lirë dhe në detyrë mund të kryejnë sërish të njëjtën vepër penale për të cilën janë arrestuar (bashkëlidhur janë depozituar si provë vendimet individuale<sup>179</sup> për masën disiplinore “Pezullim nga detyra” të DPPSH-së); (ii) nuk ekziston rreziku i largimit jashtë shtetit; (iii) kanë shfaqur pendesë gjatë hetimit; (iv) nuk kanë precedentë penalë të mëparshëm; (v) ndodhen në kushte të vështira ekonomiko-sociale për familjen, madje njëri prej tyre ka 4 fëmijë dhe gjendje jo të mirë shëndetësore. Në gjykim, prokurori ka qenë dakord me masën “Garanci pasurore” në vlerën 300,000 lekë.

**56.6** Në seancat gjyqësore të datës 29.12.2020, subjekti i rivlerësimit, duke u bazuar në nenin 236 të Kodit të Procedurës Penale, me vendime individuale<sup>180</sup> për secilin nga këta shtetas ka vendosur: (i) Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” me masën “Garanci pasurore”, në vlerën 300,000 lekë; (ii) Depozitim të shumës 300,000 lekë brenda afatit 48 orë, duke u vënë në dijeni prokurori, i cili me vërtetimin e dokumenteve duhet të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi; (iii) I dyshuari të qëndrojë nën masën e sigurimit “Arrest në burg” derisa të ekzekutohet garancia pasurore; (iv) Caktimin edhe të masës shtrënguese “Ndalim i daljes jashtë shtetit”.

**56.7** Në vendimin e saj për secilin të ndaluar, subjekti ka argumentuar njësoj se, meqë në këtë seancë i ndaluar ka paraqitur si provë vendimin “Pezullim nga detyra” e punëdhënësit të tij, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, bie shkak për të cilin është vendosur masa e sigurimit “Arrest në burg”, duke u zbutur kështu nevoja e sigurimit. Gjithashtu, nuk ekziston as rreziku i dëmtimit apo asgjësimit të provave nga ana e të ndalurit, kriter ligjor ky për caktimin e masës “Arrest në burg”, sepse, sikurse pohoi prokurori në seancë, të gjitha provat e nevojshme janë administruar dhe hetimi është në fazën kur do të komunikohet akuza për secilin të dyshuar.

**56.8** Për sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk konstatohen mangësi në veprimet e saj.

### **Konkluzion për kriterin e figurës dhe kriterin e vlerësimit profesional**

**57.** Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLGJ dhe dokumentacionit bashkëlidhur, dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe, sipas pikës 1, shkronjave “a” dhe “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES**

Shumica e trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve IV, V e VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të

<sup>179</sup> Për shtetasin A. Ç., vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2020; për shtetasin M. K., vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2020; për shtetasin F. K. vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2020; për shtetasin Y. D. vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2020; për shtetasin A. Sh., vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2020.

<sup>180</sup> Vendimet gjyqësore nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, për shtetasin A. Sh.; nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, për shtetasin M. K.; nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, për shtetasin A. Ç.; nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, për shtetasin Y. D.; nr. \*\*\*, datë 29.12.2020, për shtetasin F. K..

rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë; ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka zhvilluar procese në konflikt interesi.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Shumica e trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 31.5.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare (kundër)**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*